

## NË GJYKATËN THEMELORE NË PRIZREN

Numri i rastit P.nr.272/13

9 shtator 2014

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Arkadius Sedek kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarët Franciska Fiser dhe Valon Kurtaj anëtarë të trupit gjykues dhe procesmbajtësi Sonila Macneil, në rastin penal kundër:

1. **N.U.**, XXX;
2. **O.J.**, XXX;
3. **E.A.**, XXX;
4. **F.B.**, XXX;
5. **S.M.**, XXX;
6. **S.S.**, XXX;
7. **R.R.**, XXX;
8. **T.M.**, XXX;
9. **H.B.**, XXX;
10. **G.G.**, XXX.

Të paditur me aktakuzën e Prokurorisë Speciale PPS.No. 253/09 të datës 19 korrik 2012 dhe aktakuzën e ndryshuar të datës 22 janar 2014 për veprën penale *nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore* në kundërshtim me nenin 346 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "KPPK") lidhur me O.J., E.A., F.B., S.M., S.S., T.M. dhe R.R.; për veprën penale *nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore* në kundërshtim me nenin 346 të KPPK-së në lidhje me nenin 25 të KPPK-së lidhur me H.B. dhe G.G.; dhe për veprën penale *nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore* në kundërshtim me nenin 346 të KPPK-së në lidhje me nenin 24 të KPPK lidhur me N.U.

Pas mbajtjes së shqyrtimeve kryesore më 21 dhe 23 janar, 5, 18, 20, 24, 25, 16 shkurt 2014, 12 mars 2014, 7 prill 2014, 19 maj 2014 dhe 20 qershor 2014, 29, 30 dhe 31 korrik 2014, 3 dhe 4 shtator 2014 në të cilat prokurorinë e përfaqësoi Andrew Carney, A.H. e përfaqësoi palën e dëmtuar (Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit "AKM"), T.R. e përfaqësoi N.U., Z.J. e përfaqësoi O.J., V.V. e përfaqësoi S.M., Sh.S. e përfaqësoi R.R., M.D. e përfaqësoi H.B., Q.M. e përfaqësoi G.G., S.S. e përfaqësoi *veten*, E.A. e përfaqësoi *veten*, F.B. e përfaqësoi *veten* dhe gjatë tërë shqyrtimit ishin të pranishëm të pandehurit, pas diskutimeve dhe votimit të mbajtur më 4 shtator, më 9 shtator 2014 u shpall ky:

## AKTGJYKIM

### I.

Në bazë të nenit 365 paragrafit 1 të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme "KPP"). i pandehuri **N.U.** është

### FAJTOR

Sepse:

Mes viteve 2006 dhe 2007 në Prishtinë, N.U., në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës së Komunale të Prishtinës, në bashkëkryerje me O.J., S.M., S.S. dhe T.M. kanë nxjerrë në mënyrë të kundërligjshme vendime gjyqësore në paditë pronësore të tokave të ngritura nga Gjykata Komunale kundër Ndërmarrjes Shoqërore ("NSH") KBI Kosova Export ("NSH KBI") më vonë Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ("AKM") pa referimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ("DHVGJSK") në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13: gjegjësisht Rastet e Gjykatës Komunale: 1314/07; 1698/05; 53/06; 429/05; 3.06; 1849/06; 1147/06; 3521/04; 1415/05; 1738/07; 1908/03; 342/06; 1918/06; 251/04; 2333/05.

N.U. në cilësinë e kryetarit të Gjykatës u përkujdes që rastet t'i ndaheshin O.J., S.M., S.S. dhe T.M., në kundërshtim me sistemin e përcaktuar të ndarjes së rasteve, duke e ditur që këta gjyqtarë vendosnin për paditë lidhur me pronat e tokës kundër NSG KBI në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm. Kjo ishe në kundërshtim me informacionin e dërguar Gjykatës Komunale përmes një letre të datës 4 mars 2005 e cila i është dërguar të gjitha Gjykatave Komunale nga krye-gjyqtari i UNMIK-ut e cila i përcaktoi pozitën juridike dhe procedurat për paditë që kishin të bënin me NSH-të, dhe letra e AKM-së e dërguar Gjykatës Komunale e cila është pranuar më 26 janar 2007, e cila edhe më shumë i përcakton pozitën juridike dhe procedurën dhe në të cilën gjithashtu shkruan se Gjykata Komunale e Prishtinës nuk i është përmbajtur ligjit. N.U. nuk është përgjigjur në letrën e AKM-së deri më 2 janar 2008, pas vendosjes së NSH KBI-së nën administrimin e drejtpërdrejt të AKM-së dhe pas një hetimi të nisur nga Njësia Inspektuese Gjyqësore. Pos kësaj, N.U. drejtpërdrejt mori pjesë në një rast duke e ndryshuar vendimin në rastin 2333/2005 të cilin ai e nënshkroi edhe pse forma e nënshkrimit mbeti ajo e gjyqtarës së pandehur S.S.. N.U. gjithashtu e mbajti një takim me atëherë shefin e Njesisë Administrative të AKM-së, gjatë të cilit takim ai në mënyrë të tërthortë u interesua për pengimin e AKM-së lidhur me autorizimin e ekzekutimit të vendimeve të marra nga O.J., S.M., S.S. dhe T.M.. N.U. veproi në bashkëpunim me O.J., S.M., S.S. dhe T.M. me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose personin tjetër.

- Me çka N.U. e kreu veprën penale *nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore në bashkëkryerje* në kundërshtim me nenin 346 të KPPK-së në lidhje me nenin 23 të KPPK-së.
- Kështu që bëhet ri-cilësimi i padisë fillestare nxitja e personit tjetër për *nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore* me kundërshtim e me nenin 346 të KPPK-së në lidhje me nenin 24 të KPPK-së.

\* \* \*

## II.

E pandehura **O.J.** shpallet

### FAJTORE

Sepse:

Mes viteve 2006 dhe 2007 në Prishtinë, O.J. në cilësinë e gjyqtarës në gjykatën Komunale të Prishtinës, ka lëshuar vendime në nëntë raste vijuese të Gjykatës Komunale të Prishtinës lidhur me paditë kundër NSH KBI, më vonë AKM, pa referimin e DHVGJSK në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13: gjegjësisht Rastet e Gjykatës së Komunale 1314/07; 53/06; 3.06; 1849/06; 1147/06; 3521/04; 1415/05; 1738/07. Me vendimin e O.J. paditësve i është dhënë kompensim financiar për ngastrat e NSH KBI i cili ka qenë proporcionalisht shumë i vogël krahasuar me vlerën e tregut të tokës, dhe gjithashtu në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, i cili nuk parasheh që kontratat e shitjes të shpallet e pavlefshme dhe i cili nuk parasheh që si mjet juridik toka të kompensohet me tokë tjetër.

O.J. e ka shpallur vendimin për paditë e lartpërmendura pronësore edhe pse e dinte që kjo ishte në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, i cili parashikonte që juridiksioni parësor për rastet e padive pronësore kundër NSH-ve i përket DHVGJS dhe se asnjë gjykatë tjetër nuk mund të ushtrojë juridiksion ndaj një rasti të atillë pos nëse DHVGJS e referon rastin në atë gjykatë. Pastaj O.J. lëshoi vendime me të cilat tokat në pronësi të NSH KBI u shitën pa u përcaktuar gjendja faktike e pronësisë së tokës, siç e parasheh ligji. Në veçanti O.J. me vetëdije nuk siguroi prova dhe fakte për të përcaktuar që paditësi vërtet ishte pronar i vërtetë i tokës, me vetëdije nuk e konfirmoi vërtetësinë e kontratave të shitblerjes të cilat janë parashtruar si prova, dhe me vetëdije nuk e konfirmoi vërtetësinë e certifikatave të vdekjes të cilat ishin parashtruar si dëshmi mbi të drejtat e trashëgimisë së pronës. O.J. gjithashtu i bazoi vendimet e lartpërmendura në një ligj të caktuar, në Ligjin mbi Detyrimet, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 29/78 i cili nuk ishte i aplikueshëm për rastet e lartpërmendura. Rastet gjithashtu u shqyrtuan si raste me prioritet në kundërshtim me procedurat e përcaktuara për shqyrtimin e rasteve. O.J. i shpalli këto vendime gjyqësore me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose personin tjetër.

- Me çka O.J. e kreu veprën penale *nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore në kundërshtim me nenin 346 të KPPK-së.*

\* \* \*

## III.

Të pandehurit **E.A., F.B. dhe RR.R.** shpallen:

### FAJTORE

Sepse:

Më 2 tetor 2007 në Prishtinë, E.A., F.B. dhe RR.R., në cilësinë e gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, gjykata e shkallës së dytë, e ka lëshuar një vendim në rastin e pronësisë së tokës e numër të Gjykatës së Qarkut 604/2003. Kjo ishte një ankesë ndaj Vendimit të Gjykatës Komunale, nr. i rastit 2333/05, rast i pronësisë së

tokës, vendimin e mori S.S.. Gjyqtarët e Kolegjit të apelit vendosën lidhur me ankesën në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 me të cilat juridiksioni ndaj rasteve të kërkesave pronësore kundër NSH-ve i përkiste DHVGJS dhe se asnjë gjykatë nuk mund të ushtronte juridiksion ndaj rasteve të atilla pos nëse DHVGJS e referon rastin në atë gjykatë dhe që më tutje thoshte se çdo ankesë ndaj vendimit të lëshuar nga gjykata pas referimit të DHGJS ishte kompetencë e DHVGJS. Kolegji i Apelit nuk e shpalli Gjykatën e qarkut jo-kompetente për shqyrtimin e ankesës ndaj rastit 2333/05 në kundërshtim me këtë ligj. Për më tepër, Kolegji i apelit e konfirmoi vendimin e Gjykatës Komunale që u bë në kundërshtim me ligjin e palakueshëm dhe me ta bërë këtë e citoi një vendim të DHVGJS (SCA-05-0104) dhe me qëllim i paraqiti ndryshe arsyetimin dhe rrethanat faktike të këtij vendimi për t'u përpjekur për ta përcaktuar ligjshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë (Vendimi i Gjykatës Komunale C. Nr. 2333/05). Kolegji i apelit e mori këtë vendim me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose personin tjetër.

- Me çka E.A., F.B. dhe RR.R. e kryen veprën penale *nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore* në kundërshtim me nenin 346 të KPPK-së.

\* \* \*

#### IV.

E pandehura **S.M.** shpallet

#### FAJTORE

Sepse

Mes viteve 2006 dhe 2007 në Prishtinë, S.M., në cilësinë e gjyqtares në gjykatën Komunale të Prishtinës, ka marrë vendime të kundërligjshme në dy rastet vijuese pronësore të tokës të Gjykatës Komunale të Prishtinës lidhur me paditë kundër NSH KBI, më vonë AKM, gjegjësisht Rastet e Gjykatës së Komunale 1698/05 dhe 251/04. S.M. vendosi lidhur me kërkesat e lartermdnura pronësore të tokës edhe pse e dinte që me këtë bënte shkelje të ligjit të aplikueshëm, i cili parashikonte që juridiksioni parësor për rastet e padive pronësore kundër NSH-ve i përket DHVGJS dhe se asnjë gjykatë tjetër nuk mund të ushtronte juridiksion ndaj një rasti të atillë pos nëse DHVGJS e referon rastin në atë gjykatë. Pastaj S.M. lëshoi vendime me të cilat tokat në pronësi të NSH KBI u shitën pa u përcaktuar gjendja faktike e pronësisë së tokës, siç e parasheh ligji. Vendimi 1698/05 i lëshuar nga S.M. paditësve i është dhënë kompensim financiar për ngastrat e NSH KBI i cili ka qenë proporcionalisht shumë i vogël krahasuar me vlerën e tregut të tokës, dhe gjithashtu në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, i cili nuk parasheh që kontratat e shitjes të shpallet e pavlefshme dhe i cili nuk parasheh që si mjet juridik toka të kompensohet me tokë tjetër. S.M. gjithashtu i bazoi vendimet e lartpërmendura në një ligj të caktuar, në Ligjin mbi Detyrimet, i cili nuk ishte i aplikueshëm për rastet e lartpërmendura. Rastet gjithashtu u shqyrtuan si raste me prioritet në kundërshtim me procedurat e përcaktuara për shqyrtimin e rasteve. S.M. i shpalli këto vendime gjyqësore me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose personin tjetër.

- Me çka S.M. e kreu veprën penale *nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore* në kundërshtim me nenin 346 të KPPK-së.

\* \* \*

## V.

E pandehura **S.S.** shpallet

### FAJTORE

#### Sepse

Mes viteve 2006 dhe 2007 në Prishtinë, S.S., në cilësinë e gjyqtarës në gjykatën Komunale të Prishtinës, ka marrë vendim të kundërligjshëm në rastin vijues pronësor të tokës të Gjykatës Komunale të Prishtinës lidhur me NSH KBI: 2333/05. S.S. vendosi lidhur me kërkesat e lartpërmendura pronësore të tokës edhe pse e dinte që me këtë bënte shkelje të ligjit të aplikueshëm, i cili parashikonte që juridiksioni parësor për rastet e padive pronësore kundër NSH-ve i përket DHVGJS dhe se asnjë gjykatë tjetër nuk mund të ushtrojë juridiksion ndaj një rasti të atillë pos nëse DHVGJS e referon rastin në atë gjykatë. S.S. lëshoi vendime me të cilat u dha sipërfaqe të mëdha të tokës paditësve dhe u dha hapësira shtesë si kompensim. Kjo ishte në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm Rregulloren e UNMIK-ut 2001/13 i cili nuk parasheh që kontratat e shitjes të shpallet e pavlefshme dhe i cili nuk parasheh që si mjet juridik toka të kompensohet me tokë tjetër. S.S. pastaj i mori këto vendime me të cilat toka në pronësi të NSH u dha apo u shit pa përcaktimin e gjendjes faktike të pronësisë së tokës, siç kërkohet me ligj. S.S. gjithashtu i bazoi vendimet e lartpërmendura në një ligj të caktuar, në Ligjin mbi Detyrimet, i cili nuk ishte i aplikueshëm për rastin e lartpërmendur. Rasti gjithashtu u shqyrtua si rast me prioritet në kundërshtim me procedurat e përcaktuara për shqyrtimin e rasteve. S.S. i shpalli këto vendime gjyqësore me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose personin tjetër.

- Me çka S.S. e kreu veprën penale *nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore në kundërshtim me nenin 346 të KPPK-së*.

\* \* \*

## VI.

I pandehuri **T.M.** shpallet

### FAJTOR

Sepse mes viteve 2006 dhe 2007 në Prishtinë, T.M., në cilësinë e gjyqtarit në gjykatën Komunale të Prishtinës, ka marrë vendime të kundërligjshme në tre rastet vijuese pronësore të tokës të Gjykatës Komunale të Prishtinës lidhur me paditë pronësore kundër NSH KBI, më vonë AKM, pa referimin e DHVGJSK në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13: gjegjësisht Rastet e Gjykatës së Komunale: 1908/03, 342/06, 1918/06. T.M. vendosi lidhur me kërkesat e lartpërmendura pronësore në kundërshtim ligjin e aplikueshëm, i cili parashikonte që juridiksioni parësor për rastet e padive pronësore kundër NSH-ve i përket DHVGJS dhe se asnjë gjykatë tjetër nuk mund të ushtrojë juridiksion ndaj një rasti të atillë pos nëse DHVGJS e referon rastin në atë gjykatë. T.M. lëshoi vendime me të cilat u dha sipërfaqe të mëdha të tokës paditësve dhe u dha hapësira shtesë si kompensim. Kjo ishte në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm i cili nuk parasheh që kontratat e shitjes të shpallet e pavlefshme dhe i cili nuk parasheh që si mjet juridik toka të kompensohet me tokë tjetër. T.M. pastaj i mori këto vendime me të cilat toka në pronësi të NSH u dha apo u shit pa përcaktimin e gjendjes faktike të pronësisë së tokës, siç kërkohet me ligj. T.M. gjithashtu i bazoi vendimet e lartpërmendura në një ligj të caktuar, në Ligjin mbi Detyrimet, i cili nuk ishte

i aplikueshëm për rastet e lartpërmendura. Rastet gjithashtu u shqyrtuan si raste me prioritet në kundërshtim me procedurat e përcaktuara për shqyrtimin e rasteve. T.M. i shpalli këto vendime gjyqësore me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose personin tjetër.

- Me çka T.M. e kreu veprën penale *nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore në kundërshtim me nenin 346 të KPPK-së*.

\* \* \*

## VII.

E pandehura **H.B.** shpallet

### FAJTORE

Sepse mes viteve 2006 dhe 2007 në Prishtinë, H.B., propozoi të përfaqësonte NSH KBI, të paditurën për 15 rastet vijuese pronësore të tokës të Gjykatës Komunale të Prishtinës lidhur me paditë pronësore, edhe pse nuk ishte e autorizuar ta bënte këtë: gjegjësisht Rastet e Gjykatës së Komunale: 1314/07; 1698/0553/06; 429/05; 1849/06; 1147/06; 3521/04; 1415/05; 1738/07; 1908/03; 342/06; 1918/06; 251/04; 2333/05. H.B. është liruar nga përfaqësimi i rasteve më 23 nëntor 2006 dhe nuk ishte formalisht punësuar nga asnjë NSH nga kjo datë. Derisa e përfaqësonte NSH KBI, H.B. nuk kërkoi mbrojtjen e interesave të NSH-së: ajo nuk e kundërshtoi faktin që Gjykata Komunale nuk kishte juridiksion për të vendosur për rastet pronësore të lartpërmendura dhe ajo nuk e informoi AKM-në që AKM-ja ishte paditur përkundër marrjes së njoftimit nga Shefi i AKM-së më 21 mars 2005 dhe 20 shtator 2005, i cili i udhëzonte të gjitha NSH-të për obligimin e tyre lidhur me raportimin, mbrojtjen e pasurive dhe ligjin e aplikueshëm lidhur me paditë e parashtruara kundër NSH-ve. Për më tepër H.B. me qëllim të përfaqësimit të paditësit NSH KBI gjatë shqyrtimit gjyqësor u ndihmoi të pandehurve O.J., T.M., S.M. dhe S.S. duke i plotësuar kërkesat e përfaqësimit ligjor të të paditurit. Këto veprime bashkërisht u ndihmuan O.J.it, T.M.it, S.M.t dhe S.S.t duke u mundësuar që para tyre të parashtrihen paditë dhe të lëshohen vendimet. H.B. ishte në dijeni që vendimet janë lëshuar me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore dhe u ndihmoi O.J.it, T.M.it, S.M.t dhe S.S.t ta bënin këtë.

- Me çka H.B. e kreu veprën penale ndihma në *nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore në kundërshtim me nenin 346 të KPPK-së* lidhur me nenin 25 të KPPK.

\* \* \*

## VIII.

I pandehuri **G.G.** shpallet

### FAJTOR

Sepse:

- Gjatë viteve 2006 dhe 2007 në Prishtinë, G.G., në cilësinë e përfaqësuesit ligjor i përfaqësoi paditësit në rastet vijuese pronësore të tokës të Gjykatës Komunale të Prishtinës numër: 429/05; 1849/06; 53/06; 1918/06; 1415/05 në Gjykatën Komunale të Prishtinës. Derisa vepronte në cilësinë e përfaqësuesit ligjor lidhur me kërkesën 1918/06 G.G. e bashkëngjiti dokumentin referues të Dhomës së Posaçme që kishte të bënte me një rast tjetër (1896/07) me padinë 1918/06, me qëllim që kjo të konsiderohej si

dokument original dhe padia të bëhej që të dukej thuajse është referuar drejt në gjykatën Komunale në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13

- Me çka G.G. e kreu veprën penale falsifikimi i dokumenteve në kundërshtim me nenin 332 të KPPK-së.

\* \* \*

Prandaj në bazë të dispozitave të neneve 6, 11, 15, 31, 32, 33, 34, 36,38, 41, 42, 43, 44 dhe 332 of KPPK dhe neneve 359, 361, 365 par.1, 366 të KPK, gjykata i shpallë këto dënime:

**N.U.**

- për veprën penale nën pikën I të këtij aktgjykimi dënohet me dënim me kusht me dy vjet burgim me kusht që i pandehuri të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës prej 2(dy) vitesh;

**O.J.**

- për veprën penale nën pikën II të këtij aktgjykimi dënohet me dënim me kusht me 18 (tetëmbëdhjetë) muaj burgim me kusht që e pandehura të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës prej 2 (dy) vitesh;

**E.A.**

- për veprën penale nën pikën III të këtij aktgjykimi dënohet me dënim me kusht me 9 (nëntë) muaj burgim me kusht që i pandehuri të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës prej 2 (dy) vitesh;

**F.B.**

- për veprën penale nën pikën III të këtij aktgjykimi dënohet me dënim me kusht me 9 (nëntë) muaj burgim me kusht që i pandehuri të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës prej 2 (dy) vitesh;

**S.M.**

- për veprën penale nën pikën IV të këtij aktgjykimi dënohet me dënim me kusht me 6 (gjashtë) muaj burgim me kusht që e pandehura të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës prej 2 (dy) vitesh;

**S.S.**

- për veprën penale nën pikën V të këtij aktgjykimi dënohet me dënim me kusht me 8 (tetë) muaj burgim me kusht që e pandehura të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës prej 2 (dy) vitesh;

**T.M.**

- për veprën penale nën pikën VI të këtij aktgjykimi dënohet me dënim me kusht me 1 (një) vit burgim me kusht që i pandehuri të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës prej 2 (dy) vitesh;

**RR.R.**

- për veprën penale nën pikën III të këtij aktgjykimi dënohet me dënim me kusht me 9 (nëntë) muaj burgim me kusht që i pandehuri të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës prej 2(dy) vitesh;

**H.B.**

- për veprën penale nën pikën VII të këtij aktgjykimi dënohet me dënim me kusht me 1 (një) vit burgim me kusht që e pandehura të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës prej 2 (dy) vitesh;

**G.G.**

- për veprën penale nën pikën VII të këtij aktgjykimi dënohet me dënim me kusht me 6 (6) muaj burgim me kusht që i pandehuri të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës prej 2 (dy) vitesh;

Kundër të pandehurve O.J., E.A., F.B., S.M., S.S., RR.R., T.M., H.B. dhe G.G. në bazë të nenit 54 paragrafët 1 dhe 2 dhe nën-paragrafi 4 dhe nenit 57 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, shpallet **dënimi dytësor** i *ndalimit të ushtrimit të profesionit, aktivitetit ose detyrës* për një periudhë prej dy (2) vitesh.

Kundër të pandehurit N.U., në bazë të nenit 54 paragrafët 1 dhe 2 dhe nën-paragrafi 4 dhe nenit 57 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, shpallet **dënimi dytësor** i *ndalimit të ushtrimit të profesionit, aktivitetit ose detyrës* për një periudhë prej tri (3) vitesh nga dita kur hyn në fuqi vendimi i gjykatës.

Palët e dëmtuara mund të ankohen për kompensim në gjykatat civile.



## ARSYETIMI

### PËRMBAJTJA

A. Historiku i procedurës.....	13
B. Kompetencat .....	15
C. Procedura e dëshmime .....	17
D. Faktet e përcaktuara .....	23
E. Arsyetimi ligjor .....	43
F.Fajësia e të pandehurve .....	51
G.Dënimi .....	76

## A. HISTORIKU I PROCEDURËS

1. Më 27 korrik 2012 prokurori special e parashtrori aktakuzën PPS 253/09 të datës 19 korrik 2012 i cili i akuzon të pandehurit si vijon: të pandehuri 1 deri 8 për shpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit në kundërshtim me nenin 339, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK; të pandehurit 2 deri 8 për nxjerrja të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore në kundërshtim të nenit 346 të KPPK; të pandehurit 9 dhe 10 për ndihmë në shpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit në kundërshtim me nenin 339 në lidhje me nenin 25 të KPPK; të pandehurit 1, 9 dhe 10 për ndihmë në nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore në kundërshtim të nenit 346 t në lidhje me nenin 25 të KPPK;
2. Seanca dëgjimore konfirmuese janë mbajtur më 20 gusht 2014, 24 shtator 2012, 18 tetor 2012 dhe 2 nëntor 2012. Më 24 tetor 2012 të pandehurit F.B. dhe T.M. janë përjashtuar nga ky shqyrtim. Por shqyrtimi lidhur me T.M.in rinisi më 18 tetor 2012.
3. Aktakuza u hodh poshtë në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake të datës 27 dhjetor 2012. Prandaj Procedura kundër të gjithë të pandehurve (pos palës së përjashtuar F.B.) u pezullua.
4. Prokurori special është ankuar kundër aktvendimit me të cilin është hedhur poshtë aktakuza. Në aktvendimin e datës 17 prill 2013, Gjykata e Apelit pjesërisht e pranoi ankesën e prokurorit special dhe konstatoi që aktakuza mbetet në fuqi, me mundësi ndryshimi. Aktakuza për të gjithë të pandehurit u hodh poshtë sa i përket cilësimit juridik të shpërdorimit të pozitës zyrtare.
5. Më 22 gusht 2013 kryetari i atëhershëm i trupit gjykues, me kërkesën e prokurorit special e ribashkoi rastin e F.B. me rastet e 9 të pandehurve të tjerë të akuzuar me aktakuzën PPS 253/09. Aktakuza është konfirmuar kundër tij përmes aktvendimit të kryetarit të trupit gjykues të datës 5 dhjetor 2013 e cila është konfirmuar nga gjykata e apelit.
6. Një aktakuzë e ndryshuar është parashtruar më 22 janar 2014 përmes së cilës të pandehurit akuzoheshin si vijon: të pandehurit 2 deri 8 për nxjerrja të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore; të pandehurit 9 dhe 10 për ndihmë në nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore; 1 i pandehur për nxitjen personit të tjetër për nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore
7. Shqyrtimet kryesore janë mbajtur më 21 dhe 23 janar 2014, 5, 18, 20, 24, 25, 26 shkurt 2014, 12 mars 2014, 7 prill 2014, 19 maj 2014, 18 dhe 20 qershor 2014, 29, 30 dhe 31 korrik 2014, 3 dhe 4 shtator 2014.
8. Dispozitivi i aktgjykimit është shpallur më 9 shtator 2014.
9. Në bazë të nenit 541 të KPK i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013<sup>1</sup>, shqyrtimi është mbajtur në bazë të dispozitave të kodit të ri të procedurës penale.

---

<sup>1</sup> Penale Nr.04/L-123

## B. KOMPETENCAT

10. Ligji për gjykatat, ligji nr. 03/L-199 hyri në fuqi më 1 janar 2013.
11. Ky ligj e rregullon juridiksionin territorial dhe lëndor të gjykatës.
12. Sipas nenit 11 paragrafit (1) të Ligjit për Gjykatat, gjykatat themelore janë kompetente për të vendosur për të gjitha rastet e nivelit të parë pos nëse është paraparë ndryshe me ligj.
13. Neni 9 i ligjit për gjykatat parasheh që gjykatat themelore të themelohen për territoret e komunave të tyre përkatëse. Veprat të cilat i nënshtrohen këtyre shqyrtimeve janë kryer brenda kompetencës territoriale të gjykatës themelore të Prishtinës. Por meqë pesë të pandehur janë ish gjyqtar të gjykatës që qarkut në Prishtinë, gjykata themelore e Prizrenit ka kompetencë territoriale në bazë të nenit 123.2 (b) të Ligjit mbi kompetencat<sup>2</sup>.
14. Në bazë të nenit 15 paragrafi (1) nën-paragrafi (1.19) të ligjit për gjykatat, veprat penale kundër pozitës zyrtare (përfshirë por *jo vetëm* shpërdorimin e pozitës zyrtare ose të autorizimit, përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës, mashtrimi në detyrë, rryshfeti dhe ushtrimi i ndikimit) janë kompetencë e Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore. KPP e plotëson nenin 15 të ligjit për gjykatat: neni 22, nën-paragrafi (1.1.87) i KPP-ës parasheh që vepra nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore do të konsiderohet si krim i rëndë në përputhje me nenin 15 të ligjit për gjykatat. Pos kësaj, në bazë të nenit 15 paragrafi (1) nën-paragrafët (1.20) të ligjit për gjykatat, çdo krim i cili nuk është paraparë në mënyrë specifike me nenin 15 por i cili bie nën kompetencën ekskluzive apo vartëse të Prokurorisë Speciale të Kosovës<sup>3</sup> do të bie nën kompetencën e Departamentit të Krimeve të Rënda. Prandaj, tërë rasti është gjykuar nga Departamenti i Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore të Prizrenit.
15. Në përputhje me paragrafin (2) të nenit 15 të Ligjit për Gjykatat dhe në bazë të Ligjit mbi Kompetencat , përzgjedhja e rasteve dhe ndarja e rasteve mes gjyqtarëve të EULEX-it dhe prokurorëve të Kosovës (Ligji nr. 03/L-053), rasti është shqyrtuar nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Arkadiusz Sedek kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarja e EULEX-it Franciska Fisher dhe Valon Kurtaj anëtarë të trupit gjykues.<sup>4</sup>
16. Ndryshimet e kompetencave të EULEX-it janë bërë me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve lidhur me Mandatin e Bashkimi Europian për sundimin e ligjit në Kosovë, (Ligji nr. 04/L-273) i cili ka hyrë në fuqi më 15 maj 2014. Meqë gjyqtarët e EULEX-it janë caktuar në këtë rast para datës 15 prill 2014, ky rast është një “rast në vazhdim” sipas Nenit 1 A paragrafi (2) të Ligji nr. 04/L-273) dhe prandaj gjyqtarët e EULEX-it e kanë ruajtur kompetencën për këtë rast.
17. Asnjëra nga palët nuk ka pasur kundërshtime për kompetencën e gjykatës ose përbërjen e trupit gjykues.

---

<sup>2</sup> 2008/03-L-052

<sup>3</sup> Veprat në aktakuzën PPS 253/09 mendohet të jenë kompetencë e PSRK sipas nenit 12 të Ligjit mbi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-52 (13 mars 2008) – vendimi nga kryeprokurori i EULEX-it i datës 21 janar 2014,

<sup>4</sup> Neni 3.2 i Ligjit nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe ndarjen e caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it dhe prokurorëve në Kosovë, parasheh që gjyqtarët e EULEX-it do të kenë kompetenca ndaj rasteve të zhvilluara nga PSRK. PSRK e ka zhvilluar këtë rast.

### C. PROCEDURA E DËSHMIVE

18. Provat e parashtruara gjatë shqyrtimit kryesor

19. I. Gjatë shqyrtimit kryesor dëshmitarët në vijim kanë dëshmuar ( sipas radhës së paraqitjes në shqyrtim):

- V.H., (është ftuar si dëshmitar nga prokuroria), është dëgjuar më 23 janar 2014,
- S.N., ( ftuar si dëshmitar nga prokuroria), është dëgjuar më 5 shkurt 2014,
- S.B., (dëshmitare e prokurorisë por e propozuar nga mbrojtja dhe është ftuar nga si dëshmitare nga avokati mbrojtës M.D.) është dëgjuar më 5 shkurt 2014,
- M.A., (është ftuar si dëshmitare nga prokuroria), është dëgjuar më 18 shkurt 2014,
- F.T., (është ftuar si dëshmitar nga prokuroria), është dëgjuar më 20 shkurt 2014,
- B.K., (është ftuar si dëshmitare nga prokuroria), është dëgjuar më 20 shkurt 2014,
- M.S., (është ftuar si dëshmitare nga prokuroria), është dëgjuar më 24 shkurt 2014,
- M.K., (është ftuar si dëshmitare nga prokuroria), është dëgjuar më 24 shkurt 2014,
- N.H., (është ftuar si dëshmitar nga prokuroria), është dëgjuar më 25 shkurt 2014,
- S.H., (është ftuar si dëshmitar nga prokuroria), është dëgjuar më 26 shkurt 2014,
- B.T., (është ftuar si dëshmitar nga prokuroria), është dëgjuar më 26 shkurt 2014,
- M.B., (është ftuar si dëshmitar nga avokati mbrojtës M.D.), është dëgjuar më 12 mars 2014,
- Mu.B., (është ftuar si dëshmitar nga avokati mbrojtës M.D.), është dëgjuar më 12 mars 2014,
- I.A., (është ftuar si dëshmitare nga avokati mbrojtës T.R. është dëgjuar më 12 mars 2014,
- N.L., (është ftuar si dëshmitar nga avokati mbrojtës T.R. është dëgjuar më 12 mars 2014,
- R.F., (është ftuar si dëshmitar nga prokuroria), është dëgjuar më 12 mars 2014,
- N.M., (është ftuar si dëshmitar nga trupi gjykues *sipas detyrës zyrtare*), është dëgjuar më 7 prill 2014,
- Barjam Selmani, (është ftuar si dëshmitar nga trupi gjykues *sipas detyrës zyrtare*), është dëgjuar më 19 maj 2014,

20. Gjatë shqyrtimit kryesor më 20 qershor 2014, ka dëshmuar e pandehura në vijim:

- H.B.

Të pandehurit e tjerë nuk dëshmuar gjatë shqyrtimit kryesor.

21. II. Me pajtimin e palëve dhe në përputhej me nenin 338 (1.3) të KPP deklaratat vijuese të dëshmitarëve konsiderohen të shënuara në procesverbal dhe si dëshmi të pranueshme:

**Grupi a): Dëshmitarët e dëgjuar gjatë gjykimit**

- B.K., deklaratë e datës 22 qershor 2012
- N.H., deklaratë e datës 20 qershor 2012
- F.T.i, deklaratë e datës 18 tetor 2011
- M.A., deklaratë e datës 23 gusht 2011
- S.B., deklaratë e datës 11 gusht 2011
- M.S., deklaratë e datës 4 korrik 2012
- M.K., deklaratë e datës 4 korrik 2012
- V.H., deklaratë e datës 15 qershor 2012
- S.N., deklaratë e datës 5 qershor 2012
- S.H., deklaratë e datës 27 mars 2012
- B.T., deklaratë e datës 16 gusht 2011

**Grupi b): Dëshmitarët e dëgjuar gjatë gjykimit**

- B.R., deklaratë e datës 14 tetor 2011
- G.B., deklaratë e datës 6 prill 2012
- S.Sp., deklaratë e datës 28 mars 2012
- L.D., deklaratë e datës [shih regjistratorin 6– ku është regjistratori 6? ]
- V.M., deklaratë e datës [shih regjistratorin 6]
- Z.M., deklaratë e datës [shih regjistratorin 6]
- N.D., deklaratë e datës [shih regjistratorin 6]

**Grupi c): Dëshmitarët e dëgjuar gjatë gjykimit(sipas radhës së aktakuzës)**

- N.U., deklaratë e datës 26 gusht 2011
- O.J., deklaratë e datës 11 korrik 2012
- E.A., deklaratë e datës 23 gusht 2011
- F.B., deklaratë e datës 24 gusht 2011
- S.M., deklaratë e datës 26 gusht 2011
- S.S., deklaratë e datës 22 gusht 2011 dhe 31 gusht 2011
- RR.R., deklaratë e datës 24 gusht 2011
- T.M., deklaratë e datës 11 tetor 2011
- H.B., deklaratë e datës 7 korrik 2011

- G.G., deklarata e datës 8 mars 2012, 13 mars 2012, 15 mars 2012, 22 mars 2012

22. III. Gjatë shqyrtimit kryesor më 20 qershor 2014 dokumentet në vijim janë shënuar në procesverbal:

- Provat e të gjitha 15 rasteve civile të Gjykatës Komunale (1314/07, 1698/05, 53/06, 429/05, 3/06, 1849/06, 1147/06, 3521/04, 1415/05, 1738/07, 1908/03, 342/06, 1918/06, 251/04, 2333/05), përfshirë raportet e gjeodezistit ekspert, që kanë të bëjnë me aktakuzën:
- Dosja 7 – Rastet 1 (P: 1-121); Rasti 2 (P:122-243); Rasti 3 (P: 244-344)
- Dosja 8 – Rasti: 4 (P:1-112); Rasti: 5 (P: 113-245); Rasti:6 (P:246-336)
- Dosja 9 – Rasti: 7 (P:1-113); Rasti: 8 (114-183); Rasti: 9 (P:184-265)
- Dosja 10- Rasti: 10 (P:1-114); Rasti: 11(P: 115-464)
- Dosja 11- Rasti: 12 (P: 1-77); Rasti: 13 (P: 78-338)
- Dosja 12- Rasti: 14 (P:1-139); Rasti:15 (P: 140-268)
- Raporti i Njësitit Gjyqësor të Inspektimit, 12 dhjetor 2008 - Regjistratori 13, Faqe: 1-54
- Letra nga C.P., 4 mars 2005 – Regjistratori 13, Faqe: 55-65
- Vendimi i Gjykatës së Qarkut AC nr. 701/2005 – Regjistratori 13, faqe: 66-75
- Vendimi i Gjykatës së Qarkut AC nr. 127/2006 – Regjistratori 13, faqe: 76 – 85
- Vendimi i Gjykatës së Qarkut AC nr. 400/2005 – Regjistratori 13, faqe: 86 – 91
- Letra e Kryesuesit të AKM-së drejtuar të gjitha NSH-ve e datës 21 mars 2005 - Regjistratori 13, faqe: 92-97
- Letra e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të AKM-së drejtuar menaxhmentit të NSH-ve dhe Këshillave të Punëtorëve e datës 20 shtator 2002 - Regjistratori 13, faqe: 98-105
- Letra e AKM-së drejtuar H.B.t e datës 22 nëntor 2006 - Regjistratori 13, faqe: 106 -109
- Letra e AKM-së drejtuar N.U. e datës 26 janar 2007-Regjistratori 13, faqe 110-115
- Letra e AKM-së drejtuar N.U., kryetarit të Gjykatës Komunale dhe A.N., kryetarit të Gjykatës së Qarkut e datës 11 dhjetor 2007 - Regjistratori 13, faqe: 116 – 117
- Letër drejtuar AKM-së nga N.U. e datës 02 janar 2008 - Regjistratori 13, faqe: 118 – 126
- Komunikimet me e-mail mes AKM-së dhe H.B. të muajit janar 2008 - Regjistratori 13, faqe: 127 - 129
- Raporti hetues lidhur me regjistrimin e thirrjeve telefonike 11.07.2012 - Regjistratori 13, faqe: 130 – 153 pagesa në rastin 1 ( C.nr. 1317/07) - € 813.25 paguar NSH-së - Regjistratori 13, faqe: 154 – 156 pagesa në rastin 3 ( C.nr. 53/06) - € 976.90 paguar NSH-së - Regjistratori 13, faqe: 157 pagesa në rastin 4 ( C.nr. 429/05) - € 4,476.57 paguar NSH-së - Regjistratori 13, faqe: 158
- Kërkesa e Njësisë së Inteligjencës Financiare (FIU) e adresuar Dhomës së Posaçme, z.

- R.W. e datës 23 gusht 2010 - Regjistratori 13, faqe: 159
- Përgjigja e z. R.W., Dhoma e Posaçme FIU-së e datës 17 shator 2010 - Regjistratori 13, faqe: 160 – 166
  - Letra e Dhomës së Posaçme drejtuar Gjykatës Komunale në Ferizaj - Regjistratori 13, faqe: 167 – 174
  - Letra përcjellëse për kryetarin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë - Regjistratori 13, faqe: 175 – 179
  - Memorandumi lidhur me legjislacionin që i rregullon kontratat e anuluar - Regjistratori 13, faqe: 180 – 181 Ligji mbi kthimin e pronave - Regjistratori 13, faqe: 182 – 189
  - Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme në një rast tjetër të NSH – SCC-08-0112- Regjistratori 13, faqe: 190 -195
  - Raporti i përkohshëm i FIU-së -18.08.2010 - Regjistratori 13, faqe: 196 – 327
  - Raporti i përkohshëm i FIU-së -01.12.2010 - Regjistratori 14, faqe: 1 – 234
  - Raporti i përkohshëm i FIU-së -01.09.2011 - Regjistratori 14, faqe: 235 – 375
  - Raporti i përkohshëm i FIU-së -01.11.2011 - Regjistratori 14, faqe: 375 – 395
  - Raporti përmbledhës i FIU-së për intervistën me G.G. - 22.05.2012 - Regjistratori 15, faqe: 1-54
  - Raporti i FIU-së për të dhënat e marra nga Gjykata Komunale e Prishtinës, 17 korrik 2012 – Regjistratori 15, faqe: 55- 57
  - Pasqyra e bankës Raiffeisen për T.M. - Regjistratori 15, faqe: 58- 71
  - Hetimi i Bankës Qendrore lidhur me transaksionin e dyshimtë të 1,025.00 eurove e datës 24 korrik 2006 - Regjistratori 15, faqe: 72-81
  - Ligji për Gjykatat e rregullta nr. 21/78 - Regjistratori 15, faqe: 82 – 123
  - Ligji mbi detyrimet , Gazeta zyrtare e RSFJ-së 29/78 (nenet 99-109) - Regjistratori 15, faqe: 124 -127
  - Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 - Regjistratori 15, faqe: 128 – 193
  - Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 - Regjistratori 15, faqe: 194- 214
  - Vendimi i Komisionit Disiplinor Gjyqësor i datës 20 qershor 2011- Regjistratori 15, faqe: 215 – 222
  - Letra nga Zyra Kadastrale drejtuar B.T. lidhur me rastin e Gjykatës Komunale 1314/07 - Regjistratori 15, faqe: 223 – 225
  - Të gjitha dokumentet në pakon e raporteve të AKM-së që janë parashtruar gjatë dëgjimit të konfirmimit të aktakuzës;
  - Të gjitha dokumentet e parashtruar me Njoftimin Vërtetues që i verifikojnë numrat telefonik të të pandehurve;

- Raporti i plotësuar (lista e numrave telefonik të regjistruar dhe lista e thirrjeve telefonike) i raportit të thirrjeve të regjistruara si provë nr. 14 në aktakuzë dhe raporti i regjistrimit të thirrjeve i parashtruar në seancën e parë të konfirmimit të aktakuzës;
- Diagrami – analiza telefonike në bazë të raportit të regjistrimit të thirrjeve telefonike (e përmendur në pikën 4);
- Aktgjykimi i S.M. (jo pjesa 15 e rastit):
  - i. C.nr. 1911/06 Aktgjykimi është shpallur më 16.05.2007 – rasti penal në pritje në Gjykatën Themelore të Prizrenit
- Vendimet e S.S. në të cilat ajo e deklaron veten jo-kompetente
  - i. C.no. 82/04 vendimi i shpallur më 25.01.2005
  - ii. C.no. 2742/2004 vendimi i shpallur më 31.03.2005
  - iii. C.no. 2422/2008 vendimi i shpallur më 27.10.2009
  - iv. C.no. 22/2007 vendimi i shpallur më 29.05.2007
  - v. C.no. 332/2009 vendimi i shpallur më 02.07.2009
  - vi. C.no. 622/2006 vendimi i shpallur më 25.06.2009
  - vii. C.no.1822/2003 vendimi i shpallur më 23.09.2008
- Memorandumi i brendshëm i UNMIK-ut *Ref. DD/JDD/08/bf02335 datë 9 qershor 2008*

23. IV. Gjatë shqyrtimit kryesor, provat në vijim janë mbledhur nga Trupi gjykues sipas detyrës zyrtare:

- Raporti i zyrës kadastrale të Graçanicës, i datës 2 maj 2014
- Memorandumi i Institutit Gjyqësor të Kosovës lidhur me trajnimet, datë 4 prill 2014
- Aktgjykimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në vijim: SCC-09-0167; SCC-09-0096; SCC-08-0255; AC-1-120038; SCC-09-0106.
- Fotografitë e ekspozuara nga eksperti i gjeodezisë B.S. gjatë dëshmisë së tij më 19 maj 2014

24. V. Gjatë shqyrtimeve vijues e kryesore, avokati mbrojtës parashtroi shumë dokumente gjyqësore të lëshuara nga institucione ndryshme të Kosovës për të provuar që veprimet që ato i ndërморën kanë qenë plotësisht legjitime. Këto dokumente janë pjesë e provave dhe janë futur në regjistrat e rastit ( regjistri i gjykatës i emëruar “Dokumentet e parashtruara gjatë shqyrtimit kryesor”.)

25. VI. Gjatë shqyrtimit kryesor, janë bërë këto parashtresa:

26. *Kërkesa e prokurorit për pranimin e provave të reja në formë të audio transkriptit të siguruara si rezultat i urdhrorit për masat e fshehura të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës themelore të Prizrenit më datë 12 qershor 2013.*

27. Më 21 janar 2014, gjatë shqyrtimit kryesor, prokurori e parashtroi “kërkesën për pranimin e provave të reja”. Provat e propozuara përbëheshin nga audio-transkripti i



bisedës mes të pandehurit G.G. dhe K.U. të regjistruar më 20 shtator 2013, është siguruar në bazë të urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake për masat e fshehur (vëzhgimi i hapësirave private) të datës 12 qershor 2013 në një procedurë të ndarë penale, rasti numër HEP 273/12 (PP 276/12). Prokuroria theksoi që detajet e kësaj bisede nuk ishin të njohura për prokurorinë në kohën e Seancës së dytë dëgjimore në rastin aktual dhe që prova, e cila pretendohet të jetë pranim i veprës së kryer, nuk i dyfishon provat e tjera në këtë rast. Mbrojtja gjatë shqyrtimit kryesor më 21 janar 2014 e kundërshtoi kërkesën e prokurorit dhe deklaroi që prova duhet të konsiderohet si e papranueshme sepse biseda relevante është marrë pas datës 12 shtator 2013, e cila është dita e skadimit të urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Pos kësaj, mbrojtja e kundërshtoi kërkesën sepse urdhri përmes të cilit është siguruar prova nuk i referohet të pandehurit G.G..

28. Në Aktvendimin e datës 28 janar 2014, kryetari i trupit gjykues e refuzoi kërkesën e prokurorit dhe konstatoi që prova e propozuar ishte e papranueshme sipas nenit 97 (1) të KPP si dhe nenit 97 (2) të KPP në lidhje me nenin 88 (3.1) dhe nenit 90 të KPP, dhe që lejimi i pranimi të provës së papranueshme do ta cenonte të drejtën për gjykim të drejtë që garantohet me nenin 5 të KPP dhe nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Aktvendimi i datës 28 janar 2014 është ankimuar nga prokurori por kolegji i apelit e refuzoi ankesën si të parakohshme. Paneli e rishqyrtoi çështjen e pranueshmërisë siç është udhëzuar nga Gjykata a e Apelit dhe qëndron pranë vendimit dhe arsytimit në Aktvendimin e datës 28 janar 2014.

29. *Pranueshmëria e deklaratës së dëshmitarit F.T. të shpallet e papranueshme.*

30. Gjatë shqyrtimit kryesor më 21 dhe 23 janar, avokati mbrojtës i G.G. theksoi që deklarata e dëshmitarit F.T. duhet të shpallet e papranueshme sepse ai e ka dhënë deklaratën në kohën kur e kishte statusin e të dyshuarit dhe jo të dëshmitarit. Mbrojtja e bazoi kundërshtimin e saj në nenin 249 të KPP. Kjo parashtresë është mbështetur nga avokati mbrojtës i N.U. Mbrojtja më tutje kundërshtoi që Fetat Tahiri të ftohej si dëshmitar i prokurorisë.

31. Prokurori qëndroi pranë propozimit të tij për ta ftuar dëshmitarin dhe theksoi që dispozitat ligjore nuk ndryshojnë mes deklaratës së dhënë nga dëshmitari dhe asaj të dhënë nga i pandehuri; F.T. nuk ishte më i pandehur dhe prandaj nuk kishte pengesë që ai të merrej në pyetje gjatë seancës në cilësinë e dëshmitarit.

32. Paneli plotësisht u pajtua që arsyetimi ligjor i parashtruar nga prokurori dhe e ftoi F.T. si dëshmitar në atë rast më 20 shkurt 2014.

33. *Pranueshmëria e Memorandumit të Brendshëm të UNMIK-ut Ref: DOJ/JDD/08/bf02335 të datës 9 qershor 2008*

34. Avokati mbrojtës i N.U., O.J. dhe G.G., bashkë me S.S. duke u mbrojtur vet dhe Rr.R., E.A. dhe F.B. duke u mbrojtur vet, e kundërshtuan pranueshmërinë e provës së parashtruar nga prokurori gjatë shqyrtimit kryesor më 28 maj 2014 në parashtresën me shkrim. Prova në fjalë ishte një Memorandum i Brendshëm i UNMIK-ut të datës 9 qershor 2008. Vërejtja kryesore mund të përmbledhet se Memorandumi ishte jo-relevant dhe i pabesueshëm, sipas nenit 259 të KPP.

35. Paneli konstatoi që prokurori kishte të drejtë ta parashtronte Memorandumin e brendshëm të datës 9 qershor 2008 si provë në këtë rast, meqë dokumenti kishte të bënte me referimin në Komisioni Gjyqësor të Inspektimit të 15 rasteve për hetime penale dhe prandaj përmban informata të përgjithshme për vendimet të cilat kërkojnë

hetime të mëtejshme. Dokumenti gjithashtu përmban një vlerësim të përlogaritur të tokës në fjalë. Paneli konsideroi që asnjë rëndësi nuk mund t'i jepej vlerësimit të tokës në këtë dokument shkak i faktit që dukej të jetë caktuar në mënyrë shumë arbitrare pa ndonjë justifikim të duhur të kualifikuar. Paneli konstatoi që prokurori nuk ishte i obliguar të dëshmonte vlerën potenciale të tokës për ta provuar veprën nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore. Paneli përsëriti që nuk e ka shqyrtuar vlerën e tokës së cekur në dokument si fakt të përcaktuar. Paneli dëshiron të konstatojë në këtë aktgjykim që përmbajtja e këtij Memorandumi është paraqitur në media pa theksimin e këtyre paralajmërimeve dhe përkundër faktit që vet Memorandumi ishte dokument i besueshëm.

#### D. FAKTET E PËRCAKTUARA

36. Aktgjykimi bazohet në prova e pranueshme pas përfundimit të shqyrtimit kryesor.
37. Pas fazës së prova në shqyrtimin kryesor, Gjykata i konstatoi këto fakte:
38. Gjatë viteve 2006 dhe 2007 , O.J., S.M., S.S. dhe T.M., në pozitat e tyre si gjyqtarë në Gjykatën Komunale të Prishtinës, dhe Rr.R., E.A. dhe F.B., në pozitat e tyre si gjyqtarë në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, kanë lëshuar vendime në 15 raste lidhur me tokën të pronësisë shoqërore.
39. Vendimet e lëshuar nga gjyqtarët e pandehur janë marrë në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm mbi kompetencat, gjegjësisht Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 dhe në kundërshtim me ligjin material.
40. H.B. dhe G.G. janë dy avokatë që kanë marrë pjesë në seanca si përfaqësues të palëve: H.B. e ka përfaqësuar palën e paditur në të gjitha 15 rastet; G.G. i ka përfaqësuar paditësit në 6 rastet. N.U. ka qenë kryetari i Gjykatës Komunale në Prishtinë gjatë periudhës kur të gjitha 15 rastet janë gjykuar.
41. Statusi i punësimit të të pandehurve ishte si vijon: O.J. ka qenë e punësuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë nga viti 2003 deri në vitin 2010; E.A. ka qenë i punësuar us gjyqtar civil në Gjykatën Komunale të Prishtinës nga viti 2003 deri në vitin 2010; F.B. ka qenë i punësuar si gjyqtar civil në Gjykatën Komunale të Prishtinës nga viti 2000 deri në vitin 2009; S.M. ka qenë e punësuar si gjyqtare civile në Gjykatën Komunale të Prishtinës nga viti 2000 deri në vitin 2010; S.S. ka qenë e punësuar si gjyqtare civile në Gjykatën Komunale të Prishtinës nga viti 2000 deri në vitin 2010; T.M. ka qenë i punësuar si gjyqtar civil në Gjykatën Komunale të Prishtinës nga viti 2003 deri në vitin 2010; G.G. e ka regjistruar një biznes në vitin 2006 dhe pastaj u ka ofruar shërbime juridike qytetarëve privat.
42. a) Historiku
43. Secila nga 15 vendimet kishte të bënte me tokën në pronësi shoqërore. Paneli konstaton historikun e pronësisë së tokës në Kosovë si vijon: gjatë viteve 1950 dhe 1960 ngastrat e tokës janë marrë nga regjimin i asaj kohe – regjimi socialist i Jugosllavisë – me qëllim të themelimit të veprimtarive të më mëdha, kolektive bujqësore të njohura si Ndërmarrje Shoqërore (NSH). Pronarët e tokave shpesh janë detyruar të lidhin kontrata për transferimin e tokave të tyre në emër të qeverisë për një shumë të vogël pagese.
44. Në të gjitha 15 vendimet, kontratat me të cilat toka është transferuar nga pronarët në pronësi të qeverisë janë lidhur gjatë viteve 1950 dhe 1960.
45. Gjatë viteve 1990 pronarëve të tokave, ose trashëgimtareve të tyre, i është dhënë mundësia e kthimit të tokave të tyre përmes parashtrësës së kërkesës. Mundësia për parashtrimin e padisë me këtë ligj ka qenë e kufizuar për një periudhë prej 10 vitesh nga data e hyrjes në fuqi të ligjit më 27 mars 1991.<sup>5</sup>
46. Ligji i aplikueshëm – procedura dhe kompetenca
  - i) Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 “Mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të

<sup>5</sup> Shih Ligjin mbi Metodrat dhe Kushtet për njohjen e të drejtave dhe kthimin e tokës të shndërruar në pronë shoqërore për qëllime të fondit të tokës bujqësore dhe tokës së konfiskuar shkaku i moszbatimit të detyrimeve të blerjes së detyrueshme të produkteve bujqësore (Gazeta Zyrtare e RS” Nr. 18/90”)

Mirëbesimit”.

47. Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 hyri në fuqi më 13 qershor 2002 dhe u themelua Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (“AKM”).
48. AKM-ja është themeluar për t’i likuiduar dhe privatizuar të gjitha NSH-të, dhe për ta menaxhuar procesin e ndarjes së tokave shoqërore pronarëve të vërtetë ose trashëgimtareve të tyre. Me këtë u përcaktua primati i AKM-së ndaj të gjitha NSH-ve.

Paragrafi 2 i Rregullores 2002/12 e përcaktoi subjektin dhe qëllimin e AKM-së të administrojë ndërmarrjet shoqërore publike dhe pasuritë e tyre. Ajo siguroi, inter alia, që për ta arritur këtë qëllim AKM-ja do të kryese veprime ndihmëse për ta ruajtur ose shtuar vlerën, gabueshmërinë ose qeverisjen e ndërmarrjes; paragrafi 6 përcaktonte që AKM-ja do të kishte autoritet administrativ sa i përket NSH-ve dhe që një autoritet i atillë do të përfshinte çdo veprim, pos atyre të përcaktuara në mënyrë specifike, që AKM-ka i konsideronte të duhura për ta ruajtur ose shtuar vlerën, zbatueshmërinë ose qeverisjen e ndërmarrjes në pyetje. Paragrafi 7 e përcaktonte ushtrimin e pushtetit të AKM-ës ndaj ndërmarrjes: paragrafi 7.1 thotë që *“Agjencia do t’i përmbushë përgjegjësitë e saj nga ky kapitull duke e ushtruar mbikëqyrjen e përgjithshme të menaxhimit ndaj ndërmarrjes brenda kufijve të burimeve të saj administrative”*. Paragrafi 7.2 e qartëson mirë se AKM e ka ruajtur tërë përgjegjësinë për ndërmarrjen përkundër zhvillimit të afarizmit të ndërmarrjes në baza ditore:” Te rasti i paragrafit 7.1 afarizmi i ndërmarrjes në baza ditore, *pa paragjykim të pushtetit të agjencisë nën paragrafin 6.1”* ( është shtuar theksi).

49. Paragrafi 29 i Rregullores 2002/12 përcakton që për t’i filluar procedurat ligjore kundër NSH-ës, paditësi duhet të ofrojë provë që AKM-së i është parashtruar njoftimi me shkrim për synimin për të parashtruar padi kundër NSH. Paragrafi 29 gjithashtu përcaktoi që AKM kishte të drejtë ligjore në emër të NSH. Paragrafi 30 i Rregullores 2002/12 përcaktonte që DHPGJS kishte kompetencë ekskluzive për të gjitha paditë kundër AKM-së dhe DHPGJS nuk do të pranojë asnjë padi kundër AKM-së nëse paditësi nuk parashtron prova që e ka njoftuar AKM-më për qëllimin e tij për të parashtruar padi së paku 60 ditë para se të parashtrrojë padinë.

ii) Rregullorja e UNMIK-ut *“Mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit”*

50. Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13 hyri në fuqi më 13 qershor 2002, po të njëjtën datë[ kur edhe Rregullorja 2002/12. Me atë u themelua Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) për t’u marrë me çështjet që ndërlidhen në AKM-në. Ajo përcaktonte që **kompetencat parësore** lidhur me çfarëdo vendimi ose veprimi të AKM-së ishin në suaza të DHPGJSK. Paragrafi 4 përcaktonte që DHPGJSK kishte kompetencave parësore lidhur me çdo padi kundër AKM-së.

51. Rregullorja 2002/13 më tutje përcaktonte që DHPGJSK mund t’ia referonte paditë e veçanta çdo gjykatë për vendose, por qartë përcaktonte se asnjë gjykatë nuk do të kishte kompetenca ndaj padive që ndërlidheshin me tokat e NSH-ve, pos nëse paditë e atilla janë referuar nga DHPGJSK (kjo është theksuar).<sup>6</sup> Ajo e përcaktonte që paditë të cilat dilnin nga rastet e referuara nga DHPGJSK te ndonjë gjykatë specifike binin ekskluzivisht nën kompetencën e DHPGJSK.

---

<sup>6</sup> Paragrafi 2.2 Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13. Dosja i Prokurorisë 15

52. Letrat e Gjyqtarit kryesor dhe AKM-së për Gjykatën Komunale
53. Një letër e datës 4 mars 2005 UNMIK-u ia kishte dërguar Gjyqtarit Kryesor të Gjykatave Komunale.<sup>7</sup> Pranimi i letrës është konfirmuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës më 17 mars 2005. Kjo letër shpjegonte që rastet ku përfshiheshin NSH-të duhej të administroheshin në përputhje me Rregulloret e UNMIK-ut 2002/12 dhe 2002/13.
54. Një letër tjetër AKM-aj ia dërgoi N.U., si kryetarit të Gjykatës Komunale të Prishtinës, më 22 janar 2006. Letra është pranuar nga Gjykata Komunale, siç qëndron në vulë, më 26 janar 2007.<sup>8</sup> Kjo letër shpjegonte se AKM-ja ishte në dijeni që Gjykata Komunale Prishtinës “dukej të pranonte kompetenca dhe juridiksione për çështjet që ishin nën kompetencën e DHPGJSK. Letra e përcakton pozitën juridike sipas Rregullores 2002/12, 2002/13 dhe që rastet ku përfshihen NSH-të mund të gjykohen vetëm nga Gjykata Komunale nëse rasti i është referuar Gjykatës Komunale nga Dhoma e Posaçme dhe që AKM është njoftuar për këto procedime.<sup>9</sup> Kjo letër gjithashtu përcaktonte se Gjykata Komunale e Prishtinës deri tash nuk i është përmbajtur ligjit. Letra kërkon, “do të ishim mirënjohës nëse do ta konfirmonit se i keni informuar kolegët tuaj që praktika e deritashme është e papranueshëm dhe që duhet ta zbatoni ligjin”. N.U. nuk u përgjigj në këtë letër deri më 2 janar 2008 (shih paragrafin x më poshtë) kur ai i shkroi AKM-së duke i thënë që ai kishte konstatuar se për 12 rastet në të cilat përfshiheshin NSH KBI ka vendosur Gjykata komunale pa u referuar nga DHPGJSK.
55. d) NSH KBI
56. Secili nga 15 rastet e theksuara në padi për tokë kundër NSH KBI, kooperativë bujqësore.
57. Në vitin 1997, Ndërmarrja Shoqërore Kosovo Export(KBI) është ndarë në shtatë NSH dhe ka psuhaur të ekzistojë në vitin 1997.
58. e) Letrat nga AKM dërguar NSH-ve
59. Siç është theksuar në paragrafin b, Rregullorja 2002/12 përcaktonte që AKM-ja ishte përgjegjëse për administrimin e NSH-ve të dhe të pasurive të tyre.
60. Fakti që AKM-ja ishte autoriteti përgjegjës për ndarjen e pasurive (aseteve) të NSH-ve i është komunikuar NSH-ve në mënyrë eksplicite në dy letrat e datave 20 shtator 2002 dhe 21 mars 2005.
61. Një letër nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve të AKM-së më 20 shtator 2002 i është dërguar të gjitha NSH-ve.<sup>10</sup> Në letër theksohej që me Rregulloren 2002/12 të gjitha NSH-të ishin vendosur në autoritetin e AKM-së dhe se të gjitha pasuritë e NSH-ve do të mbikëqyreshin nga AKM-ja.
62. Letra e dytë e dërguar nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve të AKM-së e datës 21 mars 2005<sup>11</sup> e adresuar të gjitha NSH-ve qartë thekson se vetëm AKM ose DHPGJSK mund të autorizojë marrjen e pronës së paluajtshme të NSH-së. Letra theksonte që asnjë NSH nuk duhet ta shet ose të pranojë ta shesë pasurinë e saj dhe që menaxhmenti i NSH-së

<sup>7</sup> Dosja i Prokurorisë 15, f. 55-65

<sup>8</sup> Supozohet që data 22 janar 2006 është gabim shtypi dhe duhet të jetë 22 janar 2007.

<sup>9</sup> Dosja i Prokurorisë 15, f. 116-117

<sup>10</sup> Dosja e Prokurorisë 13, f. 98-105

<sup>11</sup> Dosja e Prokurorisë 13, f. 92- 97

duhet të bëhej përpjekje të arsyeshme për ta ruajtur pasurinë e NSH-së. Më tutje ajo thekson që AKM-ja ishte në dijeni se NSH-të kishin padi kundër tyre nëpër gjykata dhe që NSH është e obliguar ta informojë AKM-në brenda tri ditësh nga marrja e informatës që ajo (NSH) është paditur. Letra përfundonte me njoftimin që NSH-të nuk duhet të tentojnë ta anashkalojnë AKM-në.

63. f) NSH KBI Kosovo Export , NSH Ferma e Derrave dhe AKM-ja
64. Siç u theksua në paragrafin d., NSH KBI pushoi të ekzistojë si subjekt juridik dhe ishte ndarë në shtatë NSH individuale në vitin 1997.
65. Derisa ndarja e tokës nuk ishte formalizuar në regjistrat e kadastrës, efekti praktik i asaj ndarjeje ishte që toka ishte ndarë mes NSH-ve të porsakrijuara dhe nuk ishte në pronësi të vetme të NSH KBI.
66. Pas ndarjes së NSH KBI Kosovo Export, H.B. dhe shefi i saj I.H. ishin të punësuar në njërin nga NSH-të e krijuara, gjegjësisht në NSH Ferma e Derrave. I.H. ishte drejtor i NSH Ferma e Derrave dhe H.B. ishte punëtore.
67. Në vitin 2006, NSH Ferma e Derrave u likuidua/privatizua nën përkujdesjen e AKM-së. Pas kësaj, të gjithë të punësuarit u shpallën tepricë nga AKM-aj. H.B. e mori dhe e nënshkroi letrën e AKM-së që është tepricë, më 23 nëntor 2006. Pas kësaj date, ajo nuk ishte e punësuar formalisht në NSH Ferma e Derrave ose në ndonjë NSH tjetër.
68. Pas likuidimit/privatizimit të një NSH, të gjithë të punësuarit e NSH e fitonin të drejtën në 20 % të shumës për të cilën pasuria, e cila e përfshinte tokën që ishte pronë e NSH, ishte shitur. H.B. dhe I.H. e gëzuan të drejtën e 20% nga likuidimi/privatizimit i NSH Ferma e Derrave.
69. Pas nën-ndarjes dhe mbylljes së NSH KBI, H.B. vazhdoi ta prezantonte veten si punëtore e NSH KBI derisa ishte e punësuar nga NSH Ferma e Derrave. Ajo vazhdoi ta prezantonte veten si punëtore e NSH KBI edhe pas përfundimit të punësimit të saj në NSH Ferma e Derrave. H.B. dhe drejtori i NSH Ferma e Derrave, I.H., i zaptuan hapësirat e NSH KBI në Fushë Kosovë. Kjo vazhdoi përkundër kërkesave të AKM-së që I.H. t'i dorëzonte të gjitha dokumentet juridike, regjistrat notare, regjistrat e rasteve të gjykatës, vendimet e gjykatave lidhur me tokën e NSH-së, marrëveshjet e dhënies me qira të tokës, vulën e NSH-ës dhe kartelën llogarisë bankare, çelësat e zyrave, derisa AKM-ja e vendosi NSH-në KBI nën administrimin e drejtpërdrejtë më 16 nëntor 2007. Pas vendosjes së NSH KBI nën administrim të drejtpërdrejt si rezultat i këtij moszbatimin, AKM i konfiskoi të gjitha gjërat e lartpërmendura dhe i ndërroi bravat e dyerve të zyrave të ish NSH KBI.
70. g. Ligji i aplikueshëm material lidhur me paditë kundër NSH-ve
  - i) *Ligji mbi detyrimet*
71. Secila padi është bazuar në Ligjin mbi Detyrimet, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 29/78
72. *Ligji mbi Detyrimet* hyri në fuqi më 1 tetor 1978. Ky ligj është i aplikueshëm për kërkesat pronësore të tokave në të cilat kontrata/detyrimet janë shënuar *pas* datë së hyrjes në fuqi të këtij ligji, siç është provuar nga jurisprudenca e DHPGJSK: DHPGJSK i ka hedhur poshtë kërkesat në bazë të Ligjit mbi Detyrimet sepse *Ligji mbi Detyrimet* nuk ishte i aplikueshëm për detyrimet kontraktore të cilat janë lidhur para hyrjes në fuqi të këtij

ligji. Në vendimin Nr SCC—8-0112 e datës 24 shkurt 2011<sup>12</sup>, DHPGJS ka hedhur poshtë një padi të bazuar mbi *Ligjin e Detyrimeve* dhe ka arsyetuar se neni 103 nuk ishte i zbatueshëm për një padi të tillë pasi detyrimet/kontratat ishin bërë para se ligji të hynte në fuqi. DHPGJS ka zbatuar praktiken e njëjtë në vendimet në vijim: SCC-09-0167 të datës 24 tetor 2012; SCC-09-0096 të datës 22 gusht 2012; SCC-08-0255 të datës 31 korrik 2012; AC-I\_12-0038 të datës 30 maj 2013 dhe SCC-09-0106 të datës prill 2013.

ii) *Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13*

73. Për rastet e referuara në mënyrë të rregullt në DHPGJS-së, mjete juridik ishte dhënë në nenin 10 të Rregullores 2002/13. Ky ofronte njohjen e një të drejte, titulli apo interesi në asetin i cili ishte në pronësi të NSH. Neni 10.3 i Rregullores 2002/13 parashihte dhënien e kompensimit monetar në rrethanat kur aset i kërkuar (në këtë rast- ngastra e tokës) nuk do të mund t'u kthehej palëve, për shkak se aset (toka) tashmë ishte privatizuar nga palët e treta, dhe për këtë arsye ato nuk janë në posedim të AKM-së. Pagesa e kompensimit monetar ishte përcaktuar që të jetë “e barabartë me vlerën e asetit, të cilat do të llogariten në përputhje me rregullat procedurale të Dhomës së Posaçme”. Ky nen nuk ka ofruar dhënien e ngastrave të tokës për zëvendësim.

iii) *Ligji mbi Metodrat dhe Kushtet për të njohur të drejtat dhe rikthimin e tokës së shndërruar në pronësi shoqërore me qëllim të fondit të tokës bujqësore dhe tokës së konfiskuar për shkak të mospërbushjes së detyrimeve e blerjes së detyrueshme të produkteve bujqësore ("Gazeta Zyrtare e RS "Nr. 18/90"), hyri në fuqi më 27 mars 1991. Ky ligj ka referenca specifike për paditë e tokave kundër NSH-ve. Ligj zbatohet në vetëm dy lloje të veçanta të padive dhe vlen vetëm për paditë që ishin paraqitur jo më vonë se 10 vjet pasi që ka hyr ligji në fuqi. Ligji parasheh, në rrethana të veçanta, dhënien e kompensimit në rastet kur toka nuk do të mund t'i kthehet paditësit, por zbatohet vetëm në paditë e parashtruara **jo më vonë se 10 vite pas hyrjes në fuqi**. Prandaj, ky ligj nuk ishte i zbatueshëm për asnjërën nga 15 vendimet (të cilat ishin paraqitur pas vitit 2001).*

74. h) Sistemi i caktimit të lëndëve

75. Në Gjykatën Komunale ka ekzistuar një sistem i caktimit të lëndëve. Në periudhën përkatëse, kanë qenë 11 gjyqtarë të lëmisë civile në Gjykatë - 9 gjyqtarë shqiptarë dhe 2 gjyqtarë serbë. Dy gjyqtarët serbë ishin O.J. dhe T.M.. Secilit gjyqtar të Gjykatës Komunale i caktohej numri i tij/saj nga numri 1 deri në numrin 11.<sup>13</sup> O.J. e kishte numrin 3, T.M. e kishte numrin 10, S.M. e kishte numrin 1, S.S. e kishte numrin 2.

76. Kur pranoheshin lëndët ,iu ipej një numër i lëndës bazuar në datën e marrë dhe numrin e gjyqtarit. Numrat e gjyqtarëve caktoheshin në mënyrë kronologjike. Pastaj lëndët caktoheshin për secilin gjyqtar bazuar në shifrat e fundit të numrit të lëndëve. Për shembull, gjyqtarit të cilit iu kishte caktuar numri 3 do të merrte të gjitha lëndët që përfundonin me shifrën 3.

77. N.U., si Kryetar i Gjykatës Komunale, ishte përgjegjës për ndarjen e lëndëve

78. Lëndët e tokave iu caktoheshin gjyqtarëve jashtë rregullit dhe në kundërshtim me sistemin e caktimit të lëndëve<sup>14</sup>. Nga rastet që janë subjekt i kësaj aktakuze, O.J. ka paraqitur vendime në nëntë nga 15 rastet, ndërsa në shtatë prej tyre vërehen shifrat e

<sup>12</sup> Dosja e prokurorisë 15, ff 215 - 222

<sup>13</sup> Deklarata e dëshmitares B.K., Dosja e prokurorisë 5 tabi 4.

<sup>14</sup> Prova e dëshmitares B.K. e dëgjuar me 20 shkurt 2014 dhe N.H. i dëgjuar me 25 shkurt 2014.

gjyqtarëve të tjerë. S.M. kishte paraqitur vendime në dy prej 15 rasteve ndërsa në një të tretën nuk vërehet shifra e saj. T.M. iu kishin caktuar tri prej 15 rasteve dhe që në të tri lëndët vëreheshin shifrat e gjyqtarëve të tjerë. S.S. vendosi në një lëndë, ndërsa në bazë të shifrës vërehet se lënda duhej të ishte caktuar për O.J.

79. Këto shkelje në sistemin normal të caktimit të lëndëve ishin pjesë e një modeli më të gjerë të shkeljes së procedurës së përcaktuar kur lënda ka përfshirë NSH KBI. Nga analiza e librave të regjistrit vërehet se Gjykata Komunale ka marrë një total prej 322 padive që përfshijnë NSH KBI gjatë periudhës 2002-2007. O.J. iu kishin caktuar 60 raste, nga të cilat në 33 prej tyre vëreheshin shifrat e gjyqtarëve të ndryshëm. T.M. kishte pranuar 32 raste, prej të cilave 19 kishin shifrat e gjyqtarëve të ndryshëm. S.M. kishte pranuar 40 raste, prej të cilave 12 kishin shifrat e gjyqtarëve të ndryshëm. Për krahasim, gjyqtarët në Gjykatën Komunale të cilët ishin duke e zbatuar ligjin në mënyrë korrekte nuk kishin marrë kaq shumë lëndë që nuk korrespondojnë me shifrat e tyre - M.S. kishte pranuar 29 lëndë, nga të cilat vetëm një lëndë nuk korrespondojnë me shifrën e saj; M.K. kishte pranuar 25 raste, nga të cilat 4 nuk korrespondojnë me shifrën e saj.

80. Përveç caktimit të lëndëve që përfshijnë NSH KBI tek gjyqtarët me numër të gabuar, një shkelje e mëtejshme e procedurës normale të caktimit të lëndëve ka ndodhur me caktimin e lëndëve të *njëpasnjëshme* për të njëjtin gjyqtar; O.J. ka pranuar *lëndë të njëpasnjëshme* në të cilat ishte e përfshirë NSH KBI<sup>15</sup>, e cila nuk ishte normale në caktimin e lëndëve<sup>16</sup>. Këto ishin numrat e lëndës 1454 e pasuar nga 1455 në 2004, 2355 e pasuar nga 2356 në 2005, 292 e pasuar nga 293 në 2006, dhe 1292 dhe 1293, si dhe 1918 dhe 1919 në 2007<sup>17</sup>.

81. Këto lëndë nuk ishin gjykuar në mënyrë kronologjike, që ishte në kundërshtim me procedurën standarde. Disa llojeve të lëndëve iu jepej përparësi, për shembull ato lëndë që përfshinin dhunën në familje, alimentacionin, pengim posedimin dhe punësimin.

Lëndët e tokave nuk ishin lëndë me prioritet. Ka ekzistuar një vjetërsim i lëndëve në Gjykatën Komunale, por lëndët e tokave edhe atëherë ishin gjykuar shpejt, pavarësisht nga fakti se këto lëndë nuk ishin lëndë me prioritet.

82. I) Vendimet

83. Vendimet të cilat janë subjekt i kësaj aktakuze përbëhen nga 14 vendimet e lëshuara nga gjyqtarët në Gjykatën Komunale të Prishtinës dhe një vendim mbi ankesën e paraqitur nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës.

84. Në secilin vendim ka pasur shkelje të ligjit procedural dhe substancial.

- Të gjitha 14 rastet janë gjykuar nga gjyqtarët në Gjykatën Komunale në Prishtinë, pa ndonjë referim nga DHPGJS-së, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13.
- Në të gjitha rastet përveç njëjës, asnjë njoftim lidhur me padinë nuk i ishte dorëzuar AKM-së para se të lëshohej vendimi në shkelje të Rregullores 2002/12.
- Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka vendosur lidhur me një ankesë pa juridiksion, në kundërshtim me Rregulloren 2002/13.
- Secila padi ishte e bazuar në *Ligjin mbi Detyrimet*, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 29/78. Siç

<sup>15</sup> Dosja e prokurorisë 16

<sup>16</sup> Prova e dëshmitarit N.H.

<sup>17</sup> Dosja e prokurorisë 16



ishite përcaktuar më sipër në paragrafin (e), në të gjitha 15 rastet paditë ishin lidhur me obligimet / kontratat e lidhura në vitet 1950 dhe 1960, dhe për këtë arsye *Ligji mbi Detyrimet* nuk ishte ligj i zbatueshëm.

- Gjatë procedurave, gjyqtarët nuk arritën të sigurojnë prova dhe fakte në mënyrë që të vendosin se paditësit kanë qenë pronarë të ligjshëm të pronave të kërkuara, dhe kanë dështuar që të konfirmojnë vërtetësinë e kontratave për shitblerje, në të cilat paditë ishin të bazuara. Gjyqtarët kanë dështuar që të konfirmojnë vërtetësinë e certifikatave të vdekjes të cilat janë dorëzuar në gjykatë si provë se paditësit ishin pronarë të vërtetë të tokave.
- Tokë për ndërrim ishte dhënë që nuk ishte një mjet juridik i paraparë me Rregulloren 2002/13 apo ndonjë ligj tjetër në fuqi.
- Toka ishte dhënë si kompensim, që nuk ishte një mjet juridik i paraparë me Rregulloren 2002/13 apo ndonjë ligj tjetër në fuqi.

85. Përveç shkeljeve procedurale dhe substanciale të ligjit, ka qenë edhe një parregullsi tjetër në të gjitha 15 rastet. H.B. ka pretenduar të jetë përfaqësuese ligjore për NSH KBI, pavarësisht nga fakti se NSH KBI ka pushuar së ekzistuari si etnitet juridik në vitin 1997 dhe se ajo ishte konsideruar si tepriçë teknologjike nga NSH Ferma e derrave në nëntor të vitit 2006. Ajo i ofroi gjykatës letër autorizimet që konfirmojnë përfaqësimin e saj, të cilat ishin të nënshkruara nga I.H. i cili pretendonte të jetë Drejtor i NSH KBI.

86. Vendimet janë paraqitur më poshtë:

87. **Lënda 1314/07**<sup>18</sup>

88. Padia ishte paraqitur më 29 maj 2007 dhe vendosur më 12 korrik 2007.

89. Paditësi ishte B.T., i cili pretendonte se ishte trashëgimtar i gjyshit të tij, D.T.. Ai pretendonte se gjyshi i tij ishte i detyruar që t'ia shiste tokën NSH KBI në vitin 1963. Padia kërkonte që të anulohet kontrata lidhur me 1,7016 hektarë tokë.

90. AKM-së nuk i ishte dorëzuar asnjë njoftim lidhur me padinë.

91. Kërkesa ishte vendosur nga O.J.. Një prej gjyqtarëve porotë ishte F.T.i, i cili dha dëshminë si dëshmitar në këtë rast. B.T. ka përfaqësuar veten. H.B. ka pretenduar të jetë përfaqësuese ligjore për NSH KBI.

92. B.T. ka paraqitur një certifikatë të lindjes për të dëshmuar identitetin e tij. Certifikata e lindjes ishte lëshuar më 14 qershor 2007 dhe data e lindjes së tij "ishite vërtetuar" si 24 janar 1976.

93. Gjatë procedurës, O.J. ka dëgjuar dëshminë se D.T. ishte nën presion që t'ia shes tokën e tij kooperativës bujqësore. Dëshmia ishte e përgjithshme dhe e paqartë dhe një nga dëshmitarët R.M. tanimë kishte dëshmuar në një rast të ngjashëm (nr. 429/05). Vendim mbi trashëgiminë nuk ishte futur në prova që të shërbejë si dëshmi se B.T. ishte trashëgimtar i D.T. Gjatë procedurës, nuk kishte asnjë pyetje lidhur me çështjen e juridiksionit.

94. O.J. nxorri një vendim lidhur me këtë lëndë. Vendimi "anuloi" kontratën e shitblerjes të vitit 1963 dhe i dha B.T. "ngastra zëvendësuese" të tokës përgjatë autostradës Prishtinë-

---

<sup>18</sup> Dosja e prokurorisë 7-12

Shkup. B.T. ishte urdhëruar që t'ia paguajë NSH KBI-së shumën prej 813,25 Euro.

95. Nuk ka pasur asnjë ankesë kundër vendimit. Vendimi u zbatua nga Zyra Kadastrale Komunale në Graçanicë më 9 nëntor 2010 dhe e drejta e pronësisë së paditësit ishte regjistruar. Më pas, B.T. shiti një pjesë të madhe të tokës së dhënë për shumën prej 448.000,00 euro.

96. **Lënda 1698/05**<sup>19</sup>

97. Padia ishte paraqitur më 7 shtator 2005 nga M.Z.V..

98. Paditësi ishte përfaqësuar nga H.G.. H.B. pretendonte se e përfaqësonte NSH KBI-në.

99. AKM-së nuk i ishte dorëzuar asnjë njoftim lidhur me padinë.

100. S.M., në cilësinë e saj si gjyqtare në Gjykatën Komunale në Prishtinë e ka gjykuar këtë lëndë dhe ka lëshuar një vendim më 15 shkurt 2007. Ajo u shpreh se paditësi ishte nën presion për t'ia shitur tokën KBI-së dhe ia kishte dhënë 1,1933 hektarë tokë për zëvendësim, sasinë e tokës të cilën paditësi e kishte fillimisht në pronësi. Paditësi ishte urdhëruar që t'ia paguajë 870,63 euro në kompensim KBI-së. Më 23 shkurt 2007, S.M. nxorri aktgjykimin e përmirësuar i cili i dha 1,2934 hektarë, një shtesë prej 0,1 hektarë tokë, pa kurrfarë shpjegimi.

101. Asnjë ankesë nuk ishte parashtruar. Zyra Kadastrale Komunale e Graçanicës nuk ka pranuar ndonjë padi për të regjistruar ngastrat e tokës<sup>20</sup>.

102. **Lënda 53/06**<sup>21</sup>

103. Kjo padi ishte parashtruar më 19 janar 2006 dhe vendimi ishte lëshuar më 26 qershor 2007.

104. Paditësja, V.M., pohoi se ajo ishte trashëgimtare e babait të saj. Ajo pretendonte se babai i saj ishte i detyruar që t'ia shes tokën kooperativës bujqësore NSH KBI në vitin 1962. Padia kërkonte që të anulohet kontrata e vitit 1962 në lidhje me tri pjesë të tokave. Në shkresat e lëndë nuk ishte gjetur asnjë provë mbi identitetin e V.M.. Vendim mbi trashëgiminë nuk ishte futur si provë që të shërbejë si dëshmi se V.M. ishte trashëgimtare e tokës së kërkuar.

105. Kërkesa ishte vendosur nga O.J.. V.M. u përfaqësua nga G.G.. H.B. ka pretenduar të jetë përfaqësuese ligjore e NSH KBI.

106. O.J. kishte paraqitur vendimin më 26 qershor 2007. Vendimi "anuloi" kontratën e vitit 1962 dhe i dha dy ngastra për zëvendësim që gjendeshin në autostradën Prishtinë-Shkup. Prona e përgjithshme e dhënë, duke përfshirë edhe tokën që u dha si kompensim, ishte 1.4332 hektarë. V.M. ishte urdhëruar që t'ia paguajë KBI NSH-së shumën prej 976,90 euro.

107. Asnjë ankesë nuk ishte parashtruar kundër aktgjykimit. Zyra Kadastrale Komunale në Graçanicë nuk e ka zbatuar vendimin, dhe ende ekzistojnë tri ngastra të regjistruara si

---

<sup>19</sup> Dosja e prokurorisë 7

<sup>20</sup> Prova e N.M., 7 prill 2014

<sup>21</sup> Dosja e prokurorisë 7

Kosovo Eksport dhe një parcelë e katërt e regjistruar në emër të një pale të tretë.<sup>22</sup>

108. **Lënda 429/05**<sup>23</sup>

109. Kjo padi ishte paraqitur më 24 mars 2005 dhe vendimi ishte lëshuar më 25 qershor 2007.

110. Padiësit, N.D. dhe J.D., pretenduan se ishin trashëgimtarë të babait të tyre dhe gjyshit. Padiësit pretenduan se babai i tyre dhe gjyshi kishin qenë nën presion që ta shesin tokën. Padia kërkonte që të anulohen kontratat në mes të babait të tyre, gjyshit dhe NSH KBI, të cilat ishin lidhur në vitin 1983, 1980, 1964 dhe 1963. Vendimi mbi trashëgiminë nuk gjendet në shkresat e lëndës.

111. Padia ishte vendosur nga O.J.. N.D. dhe J.D. ishin përfaqësuar nga G.G.. H.B. ka pretenduar të jetë përfaqësuese ligjor për NSH KBI.

112. Dëshmia në lidhje me detyrimin ishte e përgjithësuar dhe nuk ishte specifike cilës datë/kontratë ajo i referohej.

113. O.J. lëshoi një vendim në këtë lëndë. Vendimi "anuloi" kontratat dhe i dha padiësve një shumë prej 3,4442 hektarë tokë. N.D. dhe J.D. u urdhëruan që t'i paguajnë NSH KBI vlerën prej 4,467.57 Euro.

114. Me 19 korrik 2007 në Gjykatën e Qarkut ishte paraqitur një ankesë nga I.H. në kundërshtim me Rregulloren 2002/13. Si bazë të saj, ankesa përmendi mungesën e juridiksionit të Gjykatës Komunale. Ankesa ishte tërhequr nga I.H. më 23 korrik 2007, pa përmendur ndonjë arsye .

115. Vendimi nuk ishte implementuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Graçanicës.<sup>24</sup>

116. **Lënda 3/06**<sup>25</sup>

117. Kjo padi ishte paraqitur më 1 shkurt 2006 dhe vendimi ishte lëshuar më 29 janar 2007. Një aktgjykim plotësues ishte paraqitur më 9 korrik 2007.

118. Padiësi, Mi.D., pohoi se ai ishte trashëgimtar i babait të tij. Ai pohoi se babai i tij kishte qenë në presion për t'ia shitur tokën NSH KBI. Padia kërkonte që të anulohen katër kontratat për shitjen e tokës që ishin lidhur në mes të babait të tij dhe NSH KBI gjatë vitit 1962 dhe 1965. Në shkresat e gjykatës nuk ka asnjë vendim mbi trashëgiminë për të dëshmuar se Mi.D. ishte trashëgimtar i tokës së pretenduar.

119. AKM-së nuk i ishte dorëzuar asnjë njoftim lidhur me padinë.

120. Kërkesa ishte vendosur nga O.J.. Mi.D. u përfaqësua nga Ma.D.. H.B. ka pretenduar të jetë përfaqësuese ligjore për NSH KBI.

121. O.J. lëshoi një vendim në këtë rast më 29 janar 2007. Vendimi "anuloi" katër kontratat dhe i dha një total prej 2,7102 hektarë tokë, duke përfshirë 0,2826 ha të dhëna si kompensim. Mi.D. u urdhërua që t'ia paguajë KBI NSH shumën prej 3,983.20 Euro.

---

<sup>22</sup> Prova e N.M., 7 prill 2014

<sup>23</sup> Dosja e prokurorisë 8

<sup>24</sup> Prova e N.M., 7 prill 2014

<sup>25</sup> Dosja e prokurorisë 8

122. O.J. nxorri një vendim plotësues, më 9 korrik 2007. Ky vendim i referohej një kontrate të pestë të lidhur në vitin 1972. Vendimi plotësues anuloi kontratën e vitit 1972 dhe u dhanë toka shtesë. Padiësi nuk ishte urdhëruar që të paguajë ndonjë kompensim për kontratën e vitit 1972.
123. Asnjë ankesë nuk ishte parashtruar. Zyra Kadastrale Komunale në Graçanicë nuk e ka zbatuar vendimin.<sup>26</sup>
124. **Lënda 1849/06**<sup>27</sup>
125. Kjo padi ishte paraqitur më 06 tetor 2006 dhe vendimi u lëshua më 10 korrik 2007.
126. Padiësi, Z.M. pohoi se ishte trashëgimtar i babait të tij, për të cilin ai pretendonte se kishte qenë nën presion që ta shes tokën. Padia kërkonte që të anulohen kontratat në mes të babait të tij dhe NSH KBI. Vendimi mbi trashëgiminë nuk gjendet në shkresat e lëndës.
127. AKM-së nuk i ishte dorëzuar asnjë njoftim lidhur me padinë.
128. Padia ishte vendosur nga O.J.. Z.M. u përfaqësua nga G.G., megjithatë G.G. tërhoqi përfaqësimin e tij pak para se aktgjykimi ishte paraqitur dhe emri i tij nuk duket në vendim. H.B. ka pretenduar të jetë përfaqësuese ligjore e NSH KBI.
129. O.J. kishte lëshuar një vendim në këtë rast. Vendimi i dha 0,7444 hektarë tokë padiësit, dhe një tokë shtesë prej 0,16 hektarë si kompensim.
130. Asnjë ankesë nuk ishte parashtruar. Zyra Kadastrale Komunale e Graçanicës nuk e ka marrë padinë për regjistrimin e vendimit. Tri ngastrat janë të regjistruara në emër të palëve të treta dhe një parcelë nuk ishte e regjistruar në Zyrën Kadastrale të Komunës së Graçanicës.<sup>28</sup>
131. **Lënda 1147/06**<sup>29</sup>
132. Me 14 qershor dhe 15 qershor 2006 janë paraqitur dy padi. Vendimi u lëshua më 09 maj 2007.
133. Padiësja, O.S., pohoi se ajo ishte trashëgimtare e babait të saj dhe gjyshit. Padiësja pretendoi se babai i saj dhe gjyshi kishin qenë nën presion për shitjen e tokës. Padia kërkonte që të anulohen kontratat në mes babait të saj, gjyshit dhe NSH KBI që ishin lidhur në vitin 1963 dhe 1967.
134. Edhe pse ishin paraqitur disa certifikata të lindjes dhe të vdekjes, asnjë vendim mbi trashëgiminë nuk gjendet në shkresat e lëndës.
135. Padia ishte vendosur nga O.J.. Padiësi u përfaqësua nga E.G., i cili u zëvendësua nga G.G. gjatë procedurës. H.B. ka pretenduar të jetë përfaqësuese ligjore për NSH KBI.
136. Më 01 shkurt 2007, G.G. e njoftoi AKM-në për padinë.
137. Dëshmia nëse shitësit ishin nën presion për t'a shitur tokën ishte i paqartë dhe jo-specifik.

---

<sup>26</sup> Prova e N.M., 7 prill 2014

<sup>27</sup> Dosja e prokurorisë 8

<sup>28</sup> Prova e N.M.

<sup>29</sup> Dosja e prokurorisë 12

138. O.J. nxorri një vendim në këtë rast. Vendimi "anuloi" kontratat dhe i dha paditëses një shumë prej 1,3557 hektarë tokë për zëvendësim. Paditësja ishte urdhëruar që t'ia paguajë NSH KBI vlerën prej 2,333.67 Euro.
139. Me 04 qershor në Gjykatën e Qarkut ishte paraqitur një ankesë kundër vendimit, në kundërshtim me Rregulloren 2002/13. I.H. tërhoqi ankesën më 12 korrik 2007.
140. Vendimi nuk ishte implementuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Graçanicës; dy ngastrat janë të regjistruara nën emrin e palëve të treta, një parcelë nën Komunën e Graçanicës dhe një parcelë nën Kosovo Export.
141. **Lënda 3521/04**<sup>30</sup>
142. Kjo padi ishte paraqitur më 23 dhjetor 2004 dhe vendimi ishte lëshuar më 15 tetor 2007.
143. Paditësja, D.P., pohoi se ishte trashëgimtare e babait të saj, për të cilin ajo pretendonte se kishte qenë nën presion për shitjen e tokës. Padia kërkonte që të anuloheshin kontratat për shitjen e tokës të lidhura nga i ati i saj dhe NSH KBI në 1961, 1962 dhe 1964. Vendimi mbi trashëgiminë nuk gjendet në shkresat e lëndës.
144. Padia ishte vendosur nga O.J.. Paditësja u përfaqësua nga Q.Q.. H.B. ka pretenduar të jetë përfaqësuese ligjore për NSH KBI.
145. Padia ishte paraqitur më 23 dhjetor 2004, por asnjë veprim nuk u ndërmor në këtë rast deri më 15 tetor 2007 kur pastaj ishte vendosur brenda katër muajve. Më 11 qershor 2007, 21 shtator 2007, 28 shtator 2007 dhe 15 tetor 2007 u mbajtën katër seanca. Dëshmia e dhënë në Gjykatë nëse shitësi ishte i detyruar për të bërë shitjen ishte e paqartë.
146. H.B. nuk ishte e pranishme gjatë seancës gjyqësore më 11 qershor 2007. O.J. kishte emëruar një ekspert gjeodet dhe kishte kryer një inspektim në terren pa qenë e pranishme H.B.. H.B. nuk ishte e pranishme edhe gjatë seancës gjyqësore më 21 shtator 2007. O.J. emëroi një ekspert financiar jashtë seancës gjyqësore. H.B. u paraqit në gjykatë për herë të parë më 28 shtator 2007. Ajo nuk e kundërshtoi mbajtjen e seancave të mëparshme, emërimin e ekspertit të gjeodezisë apo ekspertin financiar.
147. O.J. kishte lëshuar një vendim në këtë rast më 15 tetor 2007. Vendimi "anuloi" kontratat dhe i dha paditëses 1,5858 hektarë tokë, duke përfshirë edhe një pjesë për zëvendësim, dhe i dha një shtesë prej 0,9196 hektarë si kompensim. Paditësja ishte urdhëruar që t'ia paguajë NSH KBI shumën prej 297,43 Euro.
148. Asnjë ankesë nuk u paraqit lidhur me këtë vendim. Njoftimi i ishte dhënë AKM-së në dhjetor të vitit 2007, pasi që vendimi ishte lëshuar.
149. Vendimi nuk ishte implementuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Graçanicës. Katër ngastrat janë të regjistruara në emrat e palëve të treta, dhe dy ngastrat janë të regjistruar nën Kosovo Export<sup>31</sup>

<sup>30</sup> Dosja e prokurorisë 9

<sup>31</sup> Prova e N.M., 7 prill 2014

150. **Lënda 1415/2005**<sup>32</sup>

151. Kjo padi ishte paraqitur më 10 gusht 2005 dhe vendimi ishte lëshuar më 28 shtator 2007.
152. Padiësi, M.P., kërkoi që të anulohet kontrata për shitjen e tokës që ishte lidhur në vitin 1964. Asnjë vendim mbi trashëgiminë nuk u gjend në shkresat e lëndës.
153. Padi ishte vendosur nga O.J.. Padiësi u përfaqësua nga G.G., i cili u bë përfaqësuesi i autorizuar për padiësin më 18 shtator 2006.
154. O.J. lëshoi një vendim në këtë rast më 28 shtator 2007. Vendimi "anuloi" kontratën dhe i dha 0,58 hektarë tokë, dhe 0,41 hektarë tokë si kompensim.
155. Vendimi nuk ishte kundërshtuar. Vendimi nuk ishte implementuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Graçanicës.

156. **Lënda 1738/07**<sup>33</sup>

157. Padi ishte paraqitur më 20 shtator 2007 dhe vendimi ishte lëshuar më 19 nëntor 2011.
158. Padiësit, B.J., M.J., T.J., R.J. dhe I.J. kërkuan që të anulohet kontrata për shitjen e tokës e cila ishte lidhur në vitin 1961. Asnjë vendim mbi trashëgiminë nuk u gjend në shkresat e lëndës.
159. Padi ishte vendosur nga O.J.. Padiësi u përfaqësua nga M.G.. H.B. ka pretenduar të jetë përfaqësuese ligjore NSH KBI.
160. Dëshmia nëse shitësi ishte i detyruar ishte e paqartë dhe e përgjithësuar. Gjatë seancave gjyqësore, avokati i padiësve informoi gjykatën se AKM-ja ishte e njoftuar.
161. O.J. kishte lëshuar një vendim në këtë rast më 19 nëntor 2007. Vendimi "anuloi" kontratën dhe i dha një copë tokë prej 0,54 hektarë tokë për zëvendësim përgjatë rrugës Prishtinë-Shkup. Padiësit u urdhëruan që t'ia paguajnë NSH KBI shumën prej 241,35 Euro. Vendimi nuk u kundërshtua.
162. Vendimi u zbatua nga Zyra Kadastrale në Graçanicë dhe e drejta e pronësisë së tokës ishte regjistruar në emër të R.J.<sup>34</sup>

163. **Lënda 1908/3**<sup>35</sup>

164. Padi ishte paraqitur më 28 tetor 2003 dhe vendimi ishte lëshuar më 19 dhjetor 2006.
165. Padiësit, L.V., S.D., R.A. dhe A.F. kërkuan që të anulohet kontrata mbi dhurimin e tokës e cila ishte lidhur me 1959 në lidhje me 1,0343 hektarë tokë. Padiësit pretenduan se paraardhësi i tyre u detyrua që t'a dhuronte tokën nën politikën e ish-qeverisë jugosllave për shkak të punësimit të tij në një minierë. Asnjë vendim mbi trashëgiminë nuk u gjend në shkresat e lëndës. Në dosjen e gjykatës nuk ka asnjë njoftim për AKM-në.
166. AKM-së nuk i ishte dorëzuar asnjë njoftim lidhur me padinë.

---

<sup>32</sup> Dosja e prokurorisë 9

<sup>33</sup> Dosja e prokurorisë 9

<sup>34</sup> Prova e N.M. , 7 prill 2014

<sup>35</sup> Dosja e prokurorisë 10

167. Padia ishte vendosur nga T.M.. Paditësit u përfaqësuan nga E.G.. H.B. ka pretenduar të jetë përfaqësuese ligjore për NSH KBI.
168. T.M. kishte lëshuar një vendim në këtë rast më 19 dhjetor 2006. Vendimi "anuloi" kontratën dhe ai dhuroi ngastra të tokës për zëvendësim. NSH KBI u urdhërua që të paguajë shpenzimet gjyqësore në shumë prej 608,40 Euro. Paditësit nuk u urdhëruan që të paguanin ndonjë shumë për kthim.
169. Vendimi u kundërshtua nga NSH KBI në Gjykatën e Qarkut, edhe pse juridiksioni nuk ishte ngritur si bazë për ankesë. Ankesa ishte nënshkruar nga I.H.. Ankesa ishte tërhequr pa shpjegim.
170. Vendimi nuk ishte implementuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Graçanicës.<sup>36</sup>
171. **Lënda 342/06**<sup>37</sup>
172. Padia ishte paraqitur më 13 mars 2006 dhe vendimi ishte lëshuar më 23 mars 2007.
173. Paditësit (A.O. dhe të tjerët) paraqitën një padi kundër një numri të individëve privatë e cila u zgjerua më 29 nëntor 2006 dhe e përfshinte NSH KBI si të paditur.
174. Padia ishte vendosur nga T.M.. Paditësit u përfaqësuan nga E.G.. H.B. ka pretenduar të jetë përfaqësuese ligjore për NSH KBI.
175. T.M. kishte lëshuar një vendim në këtë rast më 29 nëntor 2006. Vendimi i kishte dhënë ngastër për zëvendësim prej 1,01 hektarë tokë. NSH KBI u urdhërua që të paguajë shpenzimet gjyqësore në shumë prej 608,40 Euro.
176. AKM-ja kishte paraqitur ankesë në DHPGJS me 11 mars 2008.
177. Toka nuk i takon juridiksionit të Zyrës Kadastrale Komunale të Graçanicës.
178. **Lënda 1918/06**<sup>38</sup>
179. Padia ishte paraqitur më 17 tetor 2006. Vendimi ishte lëshuar më 6 qershor 2007.
180. Paditësit, J.M. dhe S.I.M. paraqitën një padi kundër NSH KBI.
181. Avokati i parë i paditësve, S.C., ka paraqitur padinë në DHPGJS-së, në përputhje me ligjin në fuqi. Me një vendim të DHPGJS-së, SCC-06-0223 të datës 21 qershor 2006, DHPGJS-ja referoi padinë për një parcelë toke në Gjykatën Komunale. G.G. mori përsipër përfaqësimin e kësaj lënde, pasi që ajo ishte referuar në Gjykatën Komunale. Padia u la në gjendje pasive për një vit, para se G.G. të paraqiste prapë të njëjtën ankesë drejtpërdrejt në Gjykatën Komunale të Prishtinës. Prandaj, i njëjti rast ishte regjistruar për herë të dytë dhe morri numrin e lëndës së re (1896/07). Përveç kësaj, G.G. paraqiti një padi të dytë që përfshinte të njëjtin paditës por me ngastra të ndryshme të tokës. Ky rast ishte paraqitur gabimisht në Gjykatën Komunale dhe lëndës i ishte dhënë numër i ri i lëndës 1918/16. DHPGJS nuk i ishte dorëzuar njoftimi lidhur me këtë ndryshim në ngastrën e tokës, dhe Gjykata Komunale nuk kishte kërkuar leje nga DHPGJS për të vendosur lidhur me këtë parcelë tjetër të tokës.

<sup>36</sup> Prova e N.M. , 7 prill 2014

<sup>37</sup> Dosja e prokurorisë 10

<sup>38</sup> Dosja e prokurorisë 12

182. Padia ishte vendosur nga T.M.. Padi tësit u përfaqësuan së pari nga S.C., i cili u zëvendësua nga G.G..
183. T.M. kishte lëshuar një vendim në këtë rast më 6 qershor 2007. Vendimi i kishte dhënë një tokë për zëvendësim e cila kishte 1,1034 hektarë në afërsi të autostradës Prishtinë /Shkup. NSH KBI u urdhërua që të paguajë shpenzimet gjyqësore në shumë prej 608,40 Euro. Padi tësit nuk u urdhëruan që të paguajnë ndonjë shumë për kthim.
184. Vendimi u kundërshtua nga NSH KBI më 27 qershor 2007. Ankesa ishte nënshkruar nga I.H. dhe u tërhoq më 24 shtator 2007 pa ndonjë shpjegim.
185. Vendimi nuk ishte implementuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Graçanicës.<sup>39</sup>
186. **Lënda 251/04**<sup>40</sup>
187. Padia ishte paraqitur më 23 prill 2003 dhe vendimi ishte lëshuar më 19 qershor 2007.
188. Padi tësi, R.G., kërkoi që të anulohet kontrata e tokës në lidhje me 0,65 hektarë. Padia iu referua një aktgjykimi i cili ishte lëshuar në 1996, për të cilën padi tësi tha se nuk ishte i plotë pasi që një parcelë e veçantë e tokës nuk ishte marrë parasysh. Prandaj padi tësi ka paraqitur një padi të re më 23 prill 2003, për të cilën ligj i zbatueshëm ishte Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 dhe 2002/13.
189. AKM-së nuk i ishte dorëzuar asnjë njoftim lidhur me padinë.
190. Padia ishte vendosur nga S.M.. Padi tësi u përfaqësua për herë të parë nga H.G., i cili u zëvendësua më pas nga A.G.. NSH KBI u përfaqësua për herë të parë nga Ismajil Osedautaj, i cili u zëvendësua më pas nga H.B.. H.B. nuk ishte e pranishme gjatë seancave gjyqësore të 3 qershorit 2004 ose 7 tetorit 2004. Ajo nuk mori pjesë në vizitën në terren më 11 Qershor 2004.
191. S.M. kishte lëshuar një vendim në këtë rast më 19 qershor 2007. Padia ishte vendosur në favor të padi tësit. Nuk kishte asnjë ankesë lidhur me këtë.
192. Vendimi nuk ishte implementuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Graçanicës.
193. **Lënda 2333/05**<sup>41</sup>
194. Padia ishte paraqitur më 30 nëntor 2005. Vendimi ishte lëshuar më 15 maj 2007.
195. Padi tësit, B.M., V.D., L.D., St.D. dhe T.D. kërkuan që të anulohen kontratat e tokës të vitit 1963, 1964 dhe 1970.
196. AKM-së nuk i ishte dorëzuar asnjë njoftim lidhur me padinë.
197. Padia ishte vendosur nga S.S.. Padi tësit u përfaqësuan nga Ma.D.. H.B. pretendonte të jetë përfaqësuese ligjore për NSH KBI.
198. S.S. kishte lëshuar një vendim në këtë rast më 15 maj 2007. Vendimi i dha 3,3084 hektarë tokë, dhe 0,1911 hektarë tokë si kompensim.
199. Vendimi u ndryshua nga N.U., më 14 shtator 2007. S.S. nuk e nënshkruajti vendimin pasi

---

<sup>39</sup> Prova e N.M., 7 prill

<sup>40</sup> Dosja e prokurorisë 11

<sup>41</sup> Dosja e prokurorisë 11



që ajo ishte në pushim mjekësor në atë kohë. N.U. e ka nënshkruar vendimin megjithëse nënshkrimi në emrin e S.S. mbeti i zbrazët.<sup>42</sup>

200. Gjatë rrjedhës së procedurës, H.B. e kundërshtoi vlerësimin e tokës së dhënë nga eksperti i emëruar financiar i gjykatës.
201. NSH KBI ka paraqitur ankesë (të nënshkruar nga I.H.) më 3 korrik 2007. Arsyet e cituara ishin mungesa e kompetencave të Gjykatës Komunale dhe mungesa e njoftimit të AKM-së. Ankesa ishte paraqitur në Gjykatën e Qarkut. Gjykata e Qarkut mbështeti vendimin e Gjykatës Komunale në aktgjykimin Ac. Nr. 604/03.
202. Ky vendim nuk u zbatua nga Zyra Kadastrale Komunale e Graçanicës<sup>43</sup>.
203. **Lënda e Gjykatës së Qarkut 604/2003**<sup>44</sup>
204. Më 3 korrik 2007, NSH KBI kishte paraqitur një ankesë lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Komunale 2333/05 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
205. Ankuesi paraqiti si bazë të ankesës çështjen e juridiksionit. Më 2 tetor 2007, RR.R., E.A. dhe F.B., në cilësinë e tyre si gjyqtarë në Gjykatën e Qarkut, vendosën lidhur me ankesën për aktgjykimin e Gjykatës Komunale 2333/05. Lidhur me çështjen e juridiksionit, Gjykata e Qarkut përmendi një vendim të DHPGJS-së, SCA-05-0104 dhe pohoi se në këtë vendim i cili përfshinte një kontest të ngjashëm, DHPGJS-ja ishte deklaruar të mos jetë kompetente për të vendosur lidhur me çështjen. Nga shqyrtimi i vendimit SCA-05-0104 shihet se ajo i referohet procesit lidhur me një rast të veçantë në Gjykatën Komunale, në bazë të autoritetit të saj për t'i referuar rastet e tokës në Gjykatën Komunale.
206. Gjykata e Qarkut lëshoi vendimin e saj më 2 tetor 2007. Aktvendimi hodhi ankesën si të pa-bazuar.
207. RR.R. ishte kryetari i trupit gjykues dhe ai e nënshkruajti aktvendimin. F.B. dhe E.A. morrën pjesë në shqyrtim e votuan vendimin dhe e nënshkruajtën procesverbalin e shqyrtimit.
208. J) Ekzekutimi i Transferimit nga Zyra Kadastrale
209. Në mënyrë që toka të transferohet tek paditësit e suksesshëm, vendimi i Gjykatës duhej të regjistrohej në regjistrat kadastral. Zyra Kadastrale ekzekutoi transferimin e tokës në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës. Kjo praktikë ishte aplikuar derisa DHPGJS-ja lëshoi një udhëzim për të gjitha zyrat kadastrale, të cilat udhëzonin Zyrën Kadastrale për të mos bërë transferimin e tokës së NSH tek një individ privat nëse nuk ka kopje të aktvendimit nga DHPGJS.
210. Vendimet e lëshuara nga O.J. në lëndën 1314/07 dhe lëndën 1738/07 u zbatuan nga Zyra Kadastrale e Graçanicës, dhe si rezultat transferimi i tokës tek paditësit ishte regjistruar në regjistrat kadastral.<sup>45</sup> B.T., paditësi i suksesshëm në lëndën 1314/07, më pas shiti një pjesë të madhe të tokës së dhënë për shumën 448,000.00 Euro. Toka në lëndën 1738/07 u transferua tek paditësi R.J., dhe informacionin të cilin e ka Zyra Kadastrale ishte se toka mbetet e regjistruar në emrin e tij dhe se nuk ka pasur ndonjë

<sup>42</sup>Dosja e prokurorisë 11, faqe 316-317

<sup>43</sup> Prova e N.M., 7 prill 2014

<sup>44</sup>Dosja e prokurorisë 11

<sup>45</sup> Prova e N.M., zyra kadastrale në Graçanicë, dëgjuar me 7 prill 2004.

ndërtim në tokë.

211. Transferimi i tokës i parashikuar në 13 vendimet tjera nuk u zbatua kurrë në të vërtetë nga Zyra Kadastrale. Arsyeja për këtë ishte se vendimet nuk përmbanin referimin e kërkuar nga DHPGJS-së, dhe ato nuk ishin të autorizuara nga AKM-ja; KBI NSH ishte vendosur nën administrimin e drejtpërdrejtë të AKM-së në nëntor 2007, në të cilën pikë Shefi i Njesisë Administrative refuzoi që të autorizoj çfarëdo toke për t'u transferuar te paditësit në rastet kundër NSH KBI.
212. N.U. kishte pyetur lidhur me refuzimin e AKM-së për të miratuar zbatimin e vendimeve. N.U. kontaktoi Shefin e atëhershëm të Njesisë Administrative të AKM-së dhe kërkoi një takim. Në takimin që u mbajt në Gjykatën Komunale të Prishtinës, N.U. pyeti në mënyrë të tërthortë se çfarë po e pengonte AKM-në që të jipte aprovimin që të ekzekutohen vendimet<sup>46</sup>.
213. k) Njësia e Inspektimit Gjyqësor dhe Njoftimi për AKM-në
214. Në dhjetor të vitit 2007, Njësia e Inspektimit Gjyqësor të UNMIK-ut ("NJIGJ "), sipas *detyrës zyrtare* ka hapur një hetim kundër N.U., O.J., S.M., T.M., S.S., RR.R., E.A. dhe F.B.. Hetimi u përqendrua në 15 raste të cilat janë subjekt i kësaj aktakuze. Diku në fund të vitit 2007, NJIGJ mori dosjet e lëndëve përkatëse të dymbëdhjetë lëndëve nga Gjykata Komunale e Prishtinës.
215. N.U. u përgjigj në shkresën e dërguar nga AKM-ja dhe e pranuar nga Gjykata Komunale më 26 Janar 2007 (shih paragrafin c) në një shkresë të datës 2 janar 2008. Në këtë kohë, të gjitha vendimet e marra nga gjyqtarët e Gjykatës Komunale që kishin qenë subjekt i kësaj aktakuze ishin lëshuar. N.U. i shkroi AKM-së duke deklaruar se ai kishte vendosur që dymbëdhjetë rastet të cilat përfshijnë NSH KBI ishin vendosur nga Gjykata Komunale pa referimin nga DHPGJS dhe pa njoftimin e AKM-së. Këto ishin 12 raste e njëjta për të cilat NJIGJ i kishte marrë dosjet e lëndës.

---

<sup>46</sup> Deklarata e S.N. -Dosja e prokurorisë 5

## E. ARSYETIMI LIGJOR

### I. Ligji në fuqi

216. Ngjarjet e vërtetuara më sipër kanë ndodhur diku midis viteve 2006 dhe 2007, kur ligji i zbatueshëm ishte Kodi Penal i Kosovës, i cili hyri në fuqi më 06 prill 2004 dhe titullohej 'Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës' (KPPK). Emri është ndryshuar më 06 nëntor 2008, kur u Kodi ishte riemëruar si 'Kodi Penal i Kosovës'. Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës (KPK) hyri në fuqi më 1 janar 2013<sup>47</sup>.
217. Si ligji i vjetër (KPPK) dhe ligji i ri (KPK) shprehin parimin e përbashkët se "ligji në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale do të zbatohet ndaj kryerësit."<sup>48</sup> Megjithatë, të dy ligjet shprehin një përjashtim: "Në rast se ligji në fuqi për një çështje të caktuar ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, ligji më i favorshëm apo më i favorshmi zbatohet ndaj kryerësit"<sup>49</sup>.
218. Trupi gjykues e interpretoi këtë duke përfshirë si elementët thelbësore të veprës penale dhe lartësinë dhe llogaritjen e dënimit të bashkuar po ashtu.
219. Neni 6 (2) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ"), Kushtetuta e Kosovës dhe neni 3 (1) të KPP-së parashikojë prezumimin e pafajësisë për të cilën të akuzuarit kanë të drejtë. Ky prezumim e vendos barrën e vërtetimit të fajësisë së të akuzuarve mbi prokurorinë, një barrë e cila mbetet mbi prokurorinë gjatë gjithë gjykimit.

### II. Përgjegjësia penale

220. Neni 11 (1) të KPPK-së dhe neni 17 (1) të KPK-së, përcaktojnë se një person është penalisht përgjegjës vetëm nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia".

### III. Veprat penale

#### i) *Nxjerrja e Kundërligjshme e Vendimeve Gjyqësore*

221. Pika 1 e aktakuzës i ngarkon të pandehurit për Nxjerrje të Kundërligjshme të Vendimeve Gjyqësore sipas nenit 346 të KPPK-së.
222. Neni 346 i KPPK-së parasheh që kjo vepër penale kryhet kur:
223. *Gjykatësi, gjykatësi laik ose gjykatësi për kundërvajtje i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër nxjerr vendim të kundërligjshëm dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet*
224. Vepra është përsëritur në nenin 432 të KPK-së në kushte të njëjta me një ndryshim të vogël; vepra vlen vetëm për gjyqtarët dhe jo për gjykatësin laik ose gjykatësin për kundërvajtje.

#### *Nxjerrja*

<sup>47</sup> Kodi Nr. 04/L-082

<sup>48</sup> Neni 2(1) të KPPK-së dhe neni 3(1) të KPK-së

<sup>49</sup> Neni 2 (2) të KPPK-së dhe neni 3 (2) të KPK-së, respektivisht.

225. Në lidhje me elementin e parë, nuk kishte asnjë mospajtim midis asnjërës prej palëve se të pandehurit që janë objekt i pikës së akuzës 1 në aktakuzë, ishin gjyqtarë në Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Në lidhje me S.M.n, O.J., T.M., dhe S.S.n, nuk kishte asnjë mospajtim që ata kishin lëshuar vendimet siç është përcaktuar në gjetjet faktike (S.S. ka lëshuar vendimin në rastin 2333/05, por nuk e ka ndryshuar).
226. Në lidhje me gjyqtarët e Gjykatës së Qarkut, RR.R., E.A. dhe F.B., të cilët e kishin gjykuar ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë në rastin 2333/05, çështja nëse gjyqtarët do të mund të mbaheshin përgjegjës për “nxjerrjen” e vendimit ndërkohë që vepronin anëtar të një trupi gjykues duhet të adresohet. Për shembull, a mundet që një gjyqtar të mbahet përgjegjës për lëshimin e vendimit nëse ai ose ajo nuk ka votuar për vendimin, por është mbivotuar nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues? Në rastin në fjalë, trupi gjykues ka gjetur se janë vërtetuar faktet se RR.R., E.A. dhe F.B. në fakt kishin votuar për vendimin e dhënë, dhe për këtë arsye kjo çështje nuk ka nevojë të shtjellohet më tej (shih paragrafin xxxx). Trupi gjykues nuk ka konsideruar se vetëm kryetari i trupit gjykues është personi përgjegjës për këtë rast. Sipas kodit procedural civil të aplikueshëm, të gjithë anëtarët e trupit gjykues duhet të votojnë dhe thjesht nuk i takon kryetarit të trupit gjykues të vlerësoj dhe gjykoj rastin vetëm. Në çdo rast, një pajtim i brendshëm dhe verbal i anëtarëve të trupit gjykues në lidhje me përgjegjësinë e vetme për rastin përkatës nuk ka ndikim në përgjegjësinë penale individuale të gjyqtarëve. E njëjta gjë mund të thuhet në lidhje me faktin se vetëm kryetari i trupit gjykues e ka nënshkruar versionin përfundimtar të aktgjykimit, dhe jo anëtarët e trupit gjykues.

*Vendimi i kundërligjshëm*

227. Në rastet e mëparshme ku përfshihet vepra penale e lëshimit të kundërligjshëm të vendimeve gjyqësore, gjyqtarët e EULEX-it janë shprehur se vendimi i kundërligjshëm duhet të jetë “në mënyrë të dukshme i gabuar” apo “në mënyrë të qartë i paligjshëm”.<sup>50</sup>
228. Komentari mbi veprën e Nxjerrjes së Kundërligjshme të Vendimit Gjyqësor thekson se “shkelje e ligjit mund të jetë ose një shkelje materiale të ligjit, ose një shkelje e ligjit procedural. Nuk ka rëndësi se çfarë lloji i procedurës është shkelur...”<sup>51</sup>
229. Trupi gjykues kishte konsideruar se testi që duhet zbatuar në rast shqyrtimi nëse një vendim ishte i kundërligjshëm, qoftë me anë të një shkeljeje procedurale ose një shkelje të së drejtës materiale, ishte nëse shkelja procedurale apo shkelja e së drejtës materiale kishte pasur ndonjë ndikim në rezultatin e pavarur të procedurës gjyqësore. Pyetja që duhet shtruar është: a ishte shkelja e ligjit procedural ose e ligjit material ‘neutrale’, apo e bëri atë të ketë një ndikim në rezultatin e pavarur të procedurës gjyqësore? Prandaj trupi gjykues ka konsideruar se prokuroria kishte për të provuar se shkelja e ligjit nga ana e gjyqtarëve të pandehur ka ndikuar në mënyrë thelbësore në rezultatin e çështjes. Ose, duke paraqitur të njëjtën pyetje nga një perspektivë tjetër: çfarë do të kishte qenë rezultati i çështjes nëse çështja ishte gjykuar nga DHPGJS si gjykatë kompetente? Në vijim nga kjo, dhe në kuptimin e këtij rezultati hipotetik, a mund të konsiderohet i

<sup>50</sup> Gjykata Komunale Prizren, P 955/19, Aktgjykimi, 3 qershor 2011; njëjtë Gjykata Komunale Prizren, P 917/10, Aktgjykimi, 7 tetor 2013.

<sup>51</sup> “Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentari, Botimi I”, Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, 2014

arsyeshëm vendimi i lëshuar nga ana e gjyqtarëve të pandehur, apo brenda gamës së vendimit gjyqësor të pranueshëm nga një këndvështrim objektiv?

230. Siç është përcaktuar në gjetjet faktike, është konstatuar se ka pasur shkelje të ligjit procedural; rastet u gjykuan sipas nga gjyqtarët e gjykatës komunale, pa ndonjë rekomandim nga DHPGJS-së, siç kërkohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13; dhe ankesa në rastin 2333/5 ishte vendosur nga Gjykata e Qarkut, e cila nuk kishte juridiksion sipas Rregullores 2002/13. Në shumicën e rasteve, nuk kishte asnjë njoftim për AKM-në për padinë kundër NSH KBI, siç kërkohet me Rregulloren 2002/12.
231. Më tej është vërtetuar se ka pasur shkelje të drejtës materiale; paditë dhe vendimet ishin të bazuara në Ligjin për Detyrimet. Siç është përcaktuar në gjetjet faktike, ndërsa gjyqtarët e pandehur kishin aplikuar Ligjin për Detyrimet në mënyrë retrospektive, DHPGJS-ja vendosi në të kundërtën, dhe hodhi poshtë paditë e tilla sepse Ligji për Detyrimet nuk ishte i zbatueshëm për detyrimet kontraktuale që ishin themeluar para se Ligji për Detyrimet të kishte hyrë në fuqi. Një shkelje tjetër e të drejtës materiale ka ndodhur, kur parcela të tokës si zëvendësim janë dhënë.
232. Prandaj trupi gjykues gjeti se shkeljet e ligjit procedural nuk ishin 'neutrale', sepse po të ishin gjykuar rastet në DHPGJS-së, paditë nuk do të ishin gjykuar në të njëjtën mënyrë siç është bërë nga gjyqtarët e pandehur. Shkelja e ligjit procedural, duke shmangur juridiksionin e DHPGJS-së, në këtë mënyrë ka mundësuar shkeljen e të drejtës materiale.
233. Ka një numër mënyrash sipas të cilave kjo është e dukshme: po të ishte njoftuar AKM-ja për paditë, një mbikëqyrje e duhur e aseteve të NSH-së KBI do të ishte siguruar. Së dyti, paditë do të ishin hedhur poshtë në bazë të jurisprudencës së përcaktuar të DHPGJS-së mbi paditë, bazuar në Ligjin për Detyrimet. Së treti, në rast se paditë ishin të suksesshme, atëherë parcelat e tokës si zëvendësim nuk do ishin dhënë pasi i vetmi mjet ligjor në dispozicion ishte kompensimi monetar.

*Me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore /shkaktim i dëmit*

234. Neni 11 i KPPK-së përcakton përgjegjësinë penale. Parashikohet se personi e kryen veprën penale "me dashje apo nga pakujdesia". Megjithatë, një person konsiderohet penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer nga pakujdesia vetëm nëse këtë shprehimisht e parashikon ligji (neni 11 paragrafi 3)<sup>52</sup>. As neni 346 i KPPK-së e as neni 432 i KPK-së nuk parashikojnë për kryesin e veprës penale të Nxjerrjes së Kundërligjshëm të Vendimeve Gjyqësore nga pakujdesia.
235. Neni 15 i KPPK- parashikon "dashjen". Nga ky nen parashikohet se:
- (1) *Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale.*
  - (2) *Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj.*
  - (3) *Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj."*<sup>53</sup>

<sup>52</sup> Përsëritur në nenin 17 të KPK-së

<sup>53</sup> Definicioni i qëllimit përcaktuar me nenin 15 të KPPK-së është përsëritur saktësisht në nenin 21 të KPK-së

236. Dashja, sipas nenit 11 dhe e përcaktuar në nenin 15 të KPPK-së, vlen për çdo veprë penale në kuadër të KPPK-së. Neni 346 i KPPK-së megjithatë drejtpërdrejt specifikon kuptimin e dashjes në lidhje me veprën penale nxjerrje e kundërligjshme e vendimit gjyqësor (në krahasim me qëllimin e përgjithshëm të aplikueshëm për të gjitha veprat penale), si specifikohet në nenin 432 të KPPK-së. Kjo veprë kërkon që të ketë, përveç qëllimit të përgjithshëm, një qëllim *specifik* për të shkaktuar dëm apo të marrjes së një përfitimi. Me fjalë të tjera, në mënyrë që të jetë penalisht përgjegjës, një person duhet të ketë kryer veprën qëllimisht por gjithashtu duhet të ketë kryer veprën në mënyrë që të përfitoj ose të shkaktoj dëm.
237. Prandaj duhet të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se personi e kishte për qëllim nxjerrjen e kundërligjshme të vendimit gjyqësor, dhe se arsyeja se personi e kishte marrë vendimin e kundërligjshëm ishte sepse qëllimi i tyre ishte i përfitimit të dobisë pasurore dhe/ose shkaktim i dëmit. Ky kusht paraprak i qëllimit të kundërligjshëm është i nevojshëm në mënyrë që të behet dallimi në mes të një vendimi që është marrë nga një gjyqtar i cili beson se ai/ajo është duke aplikuar ligjin në mënyrë korrekte, por i cili është gjetur më pas të jetë “i kundërligjshëm” nga gjykata e shkallës së dytë, dhe një vendim i cili duhet të sanksionohet penalisht. Prandaj një gjyqtar mund të nxjerr qëllimisht një vendim të “kundërligjshëm” (duke besuar në atë kohë se ai/ajo është duke e aplikuar ligjin në mënyrë korrekte) e cili nuk përbën veprë penale. Ky dallim është i një rëndësie të madhe dhe ekziston si i tillë për të ruajtur pavarësinë dhe lirinë e gjyqësorit, siç parashikohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
238. Nuk ka asnjë kusht paraprak që kjo duhet vërtetuar se vendimet e kundërligjshme në të vërtetë rezultuan në përfitim të dobisë pasurore apo i kanë shkaktuar dëme personit tjetër. Në këtë rast, vetëm në dy nga rastet, vendimet kishin çuar në ndryshim të titullit pronësor duke u ndryshuar në regjistrin kadastral, çka mundësoi pronësia e tokës ti transferohet paditësve. Fakti se në trembëdhjetë raste të tjera, bartjet nuk ishin proceduar përmes Zyrës Kadastrale, dhe se për këtë arsye nuk kishte asnjë bartje të tokës, është jomaterial gjatë përcaktimit të përgjegjësisë penale. Vepra penale është kryer kur vendimet janë bërë *me qëllim të fitimit të dobisë pasurore ose për të shkaktuar dëm*.
239. Në përmbledhje pastaj, trupi gjykues konsideron elementet e veprës penale të Nxjerrjes së kundërligjshme të vendimit gjyqësor, të jenë si vijon:
- A. Kryerësi i veprës është gjyqtar
  - B. Ai/Ajo lëshon një vendim të kundërligjshëm
  - C. Me qëllim të kryerjes së faktit, p.sh., me qëllim të nxjerrjes së vendimit të kundërligjshëm; DHE Me qëllim të caktuar për përfitim të dobisë per vete ose personin tjetër apo për të shkaktuar dëm.
240. Edhe pse trupi gjykues nuk ka gjetur asnjë provë të *drejtpërdrejtë* se gjyqtarët qëllimisht kanë nxjerrë një vendim të kundërligjshëm, d.m.th. nuk ka pasur dëshmi të paraqitura se gjyqtarët kishin njohuri të ligjit në fuqi dhe qëllimisht e kishin keq zbatuar ligjin, trupi gjykues ka gjetur se kjo ishte dëshmuar nga pesha kumulative e provave rrethanore. Në veçanti, trupi gjykues ka shqyrtuar njohuritë e stafit të gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës Komonale në Prishtinë sa i përket ligjit të aplikueshëm ose praktikës në lidhje me juridiksionin, faktin që gjyqtarët O.J., T.M. dhe S.S. dhe S.M. kishin zbatuar me korrektësi ligjin dhe kishin refuzuar juridiksionin në rastet e tjera, dhe fakti që gjyqtarët

e Gjykatës së Qarkut me qëllim kishin keqinterpretuar konstatimet e vendimit të DHPGJS-së, SCA-05-0104, në aktvendimin e tyre.

241. Në lidhje me qëllimin e caktuar (qëllimi i përfitimit të dobisë pasurore për vete ose një person tjetër, ose për t'i shkaktuar dëm një personi tjetër si arsye për marrjen e vendimit të kundërligjshëm) përsëri trupit gjykues nuk i është paraqitur ndonjë provë e drejtpërdrejtë rreth kësaj. Qëllimi i caktuar megjithatë mund të vërtetohet në shumë mënyra, duke përfshirë edhe përmes konkluzioneve logjike që mund të nxirren nga prova të tjera, duke përfshirë provat rrethanore. Në këtë rast, trupi gjykues mori parasysh shkeljen e qëllimshme të ligjit në lidhje me juridiksionin, praninë e shumë parregullsive në marrjen e vendimeve d.m.th. mos njoftimin e AKM-së, mungesën e dëshmimeve të trashëgimisë në shumë prej vendimeve, shkelje të së drejtës materiale (argumentimi i vendimeve në ligjin për Detyrimet dhe dhënien e parcelave të tokës), anomalitë në sistemin e caktimit të lëndëve, afati kohor i shkurtër në të cilin janë marrë vendimet, dhe vlera potenciale e tokës së dhënë, si pjesë të provave rrethanore që, kur konsiderohen si një e tërë, tregojnë në përfundimin e vetëm logjik se gjyqtarët kanë lëshuar vendime me qëllim që marrjes së përfitimit ose shkaktimit të dëmit. Edhe pse trupi gjykues nuk ka gjetur asnjë provë të drejtpërdrejtë se gjyqtarët kanë marrë vendime me qëllim të përfitimit ose për të shkaktuar dëm, trupi gjykues ka gjetur se pesha kumulative e provave ka vërtetuar qëllimin e nevojshëm përtej dyshimit të arsyeshëm, siç përshkruhet në pjesën për fajësi individuale më poshtë.

*ii) Ndhima në nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore*

242. Neni 25 i KPPK-së (neni 33 i KPK-së) përcakton se:

*1. Kushdo që me dashje ndihmon personin tjetër për kryerjen e veprës penale dënohet më dënim më të butë*

243. Prandaj ligji kërkon që vepra kryesore penale të kryhet d.m.th. përfundohet para se përgjegjësia penale për ofrimin e ndihmës të ngritët. Siç është parashtruar më lartë, trupi gjykues gjeti se vepra kryesore penale e Nxjerrjes së kundërligjshme të vendimit gjyqësor është kryer, dhe për këtë arsye trupi gjykues vazhdon në shqyrtimin e çështjes së përgjegjësisë së bashkëfajësisë.

244. Akti i 'Ndhmës' përcaktohet me anë të nenit 25 të KPPK-së (neni 33 KPK-së) si në vijim:

*Ndhima për të kryer një vepër penale përfshin këshillimin ose udhëzimin se si kryhet vepra penale, duke vënë në dizpozicion të kryerësit mjetet për kryerjen e veprës penale, duke larguar pengesat për kryerjen e veprës penale ose duke i premtuar paraprakisht se do t'i fshehë provat e veprës së kryer penale, identitetin e kryerësit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.*

245. Si KPPK-ja ashtu dhe KPK-ja kërkojnë që personi 'me dashje' ndihmon në kryerjen e një vepre penale. Prandaj nuk është e mundur që të ofrohet 'ndihmë' duke vepruar nga pakujdesia.

246. 'Dashja' mund të kryhet me dashje direkte apo eventuale, siç përcaktohet më sipër. Një person mund të përgjigjet penalisht për ndihmë prandaj nëse: 1) ai/ajo është i vetëdijshëm se një vepër penale është duke u kryer dhe se veprimet e tij/saj ndihmojnë në kryerjen e veprës, dhe nga veprimet e tij/saj, ai/ajo ka ndërmend që vepra penale të

kryhet ose 2) ai/ajo është i vetëdijshëm se një veprë penale është duke u kryer dhe se veprimet e tij/saj mund të kontribuojnë në kryerjen e veprës, dhe ai/ajo pajtohen me këtë rrezik.

247. Në përmbledhje, trupi gjykues është i mendimit se përgjegjësia penale për ndihmë lind kur parakushtet e mëposhtme janë vërtetuar:

- 1) Vepra kryesore është kryer.
- 2) Ndihmësi ka ofruar një veprim konkret të ndihmës
- 3) Ndihmësi ka dijeni se një veprë penale është duke u kryer.
- 4) Ndihmësi është i vetëdijshëm se veprimet e tij/saj kontribuojnë në kryerjen e veprës penale dhe ai/ajo ka për qellim veprimet e tij të kontribuojnë OSE ai është i vetëdijshëm se veprimet e tij/saj mund të kontribuojnë në kryerjen e veprës, dhe ai/ajo pajtohen me këtë rrezik

iii) *Shtytja e personit tjetër për nxjerrjen e kundërligjshëm të vendimit gjyqësor & veprat në bashkëkryerje*

248. Përgjegjësia penale për “Shtytje” është e rregulluar me nenin 24 të KPPK-së (neni 32 i KPK-së), i cili thotë si vijon:

*Kushdo që me dashje e shtytë tjetrin të kryejë veprë penale dënohet sikurse ai ta kishte kryer atë veprë penale, nëse vepra penale është kryer nën ndikimin e tij*

249. Neni 24 nuk lëshohet në kuptimin e ‘shtytjes’, dhe për këtë arsye trupi gjykues i jep kësaj fjale kuptimin e saj natyror, domethënë për të inkurajuar apo të bindur të tjerët për të vepruar në mënyrë të kundërligjshme.

250. ‘Shtytja’ kërkon një lloj veprimi të inkurajimit, qoftë verbal ose jo-verbal. Prandaj autori kryesor i veprës nuk është e thënë të ketë krijuar një dashje të qëndrueshme për të kryer veprën penale, dhe inkurajimi apo bindja nga shtytësi duhet të kenë forcuar dashjen e tyre për të kryer veprën.

251. Prandaj shtytësi nuk merr pjesë në kryerjen aktuale të veprës. Në të kundërt, bashkëkryerësi i veprës penale është një person, i cili së bashku me të paktën një tjetër, së bashku kryejnë një veprë penale, ose kontribuon thelbësisht në kryerjen e veprës.

252. ‘Bashkëkryerja’ përcaktohet me anë të nenit 23 të KPPK-së dhe nenit 31 të KPK-së si vijon:

*Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprë penale.*

253. Për të qenë penalisht përgjegjës për kryerjen e një veprë penale në bashkëkryerje, duhet pra të vërtetohet se është kryer një veprë penale, dhe se personi ka marrë pjesë ose thelbësisht ka kontribuar në kryerjen e veprës.

254. Në vijim të kësaj, për të qenë përgjegjës për kryerjen e veprës penale të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore në bashkëkryerje, parakushtet në vijim duhet vërtetuar:



1. një vendim i kundërligjshëm ishte lëshuar sa i përket parakushteve të veprës penale kryesore
  2. bashkëkryerësi ka marrë pjesë në kryerjen e kësaj vepre, ose ka kontribuar thelbësisht në kryerjen e saj, me qëllim që të lëshohet një vendim i paligjshëm DHE me qëllim të caktuar për përfituar për veten e tij ose një tjetër person ose për të shkaktuar dëm.
255. Një vepër e kryer në bashkëkryerje pra është një formë më e lartë e përgjegjësisë penale se sa shtytja, pasi kjo kërkon që personi të ketë marrë pjesë ose të ketë kontribuar thelbësisht në nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm, dhe ka qëllimin që kërkohet nga vepra penale kryesore, domethënë qëllimin për të përfituar për veten e tij apo një person tjetër.

iv) *Falsifikimi i dokumenteve*

256. Kjo vepër rregullohet me anë të nenit 332 të KPPK-së dhe definohet si në vijim:

1. *Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal dënohet me gjobë apo burgim deri në një vit.*

257. Për këtë arsye vepra mund të kryhet në dy mënyra: kur një dokument i falsifikuar është krijuar ose një dokument origjinal është përpiluar me qëllim të shfrytëzimit të tij në të ardhmen si dokument origjinal, ose kur një dokument i falsifikuar ose i ndryshuar faktikisht përdoret dhe kryerësi e bën një gjë të tillë me vetëdije.

## F. FAJËSIA INDIVIDUALE E TË PANDEHURVE

### 258. O.J. (akuza 1)

259. Siç është vërtetuar në gjetjet faktike, O.J. kishte vendosur në nëntë raste të cilat janë objekt i kësaj aktakuze. Këto vendime ishin ‘të kundërligjshme’, siç është përcaktuar në gjetjet faktike dhe vlerësimin ligjor, për shkak të faktit se përmbanin shkelje të ligjit procedural dhe të drejtës materiale duke ndikuar në masë të madhe në përfundimin e padive, dhe të cilat nga një këndvështrim objektiv, nuk ishin brenda gamës së vendimit gjyqësor të pranueshëm. Në përmbledhje, asnjë prej këtyre rasteve nuk i ishte referuar gjykatës komunale nga DHPGJS-ja, në shkelje të Rregullores 2002/13; në shumicën e rasteve nuk kishte asnjë njoftim dërguar AKM-së, në shkelje të Rregullores 2002/12; paditë dhe vendimet ishin të bazuara në Ligjin e Detyrimeve, i cili nuk ishte ligji në fuqi, dhe mjeti juridik i dhënies së ngastrave të tokës si zëvendësim nuk ishte i parashikuar me ligj. Përveç kësaj, ka pasur mangësi dhe parregullsi të shumta në procesin e vlerësimit të padive dhe në marrjen e vendimeve.
260. Trupi gjykues konstatoi se O.J. me dashje ka shkelur ligjin në fuqi. Në formimin e këtij përfundimi, trupi gjykues mori parasysh që të gjitha vendimet janë lëshuar në vitin 2007, dhe kështu pasi që njoftimet në lidhje me ligjin e zbatueshëm ishin dhënë në letrën nga kryegjyqtari i UNMIK-ut më 4 mars 2005, dhe letrën nga AKM-ja të marrë më 26 janar 2007. Trupi gjykues gjithashtu ka marrë në shqyrtim dëshminë e të punësuarve të tjerë në gjykatën komunale - **M.S., M.K., B.K. dhe F.T.i** - në lidhje me njohuritë e tyre të ligjit në fuqi të jenë shumë të rëndësishme, dhe tregues të faktit se dispozitat e Rregulloreve ishin plotësisht të njohura.
261. Dëshmitarja **M.S.**, një gjyqtare civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë gjatë gjithë kohës që N.U. ishte kryetar, ka dhënë dëshmi në gjykatë më 24 shkurt 2014. Ajo e shpalli veten jokompetente në të gjitha 29 rastet që përfshijnë KBI Kosova Export që i ishin caktuar asaj, në pajtim me Rregulloren 2002/13. Në gjykatë ajo dëshmoi se *“unë gjithmonë jam deklaruar si gjyqtare jokompetente sa i takon këtyre rasteve, dhe për hir të palëve, diku në arsyetimin e këtyre aktvendimeve, unë kam përmendur se ata mbajnë të drejtën për të paraqitur padi të re para Dhomës së Posaçme”*.
262. Dëshmitarja më tej dëshmon se ajo ishte në dijeni të rregulloreve që kanë administruar gjendjen përmes Gazetës Zyrtare dhe internetit, dhe se këto përditësime i përcillehin gjykatës dhe shpërndaheshin. Dëshmitarja është pyetur në mënyrë specifike në lidhje me Rregulloren 2002/13 dhe nëse dispozitat në lidhje me referimin në Dhomën e Posaçme ishin të komplikuar; ajo u përgjigj se Rregullorja ishte *“e kuptueshme”*.
263. Dëshmia e M.S. mbështetet nga dëshmia e **M.K.**, e cila ishte gjithashtu një gjyqtare civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë në kohën përkatëse. Ajo e dha një deklaratë të dëshmisë para prokurorisë më 4 korrik 2012. Në të ajo deklaroi se *“në rastet që përfshijnë paditë e paraqitura kundër ndërmarrjeve shoqërore, ligji ishte shumë i qartë. Ne i kemi marrë këto raste, është dashur të nxirret një aktvendim dhe të deklarohet jo kompetenca. Në këtë aktvendim ne duhej t’i udhëzonim paditësit që ata duhej paraqitur padinë në Odën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Mua gjithashtu me kujtohet se ka pasur një dispozitë që i obligonte paditësit për të informuar AKM-në për qëllimin e tyre për të paraqitur padinë kundër ndërmarrjeve shoqërore.”*<sup>54</sup>

---

<sup>54</sup> Dosja e prokurorisë 5, tab 11

264. Dëshmitarja **B.K.** ishte administratore e gjykatës në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Ajo nuk ishte pjesëtare e personelit ligjor edhe pse ishte në dijeni të procedurës së referimit drejtuar dhe nga DHPGJS-ja. Gjatë dëshmisë së saj në gjykatë më 20 shkurt 2014 ajo deklaroi se: *“ka pasur raste kur gjyqtarët kishin lëshuar aktvendim që tregonte se Gjykata Komunale nuk ishte kompetente për t'u marrë me raste të tilla”*. Në deklaratën e saj të dëshmisë të datës 20 qershor 2012, kur u pyet nëse ajo e dinte se rastet që përfshijnë NSH-të duhej referuar në Dhomën e Posaçme, ajo deklaroi: *“Nuk e njoh ligjin pasi kjo nuk është puna ime, por e di nga puna ime në gjykatë që ka pasur raste kur pala ka paraqitur drejtpërdrejtë padi në Gjykatën Komunale. Në raste të tilla gjyqtarët lëshonin një aktvendim dhe duke shpallur gjykatën komunale si jo kompetente. Gjyqtarët i udhëzonin paditësit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Ndonjëherë Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme i referonte rastet përsëri në gjykatën komunale”*. Edhe pse dëshmitarja pohoi se nuk kishte dijeni të dispozitave të Rregullores, është e qartë se efekti praktik i Rregullores 2002/13 ishte mirë i njohur për të.
265. Trupi gjykues gjithashtu mori parasysh dëshminë e **F.T.**, i cili dha dëshmi në gjykatë më 20 shkurt 2014. F.T. ishte gjykatës laik në Gjykatën Komunale në Prishtinë midis viteve 2000 - 2009. Ai dëshmoi se ishte në dijeni të fakti se në mes viteve 2006 - 2007 juridiksionin primar për rastet e tokës e kishte Dhoma e Posaçme.
266. Prandaj trupi gjykues nuk e pranoi shpjegimin e O.J. se ndërsa ajo ishte në dijeni të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 dhe 2002/13, që ajo e kishte interpretuar nenin 4, paragrafin c dhe d të Rregullores 2002/13 për të nënkuptuar se të gjitha ankesat kundër një NSH-je, që nuk ishte nën administrimin e drejtpërdrejtë të AKM-së, binin nën juridiksionin e gjykatës komunale. Interpretimi i saj, ajo argumentoi, ishte i bazuar në faktin se NSH KBI nuk binte nën juridiksionin e AKM-së apo të DHPGJS-së deri më 12 dhjetor 2007, kur NSH KBI ishte vendosur nën administrimin e drejtpërdrejtë të AKM-së.
267. Trupi gjykues e ka shqyrtuar Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13, dhe në veçanti nenin 4, dhe gjeti dispozitat e saj të jenë të qarta. Megjithatë trupi gjykues tregohet i përmbajtur nga leximi i rregullores në këndvështrimin e retrospektives, dhe për këtë arsye erdhi në përfundimin e tij në bazë të dëshmimeve të dëshmitarëve M.S. dhe M.K., kolegë të gjyqtarëve të gjykatës komunale në kohën përkatëse, dhe njohuritë e referentes së gjykatës, B.K., mbi praktikën e udhëzimit të rasteve në DHPGJS. Trupi gjykues gjithashtu merr parasysh faktin se O.J. është regjistruar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës të kishte marrë pjesë në një seminar për të drejtën civile, që përfshinte temën e juridiksionit të gjykatës themelore, më 12 dhjetor 2003, dhe një seminar për të Drejtat e Pronësisë që përfshinte temën ‘kompetencat e gjykatës themelore’, më 21 maj të vitit 2004. Ajo është e regjistruar të kishte marrë pjesë në një seminar mbi të drejtat e pronësisë më 29 shtator 2005.<sup>55</sup>
268. Trupi gjykues përfundoi se O.J. ka pasur njohuri të ligjit në fuqi. Trupi gjykues vazhdoi të shqyrtoj nëse ajo kishte për qëllim nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm, dhe nëse ajo kishte për qëllim të nxjerrë vendim të kundërligjshëm me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose të shkaktojë dëm (qëllim i caktuar).
269. Nuk kishte asnjë provë të paraqitur gjatë gjykimit se O.J. kishte përfutur dobi pasurore si rezultat i nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme. Gjithashtu nuk janë paraqitur prova të drejtpërdrejta se ajo i kishte marrë vendimet e kundërligjshme me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose një person tjetër. Megjithatë, siç është përcaktuar në

<sup>55</sup> Procesverbali i siguruar ex officio nga trupi gjykues— dhe i paraqitur në përgjigje të kërkesës për zbulimin e informacionit të datës 4 prill 2014.

vlerësimin ligjor, qëllimi për të siguruar dobi pasurore mund të nxirret nga provat rrethamore. Trupi gjykues për të ardhur në përfundim se O.J. qëllimisht kishte nxjerrë vendime të kundërligjshme me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, mori në shqyrtim provat e mëposhtme rrethamore:

270. Së pari, numri i dukshëm i parregullsive, si i drejtës procedurale dhe i asaj materiale, të pranishme në nëntë vendime, dhe mënyrën në të cilën ajo ka drejtuar procedurat gjyqësore, e shtyri trupin gjykues të vij tek përfundimi se sjellja e saj ishte kaq dukshëm e gabuar për tu nënkuptuar qëllimi i saj i kundërligjshëm. Fakti që O.J. kishte drejtuar procedurat gjyqësore në mënyrë të parregullt është mbështetur nga **F.T.**, i cili, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori më 18 tetor 2011<sup>56</sup>, ka konfirmuar se emri i tij është përmendur në dymbëdhjetë raste që janë objekt i kësaj aktakuze, por deklaroi se O. “i mbante të gjitha dokumentet para saj pa i ndarë ato me gjykatësit laik. Ajo i mbulonte që të mos shiheshin. Ka pasur shumë ankesa të bëra kundër O.J., dhe për këtë arsye, këto raste duhet të kishin shkuar te Kryetari i Gjykatës Komunale dhe të mos i caktoheshin asaj, por një gjyqtari tjetër’.
271. Së dyti, secili nga nëntë rastet ishte gjykuar brenda një periudhe shumë të shpejtë në krahasim me rastet tjera jo prioritare në gjykatën komunale. Siç është përshkruar në paragrafin g, padia 1314-07 ishte paraqitur më 29 maj 2007 dhe vendimi u lëshua më 12 korrik 2007; padia 53/06 ishte paraqitur më 19 janar 2006, dhe vendimi është lëshuar më 26 qershor 2007; padia 429/05 ishte paraqitur më 24 mars 2005, dhe vendimi ishte lëshuar më 25 qershor 2007; padia 3/06 ishte paraqitur më 1 shkurt 2006 dhe vendimi ishte lëshuar më 29 janar 2007; padia 1849-06 ishte paraqitur më 6 tetor 2006 dhe vendimi ishte lëshuar më 10 korrik 2007; padia 1147/06 ishte paraqitur më 14/15 qershor 2006 dhe vendimi ishte lëshuar më 9 maj 2007; padia 3521/04 ishte paraqitur më 23 dhjetor 2004 dhe vendimi ishte lëshuar më 15 tetor 2007; padia 1415-05 ishte paraqitur më 10 gusht 2005 dhe vendimi ishte lëshuar më 28 shtator 2007; padia 1738-07 është lëshuar më 20 shtator 2007 dhe ishte lëshuar më 19 nëntor 2007.
272. Periudha më e gjatë kohore mes paraqitjes së padisë dhe vendimit të dhënë ishte 20 muaj; Periudha më e shkurtër e kohës ishte 6 javë. Trupi gjykues sërish ka shikuar në lidhje me sjelljen e gjyqtarëve të gjykatës komunale të cilët zbatonin në mënyrë korrekte rregulloret. **M.S.** dëshmoi në gjykatë se rastet me prioritet ishin përjashtime në procesin e zakonshëm të gjykimit të ankesave sipas radhës kronologjike. Këto ishin rastet që përfshijnë rastet e dhunës së brenda në familje ku përfshihej kujdestaria e fëmijëve. Paditë në lidhje me pronësinë e tokës që përfshijnë NSH-të nuk ishin raste me prioritet dhe ajo ka dëshmuar se ajo i kishte trajtuar këto raste sipas renditjes që vinin. Ajo e shpalli veten jo kompetente në të gjitha 29 rastet që përfshijnë NSH-të të caktuara asaj; kur rastet që përfshijnë NSH-të referoheshin në mënyrë korrekte nga DHPGJS-ja në gjykatën komunale në pajtim me Rregulloren 2002/13 dhe i ishin caktuar asaj, ajo nuk i kishte gjykuar këto raste në kohën e duhur para se ajo të behej Kryetare e Gjykatës në vitin 2010 për shkak të presionit të punëve të tjera. Ajo dëshmoi se “Unë nuk kam vendosur në asnjërin prej tyre, jo sepse nuk kam dashur sepse ishte detyra jonë për të vendosur mbi to, por gjithmonë jam duke iu referuar praktikës së ndjekur në zyrën time. Kam pasur raste që ishin raste më të vjetra dhe ishte dashur të merresha me to më përpara”.
273. Praktika e gjykimit të rasteve sipas renditjes, dhe prania e një grumbullimi të rasteve siç është përshkruar nga **M.S.** po ashtu ishte përshkruar edhe nga **M.K.** Në deklaratën e dëshmisë së saj të datës 4 korrik 2012, ajo deklaroi se të gjitha rastet ishin administruar

---

<sup>56</sup> Dosja e prokurorisë 5

*“në mënyrë strikte kronologjike”. Ajo shpjegoi “Kemi pasur raste specifike të cilat ishin përjashtime, të tilla si rastet e dhunës në familje. Të gjithë gjyqtarët e kishin problemin që ne gjatë gjithë kohës pranonim këto raste urgjente. Ne ishim të detyruar me ligj ti merrnim këto raste si prioritet. Ne kishim aq shumë prej këtyre rasteve me prioritet sa që vështirë se mund të merreshim me ndonjë rast tjetër. Një rast që përfshinte një ndërmarrje në pronësi shoqërore nuk ishte një nga ato përjashtime dhe për këtë arsye do të ishte trajtuar në mënyrë kronologjike si të gjitha rastet e tjera që ishin në pritje. Vetëm rastet urgjente, të cilat kërkonin ndonjë formë të ndërhyrjes së menjëhershme për shkak të konfliktit, është dashur të trajtoheshin.”<sup>57</sup>*

274. Trupi gjykues konkludoi se dëshmitë e dy gjyqtarëve civilë, të cilët e ndiqnin procedurën e përcaktuar për marrjen e vendimit, theksuan anomalitë e praktikës së O.J. të gjykimit të rasteve të pronësisë së tokës si raste me prioritet.
275. Së treti, O.J. kishte vendosur mbi rastet që duhet ti ishin caktuar një gjyqtari tjetër sipas shifrës së fundit të numrit të lëndës dhe në përputhje me sistemin e caktimit të rasteve.
276. O.J. i ishte caktuar shifra 3. Nga nëntë raste që ajo kishte vendosur, shtatë nga ato raste tregonin shifrën e një gjyqtari tjetër. Duke pasur parasysh regjistrin e rasteve si tërësi, në rastet kur NSH KBI ishte e paditura, asaj i ishin caktuar 33 raste nga 60, sipas te cilës rasti duhet ti ishte caktuar një gjyqtari tjetër sipas shifrës së fundit dhe sistemit të përcaktuar të caktimit të rasteve.
277. Vazhdimësia e lartë e shkeljes së procedurës së përcaktuar e vë në dijeni trupin gjykues që O.J. kishte kërkuar në mënyrë aktive të gjykonte mbi këto raste. Përsëri, në formimin e përfundimit të tij, trupi gjykues është udhëzuar nga sjelljet dhe praktikat e gjyqtarëve të gjykatës komunale që ishin kolegë të O.J. dhe të cilët kishin zbatuar ligjin në mënyrë korrekte. Në dëshminë e saj në gjykatë më 24 shkurt, dëshmitarja **M.S.** dëshmoi se ajo nuk është marrë me ndonjë rast që nuk e kishte shifrën e saj. Trupi gjykues gjeti dallimin në sjelljen e M.S. dhe O.J. të jetë i dukshëm, dhe si tregues i qëllimit të kundërligjshëm të O.J..
278. Trupi gjykues vuri në dukje se O.J. nuk ka ofruar asnjë shpjegim të vërtetë për trajtimin e rasteve të tokës si raste me prioritet. Shpjegimi i saj se asaj i ishin caktuar shifra tjera gjatë kohës së punësimit të saj që mund të sqaronin se pse asaj i ishin caktuar rastet me numër të ndryshëm, nuk mbështetet nga shqyrtimit i hollësishëm, duke pasur parasysh dëshmitë e qarta të stafit administrativ, **B.K. dhe N.H.** që gjyqtarëve i ishte caktuar një shifër<sup>58</sup>.
279. Së fundi, trupi gjykues ka shqyrtuar çështjen lëndore të vendimeve – pronësia e tokës - dhe se kjo është një mall me vlerë. Shumë nga ngastrat e tokës të dhëna në zëvendësim në vendime gjendeshin në autostradën Prishtinë - Shkup, një nga rrugët kryesore në Kosovë. Trupi gjykues nuk ka mundur të injoroj vlerën *potenciale* të lartë të ri-shitjes ose zhvillimin e tokës së dhënë në vendime. Trupi gjykues bën të qartë se nuk mbështet në vlerësimet e përafërta të parashikuara në memorandumun e UNMIK-ut të datës 9 qershor 2008 dhe se vlera e tregut e këtyre ngastrave duhet të vendoset në bazë të mendimit të ekspertit në procedurë civile të ardhshme kundër që pandehurit, nëse ka, por vjen në përfundimin se toka është një njësi ekonomike e cila mund të jetë me vlerë të konsiderueshme monetare në bazë të njohurisë së përgjithshme.

<sup>57</sup> Dosja e prokurorisë 5, tab 11

<sup>58</sup> Dëshmia e B.K., dëgjuar më 20 shkurt 2014 dhe e N.H., dëgjuar më 25 shkurt 2014.

280. Trupi gjykues, në përfundim, gjeti se pesha kumulative e provave rrethanore të përshkruara si më lart, nënkuptonte se konkluzioni i vetëm logjik që mund të nxirret është se O.J. kishte lëshuar qëllimisht vendimet e kundërligjshme, dhe se ajo e bëri këtë me qëllim të fitimit të dobisë pasurore për veten e saj apo tjetrin.

281. E.A., F.B. dhe RR.R. (akuza 1)

282. Këta gjyqtar kanë lëshuar një aktvendim, 604/2003, më 2 tetor 2007, duke vendosur mbi vendimin e gjykatës komunale 2333/05. Ky vendim ishte 'i kundërligjshëm', siç është përcaktuar në gjetjet faktike dhe vlerësimin ligjor. Për gjykatën e qarkut nuk kishte bazë ligjore të pranonte juridiksionin dhe për të vendosur lidhur me ankesën: rasti nuk ishte referuar gjykatës komunale në shkallë të parë nga DHPGJS-ja, dhe ankesa nuk ishte referuar gjykatës së qarkut nga DHPGJS-ja. Gjyqtarët e gjykatës së qarkut për këtë arsye duhet të kishin shpallur veten jo kompetent në përputhje me ligjin e zbatueshëm për juridiksionin. Vendimi ishte gjithashtu i kundërligjshëm në substancë, pasi ankesa mbështeste një vendim që ishte bazuar në Ligjin e Detyrimeve dhe që jepte tokën si kompensim.

283. Trupi gjykues konstatoi se vendimi i kundërligjshëm është nxjerrë qëllimisht, për arsye se gjyqtarët e gjykatës së qarkut ishin në dijeni për ligjin në fuqi dhe me qëllim iu shmangen atij. Trupi gjykues nxjerr këtë përfundim nga rrethanat e rastit.

284. Ankesa ishte parashtruar nga NSH KBI dhe përfshinte mungesën e juridiksionit të gjykatës komunale, si bazë e ankesës. Në vendimin, gjyqtarët e gjykatës së qarkut kanë cituar një vendim nga DHPGJS –ja, SCA-05-0104. Nga leximi i rastit SCA-05-0104, është e qartë se në bazë të kompetencave të saj për referimin e rasteve të tilla të gjykatës komunale, DHPGJS-ja e kishte referuar rastin konkret në gjykatën komunale për gjykim. Rasti SCA-05-0104 përcaktonte se në rast të ankesës, "një ankesë e tillë bie tek Dhoma e Posaçme", sipas dispozitave të Rregullores 2002/13. Trupi gjykues konstatoi se gjyqtarët e gjykatës së qarkut kishte keqinterpretuar rastin SCA-05-0104 duke pretenduar, në arsyetim, se DHPGJS-ja ka shpallur veten jo kompetente. Gjyqtarët e gjykatës së qarkut e kishin përdorur vendimin SCA-05-0104 për të treguar se gjykata komunale ishte e autorizuar të vendos mbi rastin 2333/05, duke adresuar dhe anashkaluar pikën e ankesës lidhur me juridiksionin. Trupi gjykues konstatoi se ky keqinterpretim i vendimmarrjes SCA-05-0104 tregonte se gjyqtarët e gjykatës së qarkut e *njihnin* ligjin në fuqi, domethënë se një rekomandim nga DHPGJS-ja kërkohet me ligj, dhe se ky keqinterpretim i ligjit në fuqi është bërë me qëllim për të mbështetur vendimin e kundërligjshëm të gjykatës komunale.

285. Trupi gjykues konstatoi se secili prej gjyqtarëve të gjykatës së qarkut ishte përgjegjës për nxjerrjen e vendimit, siç është përcaktuar në vlerësimin ligjor.

286. Në dëshminë e tij të procedurës paraprake, i pandehuri E.A. deklaroi se, për shkak të ngarkesës së madhe të punës, ishte një praktikë e përgjithshme e pranuar se rasti përgatitej nga kryetari i trupit gjykues dhe anëtarët e tjerë të trupit gjykues zakonisht mbështeteshin në propozimin e tij.<sup>59</sup> Gjithashtu i pandehuri F.B., kur u pyet nëse ndonjëherë nuk ishte pajtuar me ndonjë vendim të kryetarit të trupit gjykues ose gjyqtarë të tjerë, në rastet që përfshijnë pasuritë shoqërore, deklaroi se "nuk kishte asgjë për t'u mos u pajtuar" dhe "pasi ligji ishte i qartë, nuk kishte asnjë arsye për diskutim sepse rastet është dashur të dërgohen përsëri në gjykatën komunale".<sup>60</sup>

---

<sup>59</sup> Dosja 4, f. 103.

<sup>60</sup> Dosja 4, f. 125.

Megjithatë, kur ishte ballafaquar drejtpërdrejt me një kopje të vendimit Ac.nr.664/2007<sup>61</sup>, ai deklaroi se nuk i kujtohej rasti dhe definitivisht asnjëherë nuk e kishte parë verdiktin. Më tej, ai deklaroi: *“Do ta kisha kundërshtuar ndaj këtij rasti që të gjykohej dhe menjëherë do ta kisha njoftuar kryetarin e gjykatës së qarkut. Ky vendim është një vendim i paligjshëm dhe për këtë arsye jo ligjor. Jam krejtësisht i sigurt se gjyqtarit të cilit i ishte caktuar rasti nuk kishte përmendur në njoftimin tij se një ndërmarrje në pronësi shoqërore ishte e përfshirë në rastin në fjalë dhe për më tepër, i njëjti gjyqtar kishte shpërfillur faktin se gjyqtari duhet të ketë pasur një lloj interesi që e shtyri atë për ta fshehur të vërtetën nga anëtarët e tij të trupit gjykues dhe për më tepër, dështimi për referimin e rastit për në gjykatën e duhur”*.<sup>62</sup> Gjithashtu, i pandehuri R.R., i cili ishte kryetari i trupit gjykues, kur u pyet nëse ndonjëherë nuk ishte pajtuar me vendimin e gjyqtarëve porotë në raste që kishin të bëjnë me pasuritë shoqërore, deklaroi se *“nuk me kujtohet ndonjëherë të kem pasur mosmarrëveshje me gjyqtarët e tjerë porotë”*.<sup>63</sup> Kur ishte ballafaquar me rastin AC nr. 664/2007, i pandehuri pohoi: *“Nuk me kujtohet që jam marrë me rastin konkret. Besoj se ishte një gjyqtar i trupit gjykues të gjykatës së qarkut, koleg i imi, që është marrë me rastin”*.<sup>64</sup>

287. Kështu, gjyqtarët e pandehur nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, të gjithë konfirmojnë se ne përgjithësi nuk ka pasur ndonjë mosmarrëveshje midis gjyqtarëve të trupit gjykues kur gjykonin rastet që kishin të bënin me ndërmarrje shoqërore. Vetëm kur drejtpërdrejt përballeshin me rastin specifik për të cilin janë të akuzuar, ata deklarorin ose se nuk i kujtohej fare rasti ose do ta kishin kundërshtuar.
288. Trupi gjykues ka gjetur shpjegimet e tyre të jenë jo të besueshme. RR.R. ka mohuar të ketë ndonjë njohuri se Dhoma e Posaçme kishte juridiksion ekskluziv mbi ankesat që përfshijnë paditë ndaj ndërmarrjeve shoqërore, dhe fajësoi gjykatën e qarkut për mos përditësimin e gjyqtarëve me ligjin. Trupi gjykues nuk e pranoi këtë shpjegim - në kohën kur ishte lëshuar vendimi i Gjykatës së Qarkut 604/2003 në tetor 2007, Rregullorja 2002/13 kishte ekzistuar për 5 vjet. Fakti se vendimi SCA-05-0104, i cili në fakt shpalos ligjin e saktë, është përmendur në 604/2003 duke kuptuar se trupi gjykues e gjeti të pakuptueshme se ai nuk ishte në dijeni të ligjit lidhur me juridiksionin.
289. F.B. deklaroi se të gjithë gjyqtarët ishin plotësisht në dijeni të Rregulloreve të UNMIK-ut dhe të gjithë kishin marrë udhëzimin adekuat. Ai mohoi dijeninë për vendimin Ac. Nr 664/2007 dhe deklaroi se RR.R. duhet ta ketë marrë vendimin vetëm pa u konsultuar me të. Trupi gjykues nuk e pranoi këtë shpjegim; F.B. kishte pranuar se ai ishte pjesë e këshillimit dhe se e kishte nënshkruar procesverbalin e këtij këshillimi, prandaj ai është bashkërisht përgjegjës për lëshimin e vendimit nga ana e kryetarit të trupit gjykues.
290. E.A. ka deklaruar se ai ishte plotësisht në dijeni të rregulloreve. Ai kërkoi që të mbështetet në faktin se ka pasur një hetim nga Komisioni Gjyqësor Disiplinor, i cili arriti në përfundimin se vendimi ishte i paligjshëm por e kishte liruar atë për sjellje të pahijshme . Trupi gjykues konstatoi se vendimi i Komisionit Gjyqësor Disiplinor nuk kishte ndikim në përgjegjësinë penale; trupi gjykues ka bërë një vlerësim të ndarë të pretendimeve nga një këndvështrim penal dhe ka arritur në një konkluzion të ndryshëm në bazë të vlerësimit të provave dhe kualifikimin juridik të veprës. Trupi gjykues thekson se një konstatim disiplinor nuk është një parakusht për ndjekje penale.

---

<sup>61</sup> Dosja 11, f. 331.

<sup>62</sup> Dosja 4, ff. 126 dhe 127.

<sup>63</sup> Dosja 4, f. 248.

<sup>64</sup> Dosja 4, f. 249.

291. Trupi gjykues e gjeti faktin se Rr.R., E.A. dhe F.B., të gjithë ishin regjistruar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës se kanë marrë pjesë në seminare për të drejtën pronësore, si provë tjetër për njohurinë e tyre të ligjit në fuqi.<sup>65</sup>
292. Trupi gjykues ka vazhduar të shqyrtoj nëse gjyqtarët e gjykatës së qarkut kishin qëllim për të nxjerrë vendim të kundërligjshëm me qëllim për përfitimit të dobisë pasurore. Përsëri, nuk ishte paraqitur asnjë provë e drejtpërdrejtë gjatë gjykimit se gjyqtarët e gjykatës së qarkut kanë nxjerrë vendimin e kundërligjshëm me qëllim përfitimi të dobisë pasurore. Megjithatë, siç është përcaktuar më parë, ky qëllim mund të dëshmohej nga provat rrethore. Trupi gjykues, për të ardhur në përfundim se gjyqtarët e gjykatës së qarkut kishin qëllim të caktuar, morën në konsideratë provat e mëposhtme rrethore:
293. Së pari, arsyetimi i çoroditur i përfshirë në vendim ishte qartë një përpjekje për të mbështetur vendimin e gjykatës komunale kur ligji në mënyrë të qartë përcaktonte që as gjykata komunale e as gjykata e qarkut nuk kishte juridiksion. Trupi gjykues mori parasysh se në mënyrë që të emërohen në gjykatën e shkallës së dytë, gjyqtarët e gjykatës së qarkut duhet të kenë demonstruar një nivel të konsiderueshëm të përvojës profesionale, dhe se roli i tyre është për të ndërhyrë dhe korrigjuar çfarëdo gabimi të ligjit të kryer nga gjykata e shkallës së parë. Vendimi i lëshuar nga ana e gjyqtarëve të gjykatës së qarkut ishte kaq dukshëm i gabuar për trupin gjykues për të dëshmuar qëllimin e kundërligjshëm si arsye pas saj. Së dyti, trupi gjykues mori në konsideratë, si dëshmi për qëllimin e gjyqtarëve të gjykatës së qarkut, faktin se ankesa është vendosur në më pak se pesë muaj nga data e vendimit të gjykatës komunale; Vendimi 604/2003 ishte lëshuar më 2 tetor 2007, ndërsa ankesa në gjykatën e qarkut është parashtruar më 3 korrik 2007. Kjo ishte një periudhë jashtëzakonisht e shpejtë kohore për vendosjen në një ankesë nga grumbulli i rasteve. Duke marrë parasysh këto prova rrethore, trupi gjykues konsideron se i vetmi përfundim logjik ishte që gjyqtarët e gjykatës së qarkut qëllimisht lëshuan vendimin e kundërligjshëm, dhe se ata e bënë këtë me qëllim të fitimit të dobisë pasurore për vete ose një tjetër person.
294. S.M. (akuza 1)
295. S.M. ka vendosur në dy nga pesëmbëdhjetë rastet të cilat janë objekt i kësaj aktakuze, 251/04 dhe 1698/05.
296. Këto vendime ishin 'të kundërligjshme' siç përcaktohet në gjetjet faktike dhe vlerësimin ligjor, për shkak të faktit se përmbanin shkelje të ligjit procedural dhe material, e që kishin një efekt të konsiderueshëm në rezultatin e procedurës dhe të cilat nga një këndvështrim objektiv, nuk ishin brenda gamës së një vendimi gjyqësor të pranueshëm.
297. Trupi gjykues konstatoi se S.M. me dashje ka shkelur ligjin. Trupi gjykues rithekson se njoftimi ishte dërguar në Gjykatën Komunale në Prishtinë në formën e letrave nga kryegjyqtari i UNMIK-ut dhe AKM-ja. Trupi gjykues gjithashtu mori parasysh dëshmitë e punonjësve të tjerë në gjykatën komunale kur kishte vendosur se ajo kishte njohuri të ligjit në fuqi. Trupi gjykues përsërit shqyrtimin e dëshmive të **M.S., M.K. dhe B.K.** që janë përshkruar më lartë në paragrafët 267-271. Trupi gjykues vendosi këtë arsyetim të njëjtë për S.M., domethënë duke marrë parasysh njohuritë dhe praktikën e punonjësve të tjerë të gjykatës komunale, trupi gjykues erdhi në përfundim për njohuritë e S.M. për ligjin në fuqi.

---

<sup>65</sup> Informacion i siguruar ex officio nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në shkresë e datës 4 prill 2014.



298. Trupi gjykues gjithashtu mori parasysh faktin se S.M. kishte zbatuar me korrektësi ligjin në raste të tjera. Para nxjerrjes së vendimit në padinë 251/04 më 19 qershor 2007, S.M. e kishte shpallur veten jo kompetente më 9 tetor 2006 në një rast tjetër që përfshinte një NSH; përveç kësaj, ajo kishte lëshuar një vendim në një rast *me* një rekomandim të Dhomës së Posaçme të datës 16 maj 2007. Prandaj, trupi gjykues nuk e pranoi shpjegimin e saj në lidhje me padinë 251/04, se pasi ishte lëshuar para luftës, dhe një vendim është lëshuar më 1996, se Rregullorja 2002/12 dhe 2002/13 nuk zbatoheshin (padiësi parashtroi një padi të re në Gjykatën Komunale në Prishtinë më 23 prill 2003, në mënyrë të qartë prandaj rregulloret zbatoheshin dhe një rekomandim nga DHPGJS-ja ishte i nevojshëm).
299. Në mënyrë të ngjashme, në rastin 1698/05, ndërsa padia ishte gjykuar para hyrjes në fuqi të rregulloreve, padiësi ka paraqitur një padi të re në gjykatën komunale më 7 shtator 2005. Prandaj në mënyrë të qartë rregulloret u zbatuan dhe padia duhej referuar nga DHPGJS për në gjykatën komunale. S.M. lëshoi vendimin në këtë rast më 15 shkurt 2007, *pasi* ajo në mënyrë të drejtë e kishte shpallur veten jo kompetente në tetor 2006.
300. Trupi gjykues vazhdoi të shqyrtoj nëse ajo kishte për qëllim të nxirrte vendime të kundërligjshme, dhe nëse ajo kishte për qëllim nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete e për një tjetër (qëllimi i caktuar).
301. Nuk ishte paraqitur asnjë provë e drejtpërdrejtë gjatë gjykimit se S.M. kishte përfituar dobi pasurore si rezultat i lëshimit të vendimeve të kundërligjshme. Gjithashtu nuk janë paraqitur prova të drejtpërdrejta se ajo morri vendime të kundërligjshme me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose një person tjetër. Megjithatë, siç është parashtruar në vlerësimin ligjor, qëllimi për të siguruar dobi pasurore mund të nxirret nga provat rrethore. Trupi gjykues në të ardhur në përfundim se S.M. qëllimisht kishte lëshuar vendime të kundërligjshme me qëllim të fitimit të dobisë pasurore, mori në konsideratë provat e mëposhtme rrethore:
302. Së pari, trupi gjykues është i mendimit se shkeljet e drejtës procedurale dhe materiale që përmbajnë vendimet ishin kaq dukshëm të gabuara për tu dëshmuar qëllimi i kundërligjshëm.
303. Së dyti, fakti se S.M. në mënyrë të drejtë ka shpallur veten e saj jo kompetente në disa raste, çon në përfundimin se mos shpallja e saj si jo kompetente në këto dy raste ishte e qëllimshme dhe e motivuar nga qëllimi i kundërligjshëm.
304. Së treti, trupi gjykues mori parasysh kohen e shpejtë me të cilën S.M. e kishte gjykuar rastin 1698/05; padia 1698/05 është lëshuar më 7 shtator 2005 dhe vendimi është lëshuar më 15 shkurt 2007, që do të thotë se ishte gjykuar në më pak se 18 muaj. Padia në rastin 251/04 është lëshuar më 23 prill 2003 dhe vendimi ishte lëshuar më 19 qershor 2007, e cila për këtë arsye kishte nevojë për një kohë më të gjatë për shqyrtim, por përsëri trupi gjykues mori parasysh dëshminë e M.S. dhe M.K.t në lidhje me sistemin e gjykimin të rasteve në mënyrë kronologjike, dhe dëshminë e M.S. se ajo nuk ishte marrë me gjykimin e *asnjë* rasti të referuar asaj në mënyrë të rregullt nga DHPGJS-ja për shkak të grumbullimit të rasteve. Trupi gjykues i referohet arsyetimit të dhënë më sipër në paragrafët 279 -281.
305. Së katërti, trupi gjykues gjithashtu mori parasysh se S.M. kishte vendosur mbi një rast që sipas sistemit të caktimit të lëndëve dhe sistemit të caktimit të rasteve me shifra, duhet ti ishte caktuar O.J.. Trupi gjykues gjen se O.J. gjithashtu kishte nxjerrë vendimeve të

kundërligjshme gjyqësore në atë kohë, por trupi gjykues konstatoi faktin se S.M. kishte gjykuar në një rast me një shifër që tregon një tjetër gjyqtar, duke dëshmuar faktin se ajo ishte e përfshirë në sjellje jo normale.

306. Së fundi, trupi gjykues përsëri mori në shqyrtim vlerën e mundshme të lartë të çështjes lëndore të vendimit dhe i referohet arsytimit të dhënë në paragrafin 286.

307. Trupi gjykues, erdhi në përfundim në bazë të peshës kumulative të provave rrethore të përshkruara si më lart, se S.M. me qëllim kishte nxjerrë vendime të kundërligjshme dhe se ajo e bëri këtë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose personin tjetër.

308. S.S. (akuza 1)

309. Siç është vërtetuar në gjetjet faktike, S.S. ka lëshuar vendimin në rastin 2333/05 më 15 Maj 2007.

310. Vendimi ishte “i kundërligjshëm”, siç përcaktohet në gjetjet faktike dhe vlerësimin ligjor për shkak të faktit se përmban shkelje të ligjit procedural dhe atij material, e që kishin një efekt të konsiderueshëm në rezultatin e procedurës dhe të cilat nga një këndvështrim objektiv, nuk ishin brenda gamës të një vendimi gjyqësor të pranueshëm.

311. Trupi gjykues konstatoi se S.S. me dashje ka shkelur ligjin në fuqi. Trupi gjykues sërish i referohet provave të njoftimeve të dërguara në gjykatën komunale dhe të dëshmive të M.S., M.K. dhe B.K.. Trupi gjykues i referohet arsytimit të përshkruar më sipër në paragrafët 267-271 dhe e përdor këtë për S.S..

312. Trupi gjykues gjithashtu mori parasysh se S.S. kishte zbatuar në mënyrë korrekte rregulloret në raste të tjera: S.S. e kishte shpallur veten jo kompetente në rastet në vijim: rasti 82/04 më 25 janar 2005; rasti 2742/04 më 31 mars 2005; rasti 2422/2008 më 27 tetor 2009; rasti 22/2007 më 29 maj 2007; rasti 332/2009 më 2 korrik 2009; rasti 622/2006 më 25 qershor 2009; rasti 1822/2003 më 23 shtator 2008. Para dhe pasi ajo lëshoi vendimin në padinë 2333/05, S.S. pra ishte duke zbatuar në mënyrë korrekte rregulloren.

313. S.S. kishte pranuar në intervistën e saj para prokurorisë se ajo e dinte se rasti është dashur të ishte referuar në Dhomën e Posaçme, por se ajo ishte vënë nën presion nga paditësi i cili ka punuar për Komisionerin e Policisë së UNMIK-ut. Ajo më tej theksoi se N.U. e kishte kërcënuar me humbjen pozitive të saj nëse ajo nuk pajtohej ta gjykonte padinë.

314. Nga pranimi i S.S., trupi gjykues është i bindur që ajo qëllimisht ka nxjerrë vendimin e kundërligjshëm gjyqësor. Trupi gjykues nuk ka gjetur se shpjegimi i S.S. përbën një mbrojtje ligjore të parashikuar nga qoftë neni 8 i KPPK-së (‘mbrojtje e nevojshme’), neni 9 i KPPK-së (‘nevoja ekstreme’) ose neni 10 i KPPK-së (‘urdhrat nga lartë’).

315. Trupi gjykues vazhdon të shqyrtoj nëse ajo kishte për qëllim të nxjerrë vendim të kundërligjshëm me qëllim që të siguroj dobi pasurore për veten apo për një tjetër person (qëllim i caktuar). Në mbrojtjen e saj, S.S. gjithashtu e ngriti çështjen se më parë ishte liruar në një rast të mëparshëm të ngjashëm, mbi bazën se nuk kishte qenë e provuar se kishte pasur qëllim për të siguruar dobi pasurore të kundërligjshme.

316. Trupi gjykues ishte i bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se S.S. kishte nxjerrë vendim me qëllim të sigurimit të dobisë pasurore për veten e saj, ose në një tjetër person. Trupi

grykues ka vlerësuar se edhe në bazë të vetë shpjegimit të S.S. se ajo e kishte nxjerrë vendimin nën presion – që në mënyrë të qartë e kishte për qëllim, një përfitim do të sigurohej me nxjerrjen e një vendimi të kundërligjshëm, madje edhe nëse kjo ishte për dikë tjetër. Trupi grykues po ashtu ka shqyrtuar se nxjerrja e vendimit me qëllim të ruajtës së pozitës në punë është gjithashtu një ‘dobi pasurore’, dhe për këtë arsye trupi grykues ishte i bindur që ajo e kishte nxjerrë vendimin me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për veten e saj dhe për një tjetër person. Vendimi gjithashtu u lëshua në një kohë kur gjyqtarët e tjerë në gjykatën komunale lëshonin vendimeve të kundërligjshme gjyqësore, dhe trupi grykues e ka shqyrtuar këtë për të treguar se ka pasur një skemë kriminale që operonte mes N.U. dhe gjyqtarëve të pandehur të gjykatës komunale.

317. T.M. (akuza 1)

318. Siç është vërtetuar në gjetjet faktike, T.M. ka lëshuar vendimin në rastet 1908/03, 342/06, 1918/06.

319. Vendimet ishin “të kundërligjshme”, siç përcaktohet në gjetjet faktike dhe vlerësimin ligjor për shkak të faktit se përmbajnë shkelje të ligjit procedural dhe atij material, e që kishin një efekt të konsiderueshëm në rezultatin e procedurës dhe të cilat nga një këndvështrim objektiv, nuk ishin brenda gamës së një vendimi gjyqësor të pranueshëm.

320. Trupi grykues konstatoi se T.M. me dashje ka shkelur ligjin në fuqi. Trupi grykues nuk e pranon shpjegimin e T.M. se ai e interpretoi Rregulloren 2002/13 në të njëjtën mënyrë që e kishte bërë O.J., d.m.th. se rregullorja nuk ishte zbatuar deri sa AKM-ja nuk ishte vendosur nën administrimin e drejtpërdrejtë. Trupi grykues i referohet të njëjtit arsyetim, siç përcaktohet në paragrafët 267-271, në lidhje me njoftimet drejtuar gjykatën komunale dhe njohurisë së anëtarëve të tjerë të stafit.

321. Pas përfundimit se T.M. kishte njohuri të ligjit në fuqi, trupi grykues vazhdoi të shqyrtoj nëse ai kishte për qëllim nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm, dhe nëse ai kishte për qëllim nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm më qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për veten e tij apo personit tjetër.

322. Trupi grykues në përfundimin se T.M. me qëllim kishte nxjerrë vendimin e kundërligjshëm, ka marrë parasysh provat e mëposhtme rrethore:

323. Së pari, trupi grykues është i mendimit se shkeljet e drejtës procedurale dhe materiale që përmbajnë vendimet ishin kaq qartë të gabueshme sa që është dëshmuar qëllimi i kundërligjshëm.

324. Së dyti, T.M. kishte lëshuar vendimet në këto raste shumë shpejt në krahasim me rastet e tjera joprioritare në gjykatën komunale. Padia 1908-03 është lëshuar më 28 tetor 2003 dhe vendimi është nxjerrë më 19 dhjetor 2006; padia në rastin 342/06 është lëshuar më 13 mars 2006 dhe vendimin është lëshuar më 23 mars 2007; padia në rastin 1918-06 është lëshuar më 17 tetor 2006 dhe vendimi ishte lëshuar më 6 qershor 2007. Padi të në rastin 342/06 dhe 1918-06 ishin proceduar shpejt brenda më pak se një vit. Duke marrë parasysh dëshminë e M.S., trupi grykues konstaton se këtyre rasteve i ishte dhënë prioritet në shkelje të procedurës së përcaktuar të gjykimit të rasteve në mënyrë kronologjike.

325. Së treti, në secilin prej tre rasteve të vendosura nga T.M. numri i lëndës tregonte se çështja duhej ti ishte caktuar një gjyqtari tjetër në përputhje me sistemin e caktimit të lëndëve. Trupi grykues përsëri ka shqyrtuar dëshminë e M.S., se ajo nuk kishte gjykuar

ndonjë rast i cili nuk mbante shifrën e saj, dhe ka gjetur se sjellja e kundërt mes të dy gjyqtarëve të jetë domethënëse.

326. Së katërti, trupi gjykues mori parasysh vlerën e lartë potenciale të tokës, e cila ishte objekt i vendimeve dhe i referohet arsyetimit më sipër në paragrafin 286.

327. Së fundi, dhe duke marrë parasysh faktorët e mësipërm të identifikuar, trupi gjykues gjeti se pagesa që e kishte pranuar T.M. në shumën prej 1, 025,00 eurove në llogarinë e tij bankare nga avokati E.G., i cili kishte përfaqësuar paditësit në rastet 342/06 dhe 1908/03, që të jetë një pagesë e cila ngrit dyshime serioze mbi paanshmërinë e tij si gjyqtar. Pagesa është pranuar më 24 korrik 2006, dhe për këtë arsye pasi padia 1908-03 dhe 342/06 ishte lëshuar<sup>66</sup>. Trupi gjykues e gjeti shpjegimin e T.M. se kjo pagesë ishte në lidhje me një shlyerje të një borxhi, të jetë jo e besueshme duke pasur parasysh se ai nuk ishte në gjendje të siguroj kurrfarë prove me shkrim në mbështetje të kësaj, dhe madje edhe në qoftë se trupi gjykues do ta kishte pranuar shpjegimin e tij, kjo *ende* krijon dyshime serioze në lidhje me paanësinë duke ditur statusin e tij zyrtar si gjyqtar në këto raste.

328. Trupi gjykues, përfundoi në bazë të peshës kumulative të provave rrethore të përshkruara si më lart, se T.M. kishte lëshuar me qëllim vendimet e kundërligjshme dhe se ai e bëri këtë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose një tjetër.

329. H.B. (pika e akuzës 2)

330. Vepra kryesore e Nxjerrjes së vendimit të kundërligjshëm gjyqësor është kryer, si për piken e akuzës 1 në aktakuzë. Prandaj trupi gjykues vazhdon të marr parasysh përgjegjësinë e bashkëfajësisë.

331. Trupi gjykues konstatoi se H.B. ka ofruar veprime konkrete të ndihmës për gjyqtarët e gjykatës komunale në kryerjen e veprave penale. Ajo e bëri këtë në disa mënyra, siç është vërtetuar në gjetjet faktike.

332. Ajo pretendonte të siguronte përfaqësim ligjor për NSH KBI në secilin prej rasteve që janë objekt i kësaj aktakuze, duke përmbushur kështu kërkesën për përfaqësim ligjor, që mundësonte vazhdimin e rasteve. Sido që të jetë, ajo nuk e njoftoi AKM-në për paditë kundër NSH-ve pavarësisht nga fakti se Rregullorja 2002/12 përcaktonte përparësinë e AKM-së mbi asetet e NSH-se. Edhe pse Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 nuk përcaktonte detyrim për të paditurin ta njoftoj AKM-në e lidhur me padinë kundër një NSH, kjo është kërkuar nga vetë AKM-ja. Trupi gjykues dëshmoi njohurinë për Rregulloren 2002/12 si pasojë e letrave që ishin dërguar nga AKM-ja të gjitha NSH-ve duke i njoftuar ato për dispozitat e Rregullores 2002/12 dhe se AKM-ja duhet të njoftohet për çdo padi kundër një NSH-je brenda 3 ditësh nga paraqitja e padisë (shih paragrafin (e)). H.B., ndërsa pretendonte të përfaqësonte NSH KBI, prandaj kishte një detyrim pozitiv ta njoftonte AKM-në për çdo padi kundër NSH-së në përputhje me udhëzimin e AKM-së.

333. Ajo nuk e kishte kundërshtuar juridiksionin e gjykatës komunale, duke iu shmangur kështu AKM-së dhe DHPGJS-së. Shpjegimi i saj dhënë prokurorit në deklaratën e saj të procedurës paraprake se ajo kishte bërë përfaqësime të tilla është hedhur po ashtu nga trupi gjykues pasi shqyrtimi i kujdesshëm i procesverbalit nuk e mbështet këtë pohim - nuk ka asnjë regjistrim të asnjë parashprese të bërë nga H.B. në këtë pikë. Ajo gjithashtu nuk kishte kundërshtuar mënyrën se si u zhvilluan procedurat gjyqësore, faktin se

---

<sup>66</sup> Shih dosjen e prokurorisë dosja 15 faqe 58-71

paditë ishin të bazuara mbi Ligjin e Detyrimeve i cili nuk ishte i zbatueshëm, mungesën e vlerësimit të duhur të parcelave të tokës, apo dhënia e ngastrave të tokës si zëvendësim kur në fakt asnjë mjet ligjor nuk e parashikonte një gjë të tillë. Kjo ishte edhe në kundërshtim të qartë të udhëzimit nga AKM-ja, se vetëm AKM-ja kishte mundësi ta marre pronën e paluajtshme që i përket një NSH-je.

334. Duke mos e njoftuar AKM-në apo duke mos bërë ndonjë vërejtje në lidhje me juridiksionin, H.B. i kishte ndihmuar gjyqtarët e gjykatës komunale duke bërë të mundur që procedurat gjyqësore të vazhdonin në gjykatën komunale. Prandaj ajo kishte larguar pengesat për kryerjen e veprës penale. Sikur ndonjëra nga këto çështje të ishte ngritur, që një vëzhgues objektiv do ta priste nga një person që pretendon të përfaqësoj NSH-në, atëherë është e parashikueshme se vendimet e kundërligjshme gjyqësore nuk do të ishin lëshuar.
335. Trupi gjykues konsideron se këto veprime përbenin veprime konkrete të ndihmës në kryerjen e veprës penale. Trupi gjykues konsideron se H.B. i kishte ofruar këto akte të ndihmës me qëllim, dhe me dashje direkte sepse ajo kishte siguruar veprimet e ndihmës me qëllim të nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme gjyqësore, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo një tjetër, ose duke shkaktuar dëme. Trupi gjykues erdhi në përfundim të këtij qëllimi nga provat rrethore.
336. Së pari, H.B. e dinte se ajo nuk kishte të drejtë të përfaqësoje NSH KBI, përsëri ajo mori hapa aktivë për të dhënë përshtypjen që ajo kishte të drejtë të paraqitet në gjykatë; ajo e zyrtarizoi përfaqësimin e saj duke i paraqitur gjykatës autorizimet të lëshuara nga I.H., duke pretenduar të ishte drejtor i NSH KBI. Ajo e bëri këtë, duke e ditur se ajo nuk kishte autoritet ligjor për tu paraqitur, pasi ishte shkurtuar nga puna më 23 nëntor 2006. Gjatë gjykimit, trupi gjykues kishte dëgjuar dëshmitarët e thirrur nga H.B.: **M.B., Mu.B. dhe I.A.**. Të gjitha dëshmitarët kanë dhënë dëshmi në gjykatë më 12 mars 2014. Dëshmitarët **M.B.** dhe **Mu.B.** në fakt kanë treguar njohuritë e tyre për kompetencat e AKM-së - ata pranuan se NSH KBI ishte nën kontrollin administrativ të AKM-së që nga viti 2002. I.A. ka pranuar se ajo, si H.B., është shkurtuar nga puna më 26 nëntor 2006 dhe vazhdoi të punonte nën I.H.. Në dëshminë e saj në gjykatë, ajo dukej të kishte pranuar me vetëdije vazhdimin e punës në mënyrë të paligjshme: “ndoshta nuk ishte e drejtë që kishim vazhduar të punonim por ashtu thoshte drejtori”.
337. Trupi gjykues gjeti se ajo kishte njohuri të ligjit të zbatueshëm në lidhje me juridiksionin, pasi në gjashtë nga pesëmbëdhjetë rastet, I.H. kishte paraqitur ankesë duke përmendur mungesën e juridiksionit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, si bazë për ankesë. Këto ankesa janë dorëzuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, në kundërshtim me Rregulloren 2002/13, por megjithatë trupi gjykues gjeti faktin se kjo bazë për juridiksionin ishte e njohur në mënyrë të qartë për I.H., me të cilin H.B. kishte punuar nga afër, duke nënkuptuar se ishte e pakonceptueshme që ajo nuk ishte në dijeni të ligjit të zbatueshëm në lidhje me juridiksionin. Kjo është veçanërisht kështu, pasi sipas dëshmisë së vetë H.B., ajo ka hartuar të gjitha ankesat dhe tërheqjen e ankesave sipas udhëzimit të I.H., ndërsa ky i fundit vetëm i kishte nënshkruar dokumentet. Ajo megjithatë vazhdoi të merrte pjesë në procedurat gjyqësore në gjykatën komunale, dhe nuk ka bërë asnjë parashtesë në lidhje me juridiksionin, duke lehtësuar kështu vendimet e paligjshme. Trupi gjykues konsideron se shkelja e ligjit procedural ishte kaq qartë e gabuar, sa bashkëveprimi i H.B. me të e dëshmon qëllimin e kundërligjshëm.
338. H.B. në dëshminë e saj në prokurori deklaroi se ajo nuk është lejuar të marrë asnjë vendim pa miratimin ose udhëzimin e mbikëqyrësit të saj, I.H.. Ajo e pranoi se me vetëdije kishte bërë shkelje të ligjeve në fuqi, por e bëri këtë vetëm pas presionit nga

mbikëqyrësi i saj I.H.. Trupi gjykues nuk ka gjetur se kjo përben një mbrojtje ligjore të 'mbrojtjes së nevojshme', 'nevojës ekstreme' apo 'urdhrat nga lartë.

339. Trupi gjykues, në të kundërtën, arriti në përfundimin se H.B. qëllimisht kishte ofruar ndihmën e saj për gjyqtarët e gjykatës komunale, dhe e ka konsideruar si provë të qëllimit të saj për të ndihmuar në kryerjen e veprës, faktin që ajo personalisht ka përfituar financiarisht nga nxjerrja e vendimeve të kundërligjshme gjyqësore. Kjo dëshmohet nga të ardhurat që ajo ka marrë. Më pas duke u shkurtuar nga puna e saj në NSH Ferma e Derrave, H.B. nuk kishte kurrfarë marrëdhënie formale të punës me asnjë NSH apo NSH KBI dhe nuk ishte paguar me kurrfarë të ardhurash formale apo rrogë. Padiësit, në pesë nga pesëmbëdhjetë rastet që janë objekt i kësaj aktakuze, kanë konfirmuar se kanë paguar para për NSH KBI, në lidhje me vendimet e gjyqtarëve të pandehur (të cilët vendosen që padiësi kishte për t'ia kthyer NSH KBI shumen që i është paguar padiësit nga NSH KBI kur toka ishte shitur në vitet 1950-ta dhe 1960-ta). Tre fatura janë siguruar; që të trija ishin nënshkruar nga I.H. dhe dy janë nënshkruar edhe nga H.B.. Faturat vërtetojnë pagesën në shumen prej 813,25 euro në lidhje me rastin 1317-07, 976,90 euro në lidhje me rastin 53/06, dhe 4,476.57 euro në lidhje me rastin 429/05<sup>67</sup>. Këto pagesa nuk janë evidentuar në deklaratën bankare të NSH KBI. H.B. pranoi të ketë pranuar pagesa nga padiësit pas janë lëshuar vendimet, megjithatë ajo ka deklaruar se paratë janë shpërndarë në mënyrë të ligjshme dhe ajo nuk kishte përfituar në mënyrë të paligjshme nga procedurat gjyqësore. Trupi gjykues e gjeti këtë shpjegim për të qenë jo i besueshëm - nuk ka asnjë shpjegim tjetër të arsyeshëm për H.B., në rrethanat që ekzistonin në atë kohë, që ajo të paraqitet dhe të marrë pjesë në procedurat gjyqësore, pa pritje të përfitimit material. Fakti që ajo ka pranuar shpërbllim me para si rezultat i këtyre vendimeve të kundërligjshme është provë tjetër se ajo i kishte ofruar ndihmë gjyqtarëve të pandehur me qëllim të nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme.
340. Duke marrë parasysh peshën kumulative të provave rrethanore, trupi gjykues është i bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se H.B. ka kryer veprën penale të ndihmës në nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm gjyqësor.
341. G.G. (Akuza 2)
342. G.G. ka përfaqësuar padiësit në gjashtë raste të cilët i janë nënshtruar kësaj Aktakuze: 53/6, 429/05, 1849/06, 1147/06, 1415/05, 1918/06. Këto raste ishin gjykuar nga O.J. dhe T.M.
343. Trupi gjykues gjeti se, edhe pse G.G. ka ofruar veprime konkrete të ndihmës për gjyqtarët e Gjykatës Komunale, Trupi gjykues nuk mund të ishte i sigurt për standardet penale që ai kishte ofruar këto veprime të asistimit me qëllim që vendimet e paligjshme do të lëshoheshin me qëllim të përfitimit material. Prandaj, Trupi gjykues gjeti se vepra penale e Nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore nuk ishte dëshmuar përtej dyshimit të bazuar. Sido që të jetë, Sido që të jetë, Trupi gjykues mendon se G.G. kishte kryer veprën penale të Falsifikimit të dokumenteve.
344. Në radhë të parë, duke e konsideruar përgjegjësinë penale të ndihmës, Trupi gjykues gjeti se G.G. ka ofruar veprime konkrete të ndihmës, kryesisht duke i anashkaluar procedurat e zbatueshme dhe të drejtën materiale të cilat kanë mundësuar që padië të vijë para O.J. dhe T.M., dhe të cilat iu mundësuan këtyre gjyqtarëve që të lëshojnë vendime të paligjshme.

---

<sup>67</sup> Dosja e prokurorisë 13,f.154-158.

345. Trupi gjykues ka gjetur se ai e kishte bërë këtë, në disa mënyra. Së pari, G.G. ka ngritur paditë në Gjykatën Themelore, në vend se në OVGJS. Ai nuk ka ofruar njoftime tek AKM, sikurse që kërkohet nga Rregullorja 2002/12, në rastet sikurse më poshtë: 429/05, 1849/06 dhe 1918/06. Në rastet e mbetura, njoftimi ishte bërë pasi që procedurat gjyqësore kishin filluar. Kjo kishte mundësuar që të vazhdojnë procedurat në Gjykatën Komunale, kur në fakt, pa referimin nga OVGJS, Gjykata Komunale nuk ka pasur juridiksion.
346. Trupi gjykues gjeti se G.G. ka pasur dijeni për ligjin e zbatueshëm, dhe kërkesën për referim në Gjykatën Komunale. Kjo është demonstruar nga fakti se ai fizikisht kishte bashkëngjitur dokumentin referues nga OVGJS që ka të bëjë me një rast tjetër të padisë 1918/06 me qëllim që ta bënte të duket se ishte referuar në mënyrë të duhur në Gjykatën Komunale nga OVGJS, në pajtim me rregulloren. Ai në mënyrë të qartë synonte që Gjykata Komunale të e konsideronte këtë dokument si të “vërtet” dhe se ishte referuar në mënyrë të duhur. Ky veprim ishte pranuar nga G.G. në intervistën e tij, në Prokurori. Trupi gjykues u njoftua me datën e këtij veprimi, dhe me faktin se të gjitha paditë e tjera që ai ishte i përfshirë pas këtij veprimi, kur arriti përfundimin e saj se G.G. e dinte për ligjin e zbatueshëm dhe me qëllim e kishte anashkaluar atë.
347. G.G. gjithashtu ka asistuar tek gjyqtarët në lëshimin e vendimeve të paligjshme duke i bazuar pretendimet në Ligjin mbi Obligimet, që ishin themeluar në gjetjet faktike, nuk ishte ligj i zbatueshëm për argumentimin e pretendimeve, si që nuk mund të aplikohet në mënyrë retrospektive. Kjo pastaj i dha O.J. dhe T.M. “Bazat ligjore” për vendime të paligjshme. Sido që të jetë, Trupi gjykues thekson se përgjegjësia përfundimtare për bërjen e vlerësimeve ligjore dhe ta analizave bie me Gjykatën.
348. Trupi gjykues vazhdojë që të konsiderojë nëse ishte dëshmuar përtej dyshimit të bazuar që G.G. kishte ofruar këto veprime të asistimit me qëllim që vendimet e paligjshme juridike do të lëshoheshin me qëllim të përfitimit të të mirave të paligjshme materiale. Në këtë pjesë të vlerësimit, dallimi duhet që të bëhet në mes të rolit dhe të pozitës së G.G. në krahasim me H.B.. H.B. deri sa pretendonte të e përfaqësonte të paditurin ishte e obliguar që të mbrojtë mjetet dhe interesat e NSH KBI. Mënyra më e qartë për mbrojtjen e interesave të NSH ishte që të argumentonte se padia duhej që të hidhej poshtë duke e ngritur mungesën e kompetencave të Gjykatës Komunale, e që ajo dështojë të e bënte. G.G., si përfaqësues i paditësve, sido që të jetë ishte i obliguar që të veprojë në interesin më të mirë të paditësit, dhe prandaj, nuk ka obligimin e njëjtë që të e adreson çështjen e kompetencës së Gjykatës.
349. Trupi gjykues ka konsideruar se fakti që katër nga paditësit kanë thënë se ata kishin ditë shumë pak apo përfshirjen në rastin e tyre dhe se ishin mbështetur në shërbimet e G.G.<sup>68</sup> ishte pamjaftueshme që të dëshmohet se G.G. kishte ndihmuar gjyqtarët qëllimisht me synimin e duhur. Nuk është e paarsyeshme për klientët laikë, jo familjarë me procedurat ligjore, që të mbështeten në shërbimet e avokatit të tyre dhe të kenë një dijeni të vogël të drejtpërdrejt apo përfshirje në procedurat e tyre ligjore, dhe Trupi gjykues nuk e ka gjetur këtë fakt që të jetë mjaft jo normale, të tregojë qëllimin e paligjshëm në pjesën e G.G.. Njësojë, Trupi gjykues ka vënë re se në pesë nga gjashtë rastet, procedurat gjyqësore kishin filluar pa përfaqësuesin ligjor të autorizuar të paditësve, por nuk e kanë gjetur se kjo mund të ishte vetëm rezultat i qëllimit të paligjshëm nga ana e G.G. përkundrejt për shembull të procedurave të pasakta.
350. Fakti që G.G. ka ofruar njoftimin në AKM të veprimit në tri nga rastet që ai kishte

<sup>68</sup> Dosja e Prokurorisë 6, faqet 94-129

vepruar, edhe pse pasi procedurat gjyqësore kishin filluar dhe prandaj jo në pajtim me dispozitat e Rregullores 2002/13, ka vënë ca dyshime nëse ajo mund të dëshmohet në secilin rast që ai ka vepruar me qëllim të paligjshëm. Ai ka dështuar që të ofrojë ndonjë njoftim për AKM në të tri rastet, sido që të jetë, krijimi i dyshimit në mendjen e Trupit gjykues si rezultat i faktit se njoftimi me vonesë ishte dhënë në tri rastet e tjera do të thotë se Trupi gjykues nuk ka konsideruar këtë që të jetë dëshmi përfundimtare e qëllimit të tij të paligjshëm.

351. Trupi gjykues ka konsideruar se të dhënat e regjistrimit të siguruara gjatë hetimit, të cilat kanë treguar lidhjet e rëndësishme telefonike në mes të G.G. dhe N.U. rreth kohës së secilit rast gjyqësor,<sup>69</sup> ishte i dyshimtë, por Trupi gjykues nuk ishte i mendimit se kjo e dhënë ishte e aftë për krijimin e standardit kriminal, dëshmi e pjesëmarrjes në skemën penale, duke e ditë lidhjen familjare në mes të dy individëve dhe pa e ditë përmbajtjen e bisedave. Njësojë, Paneli nuk mund të konsideroj lokacionin e zyrës së G.G. në pronën e zotëruar nga N.U. si dëshmi për vërtetimin e skemës kriminale, duke e ditë lidhjen familjare. Dëshmia e përgjimit ishte deklaruar që të jetë e papranueshme nga Trupi gjykues (shiko procedurën e provave më lart).

352. Duke i konsideruar dëshmitë si tërësi, Trupi gjykues gjeti sjelljen e G.G. të jetë e dyshimtë, veçanërisht pasi që ai pranoi se qëllimisht e kishte bashkëngjitur notifikimin referues nga një rast tjetër në rastin 1918/06, të cilën Trupi gjykues e gjeti që të jetë përpjekje e qëllimshme që të keqinterpretojë pozitën ligjore. Për më shumë, gjithashtu ishte evidente nga analizave të dosjeve të lëndës të rastit të veçantë, se ai kishte dorëzuar referimin nga OVGJS që ishte lëshuar në një rast tjetër prandaj deklarata e të pandehurit nuk është dëshmi e vetme e këtij veprimi. Sido që të jetë, Trupi gjykues është dashur që të konsideroj nëse Prokuroria ka dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm që G.G. kishte ofruar asistim për O.J. dhe T.M. me qëllim që vendimet e paligjshme gjyqësore do të lëshoheshin me qëllim të përfitimit të të mirave materiale. Paneli gjeti se ky element nuk ishte dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Prokuroria ka dështuar që të dëshmojë se skema kriminale kishte ekzistuar në mes të N.U., Kryetar i Gjykatës Komunale të Prishtinës ku O.J. dhe T.M. kryenin funksionet e tyre dhe G.G.. Për më shumë, Trupi gjykues gjeti se në krahasim me të pandehurën H.B. kishin ekzistuar shpjegime të tjera të mundshme për sjelljen e G.G. për shembull duke vepruar për interesin më të mirë të klientit të tij, avokat i ri dhe ambicioz duke dashur që të sigurojë rezultate të suksesshme për të rritur reputacionin profesional në një treg konkurrues, që nuk do të thotë se vetëm shpjegimet logjike për veprimet e tij ishin qëllim i paligjshëm. Sido që të jetë, Trupi gjykues ishte i mendimit se vepra penale e falsifikimit të dokumenteve ishte kryer në lidhje me rastin 1918/06, dhe prandaj ka zëvendësuar këtë vepër penale.

353. N.U. (akuza 3)

354. Trupi gjykues ka konsideruar se dëshmitë e paraqitura nuk kanë mbështetur akuzën për nxitje kundër N.U.. Sikurse është theksuar në vlerësimin ligjor, përgjegjësia për nxitje kërkon inkurajim dhe nuk kërkon pjesëmarrje faktike në veprën penale. Trupi gjykues ka gjetur se faktet e krijuara kanë demonstruar se N.U. në mënyrë të konsiderueshme ka kontribuar në kryerjen e veprës penale nga gjyqtarët e Gjykatës Komunale, dhe kishte për qëllim, kur kishte bërë këtë kontribut, që të përfitojë të mira për veten e tij apo një person tjetër.

355. N.U. ishte Kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, nga viti 2000 deri në vitin 2010. Si

---

<sup>69</sup> Raporti i Aktakuzës dhe i Regjistrimit, paragrafët 195 -196, të dorëzuara gjatë shqyrtimit gjyqësor



Kryetar, ai ishte përgjegjës për administratën e Gjykatës<sup>70</sup> dhe për caktimin e shpërndarjes së punës duke i mbikëqyrur ekzekutimet e tyre.<sup>71</sup> Si Kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, N.U. ishte pra gjyqtar i lartë dhe mbikëqyrës administrativ i gjyqtarëve të cilët shërbenin në këtë Gjykatë.

356. Në pozitën e tij, nga ai është pritur që të sigurojë që gjyqtarët që punonin në Gjykatën Komunale të udhëhiqeshin sipas ligjit të zbatueshëm në lidhje me rastet e tokës sikurse është komunikuar nga Gjyqtari kryesor i UNMIK-ut, AKM dhe në fund nga zyrtarët e Kadastrës.
357. Në Gjykatën Komunale në Prishtinë ka ekzistuar sistemi për shpërndarjen e rasteve për gjyqtarët e gjykatës Komunale. N.U. si Kryetar i Gjykatës ka pasur përgjegjësi të përgjithshme për sistemin e shpërndarjes së rasteve. Sido që të jetë ka pasur manipulim në sistemin e shpërndarjes së rasteve duke përfshirë NSH KBI. Trupi gjykues ka konsideruar dëshmitë e **B.K., N.H., M.S.** dhe dëshmitë e provave të siguruara nga ekzaminimi në Regjistrin e Gjykatës të jenë etë habitshme.
358. Dëshmitarja, **B.K.**, regjistruese e rasteve civile gjatë periodës relevante të viteve 2004 - 2007, ka dhënë dëshminë në Gjykatë më 20 shkurt 2014. Ajo shpjegojë se kur pranoheshin rastet e reja civile ishin regjistruar në librin regjistruar për raste civile dhe i është dhënë numri i rastit. Rastet futeshin në librin e regjistrimit me radhën që ato ishin pranuar. Rastit i është dhënë numri i lëndës, e gjithashtu i është dhënë radha vijuese. Numri i fundit i numrit të rastit ka treguar se tek cili gjyqtar rasti do të caktohej. Pasta rasti do të i dorëzohej tek gjyqtari i caktuar me atë numër.
359. Ka pasur përjashtime tek rregulli i shpërndarjes së rasteve në renditjen vijuese. Dëshmitarja, **B.K.** deklaroi në Gjykatë se politika e shpërndarjes dhe e caktimit të lëndëve ishte nën juridiksionin ekskluziv të N.U. Dëshmia e dëshmitares në Gjykatë sa i përket arsyeve që justifikonin shpërndarjen e rasteve ishin së pari rastet do të mund të ri caktoheshin nëse gjyqtari ishte i ngarkuar shumë me punë, dhe së dyti, rasti tëri caktohej nëse në rast përfshihej pala serbe. Në deklaratën e saj, të dhënë në Prokurori, në qershor të vitit 2012, dëshmitarja qartë ka deklaruar se sistemi i caktimit të rasteve *“gjithmonë ishte përcjellë, me një përjashtim, rastet ku ishin të përfshirë palët serbe nuk do të shpërndaheshin nën këtë procedurë normale, nëse një palë ishte serb do të caktohej gjyqtari serb”*. Ajo ka konfirmuar se shumica e rasteve ku përfshiheshin palët serbe ishin padi që kishin të bënin me pronat. Ajo ka deklaruar se kur e kishte informuar N.U. lidhur me rastin, ajo do të theksonte kur rasti përfshinte një NSH. Dëshmitarja ka deklaruar se *“shumica e rasteve, ku të përfshirë ishin palët serbe, ishin të caktuara gjyqtarët, J. dhe M.. Dëshiroj që të shpjegoj se ata nuk i kanë pranuar të gjitha rastet ku ishin të përfshirë palët serbe sepse ato ishin shumë dhe për shkak të kësaj disa u janë caktuar gjyqtarëve shqiptarë”*.
360. Dëshmitari, **N.H.**, administrator i Gjykatës gjatë periudhës relevante, dhe mbikëqyrësi i **B.K.**, ka dhënë dëshmi në Gjykatë më 25 shkurt 2014. Ai ka konfirmuar dëshminë e **B.K.** lidhur me sistemin e shpërndarjes së rasteve. Ai ka konfirmuar se rastet e caktuara me anën e numrit të fundit të numrit të lëndës tek gjyqtarët, me numër të caktuar, dhe rastet janë caktuar në mënyrë kronologjike. Dëshmitari ka thënë se arsyeja për sistemin e caktimit vijues ishte se puna ishte shpërndarë në mënyrë të barabartë dhe asnjë nga gjyqtarët nuk ishte mbingarkuar me punë.

<sup>70</sup> Në bazë të nenit 55 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta, gazeta Zyrtare Nr. 21/78.

<sup>71</sup> Neni 58, po aty.

361. Dëshmitarja **M.S.**, gjyqtare civile në Gjykatën Themelore në Prishtinë, përgjatë tërë presidencës së N.U., ka dhënë dëshmi në Gjykatë më 24 shkurt 2014. Ajo ka konfirmuar dëshminë e dëshmitarit N.H. lidhur me procedurën në mënyrë kronologjike të caktimit të rasteve. Ajo ka thënë se *“rastet në Gjykatë kanë ardhur në mënyrë kronologjike, dhe zyra e regjistrimit për çështje civile ka shpërndarë rastet ashtu si ato kanë arritur”*.
362. Faktet e themeluara tregojnë se sistemi i caktimit të rasteve ishte manipuluar në dy mënyra, e para, rastet ishin caktuar në mënyrë vijuese tek i njëjti gjyqtar, dhe e dyta, rastet ishin caktuar tek gjyqtari me numër të gabuar.
363. Ekzaminimi i librit të regjistrimit tregon se rastet nuk ishin caktuar duke e përcjellë etnitetin e të pandehurve (sikurse është pretenduar nga N.U. në dëshminë e tij të procedurës paraprake dhe nga dëshmitarja, B.K.), se rastet ishin caktuar për gjyqtarët me numër të gabuar, dhe se rastet ishin caktuar vijimisht për O.J.. Në veçanti, ekzaminimi i padive në Gjykatën Komunale duke përfshirë NSH KBI gjatë periudhës kohore të viteve 2002 - 2007, tregon se 150 raste ishin caktuar tek katër gjyqtarët e pandehur<sup>72</sup>.
364. O.J. ka marrë numrin e përgjithshëm prej 60 rasteve, nga të cilat 33 raste kanë përmbajtur numra të caktuara për një gjyqtar tjetër. Asaj i ishin caktuar 53 raste që përfshinin paditës serb, dhe 7 raste që përfshinin paditës shqiptarë. Në lidhje me vendimet që janë subjekt i Aktakuzës, ajo ka vendosur në 9 raste, deri sa shtatë nga këto reflektojnë numrin e gjyqtarit tjetër.
365. T.M., ka pranuar numrin e përgjithshëm prej 32 rasteve, nga të cilat 19 reflektojnë numrin e caktuar për gjyqtar tjetër. Atij i ishin caktuar 31 raste që përfshinin paditës serb dhe 1 rast që përfshinte paditësin shqiptar. Në lidhje me vendimet që janë subjekt i Aktakuzës atij i ishin caktuar 3 nga 15 rastet, dhe të tria reflektojnë numrin e një gjyqtari tjetër.
366. S.M. ka pranuar numrin e përgjithshëm prej 40 rasteve, nga të cilat 12 reflektojnë numrin e caktuar gjyqtarëve të tjerë. Asaj i ishin caktuar 13 raste ku të përfshirë janë paditësit serb dhe 27 rast të përfshirë paditësit shqiptarë. Në lidhje me vendimet që janë si subjekt i Aktakuzës, ajo vendosi në dy nga 15 rastet, deri sa një rast nuk reflektonte numrin e saj.
367. S.S. ka pranuar numrin e përgjithshëm prej 19 rasteve, nga të cilat 2 reflektojnë numrin e caktuar një gjyqtari tjetër. Asaj i ishin caktuar 8 raste ku përfshihen paditësit serb dhe 11 raste ku përfshihen paditësit shqiptar. Nga vendimet që janë si subjekt i Aktakuzës, ajo vendosi për një rast, numri reflekton se është dashur që të i caktohet O.J..
368. Rastet gjithashtu ishin caktuar në mënyrë vijuese tek i njëjti gjyqtar. O.J. ka pranuar raste të njëpasnjëshme ku të përfshirë ishin NSH KBI<sup>73</sup>. Këto ishin numrat e rasteve 1454, të përcjellë me 1455 më 2004, 2355, në vitin 2005, 292 të vijuara me 293 në vitin 2006, dhe 1292 dhe 1293 dhe gjithashtu 1918 dhe 1919 në vitin 2007<sup>74</sup>.
369. Dëshmitari, **N.H.**, ka deklaruar se caktimi i rasteve jashtë caktimit normal të rasteve ishte e “çuditshme”. Dëshmitari ka konfirmuar se rasti menjëherë pas rastit paraprak nuk do të merrej me të njëjtin gjyqtar. Dëshmitarit i është treguar libri i regjistrimit dhe dy hyrje nga viti 2004, ku dy rastet ishin vënë në listë me numrat e rasteve 1454 dhe 1455,

<sup>72</sup> Dosja e Prokurorisë 16.

<sup>73</sup> Dosja e Prokurorisë, 16

<sup>74</sup> Dosja e Prokurorisë, 16

me inicialet OJ afër tyre. Dëshmitari ka deklaruar, *“Shoh disa të dhëna por nuk e di se pse kjo ka ndodhur sepse e shoh se i njëjti gjyqtar ishte caktuar për këto raste”*. Dëshmitari ka thënë se bazuar në inicialet, *“OJ”* ishte O.J., pasi që nuk kishte gjyqtarë të tjerë me këto inicialet. Dëshmitari ka thënë se ai nuk e ka ditë se kush e kishte bërë hyrjen dhe se nuk kishte asgjë që të bënte me të.

370. Dëshmitarit gjithashtu i është treguar hyrja nga libri i regjistrimit i vitit 2005 dhe hyrjet që i referohen numrave 2355 dhe 2356 dhe e ka konfirmuar se inicialet afër tek këto hyrje ishin O.J.. Prandaj, këto raste ishin caktuar tek gjyqtari i njëjtë dhe tek gjyqtarja me numrin tjetër (O.J.). Dëshmitari N.H., gjithashtu e ofroj një shpjegim për këtë, e konfirmoj se kjo ishte e *“çuditshme”*.
371. Sikurse që u tha më lart, shembujt që iu dhanë N.H. gjatë dëshmisë së tij në Gjykatë nuk janë vetëm shembuj të rasteve të marra jashtë rendit
372. Dëshminë e dëshmitares, **M.S.**, në lidhje me pritjet për kronologjinë e zakonshme të sistemit të caktimit të lëndëve Trupi gjykues e gjen të jetë veçanërisht relevante: Ajo ka thënë se pritjet kur kishte ndodhur konflikti i interesit, apo kur rasti ishte rast me prioritet, për shembull rastet e dhunës në familje, pengimi apo zotërimi, rastet për ushqime apo edhe caktimi i fëmijëve tek prindër specifik. Ajo gjithashtu ka thënë se nuk ishte marrë me asnjë nga rastet dhe se nuk e kishte pasur numrin e saj.
373. Në lidhje me pretendimin nga N.U., dhe gjithashtu ka reflektuar në dëshmitë e B.K. që rastet ishin caktuar tek gjyqtarët serb në bazë të etnitetit, kjo qartë nuk është mbështetur nga dëshmitë e dokumentuara. Dëshmitari, N.H., kur është pyetur nga Prokurori nëse kishte politik që paditësit serb të alokohen tek gjyqtarët serb dhe paditësit shqiptarë tek gjyqtarët shqiptarë u përgjigj se nuk ishte i *“sigurt”*. Sido që të jetë, kur dëshmitari u pyet që të konfirmojë përmbajtjen e deklaratës së tij të dhënë në qershor të vitit 2012, ai e konfirmojë, sikurse është dhënë në deklaratën e tij të bërë më 20 qershor të vitit 2012 dhe e nënshkruar nga ai, se nuk kishte sistem të caktimit të gjyqtarëve bazuar në etnitetin e paditësve. Në deklaratën e tij, N.H. ka thënë se *“të gjithë gjyqtarët kanë vendosur në rastet serbe, për këtë shkak se ishin 2 përkthyesit e Gjykatës Komunale në Prishtinë që asistuan gjyqtarët shqiptarë me rastet serbe dhe gjithashtu anasjelltas”*.
374. Dëshmitarja, **M.S.**, është pyetur në mënyrë specifike rreth kërkesave kundër NSH, dhe nëse kishte ndonjë dallim në mënyrën që drejtoreshin lëndët nëse paditësit ishin shqiptarë apo serb, ajo ka thënë, *“Pa marr parasysh nga paditësit, serb apo shqiptarë, rastet u janë dhënë të gjithë gjyqtarëve”*. Në deklaratën e saj të datës 04 korrik 2012, dëshmitarja ka thënë se ajo nuk e dinte për ndonjë përjashtim për këto raste të sistemit të caktimit dhe nëse kishte ndonjë përjashtim tek ky sistem i caktimit të rasteve, atëherë kjo do të mund të bëhej përmes vendimit të Kryetarit të Gjykatës. Dëshmia e M.S. ishte mbështetur nga **M.K.**, e cila ka thënë se të gjithë gjyqtarët kanë folur shqip dhe serbisht. Shpjegimi i N.U. se përjashtimi ishte bazuar mbi etnitetin e paditësit nuk qëndron në hollësi.
375. Trupi gjykues konsideron dëshmitë e N.H., M.S. dhe të M.K. se ata ishin në dijeni për përjashtimet në sistemin e alokimit të rasteve, që do të siguronte shpjegim të arsyeshëm se pse rastet ishin caktuar për gjyqtarët e pandehur me numra të ndryshëm nga sistemi i alokimit si dëshmi se kjo nuk ishte praktik normale që kishte ndodhur hapur. Trupi gjykues ka gjetur shpeshësinë në të cilën rastet ishin caktuar tek gjyqtari me numër tjetër të jetë e habitshme – kjo nuk ishte dukuri që ka ndodhur njëherë apo dy herë që do të mund të shpjegohej se gabime aksidentale. Trupi gjykues nuk ka

pranuar shpjegimin e N.U. se si rezultat e punës së mbingarkuar në Gjykatë se ai nuk kishte qenë i përfshirë në caktimin e lëndëve dhe se kjo detyrë ishte kryer nga Zyra e Regjistrimit. Dëshmitë e paraqitura ishin se ai nuk kishte pasur përgjegjësi për sistemin e caktimit të lëndëve në postin e tij si Kryetar i Gjykatës. Modeli i shkeljeve të sistemit të caktimit të rasteve tek gjyqtarët e pandehur gjithashtu është e habitshme. Trupi gjykues ka ardhur në përfundim se shkeljet kishin ndodhur për shkak të caktimit të qëllimshëm nga N.U. të rasteve që përfshijnë NSH KBI tek gjyqtarët, O.J., S.M., S.S. and T.M. si i vetmi shpjegim i arsyeshëm.

376. N.U. gjithashtu në mënyrë të konsiderueshme ka kontribuar në kryerjen e veprës penale të dështimit me qëllim që të sigurohet pajtueshmëria me ligjin. Trupi gjykues ka marr parasysh kohën e njoftimit të dhënë nga UNMIK-i dhe AKM në Gjykatat Komunale sipas ligjit në fuqi, dhe gjykimi i vendimeve. Trupi gjykues ka gjetur faktin se 14 nga 15 rastet ishin gjykuar pas janarit 2007, dhe pas njoftimit nga UNMIK-u në mars të vitit 2005 dhe AKM, në janar të vitit 2007 si dëshmi e qartë se ligjet e zbatueshme me qëllim ishin shkelur.

377. Trupi gjykues nuk e ka pranuar deklaratën e N.U. dëshminë e tij gjatë procedurës paraprake se ai e dinte në tërësi rregulloret e UNMIK-ut 2012 dhe 2002/13 sikurse që ishin gjyqtarët e Gjykatës Komunale, dhe se ai nuk e kishte ditë se ligjin sepse nuk ishte zbatuar nga ata. Më tej, Trupi gjykues nuk e pranojë pretendimin e N.U. se ai kishte organizuar takime për gjyqtarët e Gjykatës Komunale kur ai i këshillonte ata rreth kornizës ligjore, si dëshmi e përpjekjes së tij që të sigurojë drejtësi të duhur administrative. Trupi gjykues ka konsideruar këtë si veprim të pakuptim duke e konsideruar se praktika e paligjshme në tërësi ishte pranuar nga ai. Nëse N.U. si Kryetar i Gjykatës Komunale me të vërtetë ka menduar që në mënyrë të duhur të drejtonte gjyqtarët ai do ta duhej ta bënte ashtu, por ai ka dështuar ta bëjë atë.

378. Trupi gjykues ka konsideruar kohën që mori N.U. të i përgjigjej letrës së AKM të pranuar në janar të vitit 2007 dhe rrethanat që kishin ekzistuar kur ai në fund ishte përgjigjur. Ai nuk është përgjigjur deri më 02 janar 2008 pasi që të gjitha rastet ishin gjykuar dhe vetëm pasi që Njësi për Hetime Juridike ka siguruar dosjet e lëndës të rasteve që janë subjekt i kësaj Aktakuze. AKM gjithashtu kishte vendosur NSH KBI nën administrimin e drejtpërdrejt në nëntorin e vitit 2007. Vetëm pasi që NSH KBI ishin vendosur nën administrimin e AKM, dhe vetëm pasi që hetimi i Njësitit për Hetime Juridike ishte vënë në fund të vitit 2007, gjyqtarët kanë deklaruar veten e tyre jo kompetent dhe i referojnë lëndët tek Dhoma e Veçantë sikurse e përcaktuar me ligj.<sup>75</sup> Koha e N.U. për përgjigje në letër dhe ndryshimi praktik i gjyqtarëve, kur të kombinohen me shkeljet në sistemin e caktimit të rasteve që kishin ndodhur, qartë ka demonstruar për Trupin gjykues se të pandehurit, gjyqtarët e Gjykatës Komunale dhe Kryetari i Gjykatës vepruan së bashku. Fakti i konsideruar se pas zbulimit që 12 rastet ishin lëshuar në mënyrë jo ligjore, se N.U. nuk ka marrë ndonjë veprim disiplinor kundër gjyqtarëve të Gjykatës Komunale është si dëshmi e mëtejshme e bashkëfajësisë së tij.

379. Trupit gjykues nuk i është paraqitur ndonjë dëshmi se N.U. ka vepruar në këtë mënyrë që të përfitojë të mira materiale për vete apo tjetrin. Por si ka qenë e paraparë në vlerësimin ligjore, dhe sikurse e zbatuar në lidhje me të pandehurit e tjerë, qëllimi për përfitim të të mirave materiale mund të nxirret nga provat rrethanore. Për më shumë tek provat rrethanore që janë cekur më lart, Trupi gjykues gjithashtu ka konsideruar përfshirjen e tij të drejtpërdrejt në rastin 233/05 (dhe mënyra se si kjo ka ndodhur) dhe komunikimi i tij me AKM.

---

<sup>75</sup> Dosja 13, faqet 1-54.

380. Sikurse e paraparë në paragrafin 1, OVGJS ka udhëzuar Zyrën Kadastrale që të mos ekzekutojë transferin e tokës deri sa ekziston një kopje e Aktgjykimit nga OVGJS. Kjo do të thotë se toka ishte dhënë vetëm për paditësit në rastet 1314/07 dhe 1738/07.
381. Dëshmitari, **S.N.**, i cili në kohën relevante ishte Kreu u Njësitit Administrativ në ATM ka dëshmuar në Gjykatë më 05 shkurt 2014. Deri sa ai dëshmonte në Gjykatë kujtesa e tij ishte e dobët duke e ditë kohëzgjatjen dhe dëshmia e tij ishte disi e paqartë, ai ka konfirmuar përmbajtjet e deklaratës së tij të dhënë më 05 qershor 2012, në të cilën ai ka thënë se e kishte takuar N.U. dhe se ai *“ka përqendruar pyetjet e tij të tërthorta se çka e pengonte ATM autorizimin e aprovimit për blerjet/vendimet që të ekzekutoheshin. Unë ia shpjegova atij se...raste të caktuara duhet që të referohen nga Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme me qëllim që Zyra Kadastrale të lëshojë në mënyrë korrekte listën poseduese.”*<sup>76</sup> S.N. gjithashtu ka thënë në deklaratën e tij se ai ishte kontaktuar me telefon nga sekretari i N.U., që kishte kërkuar takim, *“shumë e çuditshme”*.
382. Trupi gjykues e gjen këtë si tregues, jo vetëm se N.U. ka pasur dijeni lidhur me vendimet individuale, por gjithashtu ai kishte për qëllim që vendimet të ekzekutoheshin dhe se ai kishte interes personal që vendimet të ekzekutoheshin. Trupi gjykues gjeti shpjegim se ai ishte kureshtar në emër të paditësve që të jetë i besueshëm sikurse që ky të ishte rasti pastaj hetim do të ishte komunikuar përmes kanaleve formale, pyetja do të ishte e hapur dhe e drejtpërdrejt, dhe administratori nuk do ta kishte gjetur situatën të *“çuditshme”*. I vetmi përfundim logjik që do të mund të bëhej ishte se ai vepronte sikurse e kishte qëllimin që të përfitoj ca lloje të përfitimeve materiale, për veten e tij, apo për një tjetër.
383. E dyta, Trupi gjykues ka marr parasysh se nënshkrimi i N.U. ishte shfaqur në vendimin e ndryshuar në rastin 2333/05. Nënshkrimi është shfaqur nën emrin e gjyqtarës S.S., e cila e kishte bërë vendimin origjinal në këtë rast dhe ishte në pushim mjekësor në kohën e ndryshimit. Dëshmitarja, **M.A.**, e cila në kohën relevante punonte si asistente administrative e S.S., dha dëshminë në Gjykatë, më 18 shkurt 2014. Ajo dëshmojë në Gjykatë se N.U., si Kryetar kishte kërkuar që ajo të ndryshojë dhe të e korrigojë Aktgjykimin. Ajo i telefonojë S.S., e cila refuzojë që të e nënshkruajë ndryshimin pasi që ishte në pushimin e saj mjekësor. Kur u pyet nëse ishte normale që të shohësh që një Aktgjykim të nënshkruhej në emër të një tjetri, ajo u përgjigj, *“jo, nuk di për raste të tilla”*. Në deklaratën e saj të datës 23 gusht 2011, M.A. ka thënë se N.U. e kishte udhëzuar atë që të e kontaktojë S.S. që ajo të e nënshkruante ndryshimin, gjë që ai e udhëzojë at të shtypte, këtë, *“dëshiroj që të theksoj që unë personalisht kurrë nuk do ta kontaktoja S.S., por kam qenë e udhëzuar ta bëjë këtë nga Kryetari i Gjykatës”*. S.S. refuzojë që të e nënshkruajë këtë dokument, dhe N.U. pranoi se ishte e mundur që do të mund të ishte e nënshkruar nga ai. Përkundër kësaj, ai ka deklaruar në intervistën e tij se në përvojën e tij 20 vjeçare në Gjykatën Themelore, në Prishtinë, kurrë nuk ka ndodhur që një gjyqtar të nënshkruaj për një gjyqtar tjetër. Ai ka shpjeguar se në asnjë rrethanë një gjyqtar do të nënshkruante në emër të një gjyqtari tjetër, dhe në rastin kur një gjyqtar është në pushim mjekësor, Gjykata ka qenë e obliguar që ta kthejë punën apo rastin në ri gjykim përsëri. Trupi gjykues gjithashtu ka marr parasysh dëshminë e dëshmitares, **M.K.** Kjo gjyqtare, e cila në kohën relevante në mënyrë korrekte zbatonte ligjin lidhur me paditë pronësore që kishin të bënin me NSH, kishte dëshmuar në Gjykatë më 24 shkurt 2014 se ajo në mënyrë absolute nuk do ta vente emrin e saj nëse hapësirën e nënshkrimit që përmbante emrin e një gjyqtari tjetër, dhe se, kur ajo vepronte si Kryetare e Gjykatës Themelore, nuk do të nënshkruante në emër të gjyqtarit

<sup>76</sup> Dosja e Prokurorisë 5.

i cili ende punonte si gjyqtar. Trupi gjykues ka konsideruar se vetëm përfundimi për tërheqjen nga një veprim i tillë jo normal e marr nga gjyqtari ishte se N.U. kishte interes personal mbi padinë.

384. Trupi gjykues prandaj ka ardhur në përfundim që, duke pasur parasysh peshën kumulative të provave rrethore, se N.U. ka vepruar në bashkëveprim me të pandehurit, gjyqtarët e Gjykatës Komunale, dhe ai e ka bërë këtë me qëllim që të përfitojë të mira materiale për veten e tij, dhe të një tjetri.

## G. DËNIMI

385. Duke vendosur mbi ligjin penal në fuqi, ky trup gjykues ka marrë parasysh dispozitën e nenit 3 të Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës që hyri në fuqi më 1 janar 2013. Neni 3.1 thotë si vijon:
386. *Ndaj kryesit aplikohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.*
387. Më tej në nenin 3.2 ligj parasheh që:
388. *Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit aplikohet ligji që është më i favorshëm.*
389. Pasi që të gjitha veprat penale ishin kryer para datës 1 janar 2013, kur Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi, në përgjithësi ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale do të aplikohet. Megjithatë trupi gjykues ishte i detyruar që të vendos se cili ligj ishte më i favorshëm për të pandehurit.
390. KPPK në nenin 346 parasheh dënim me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
391. KPK në nenin 432 parasheh pikërisht të njëjtën dënim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
392. Sa i përket veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, KPPK përcakton dënimin me burgim deri në një vit ndërsa KPK parasheh dënimin deri në tre vite. Duke pasur parasysh kufirin e dënimit, trupi gjykues vendosi të aplikojë KPPK-në si bazë për dënimin edhe në rastin e kësaj vepre penale.
393. Duke llogaritur dënimin trupi gjykues mori parasysh rregullat e përgjithshme sipas nenit 64, i cili parasheh si në vijim:
394. *" Gjykata e cakton dënimin për vepër penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë vepër penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrethanat letësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat e tij personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit. "*
395. Trupi gjykues ishte i mendimit të përgjithshëm se sistemi gjyqësor në çdo shoqëri luan një rol të madh në mbrojtjen e të drejtave pronësore. Dobësia e sistemit gjyqësor ndikon në të gjitha komunitetet në Kosovë dhe është një kërcënim serioz për stabilitetin e saj në të ardhmen. Mosbesimi dhe mungesa e besueshmërisë së sistemit jo vetëm që dëmton qëllimin e drejtësisë por edhe i detyron njerëzit që të zgjidhin kontestet jashtë kornizës së sistemit gjyqësor. Nuk është e nevojshme të thuhet, por mungesa e një sistemi efektiv gjyqësor është një pengesë për investimet dhe zhvillimin ekonomik.
396. Duke marrë parasysh situatën e të gjithë gjyqtarëve të pandehur, trupi gjykues erdhi në përfundim se secili dhe të gjithë kanë shkelur në thelb sundimin e ndershmërisë që duhet të udhëheq të gjithë gjyqtarët si shërbëtorë të sistemit të drejtësisë. Gjyqtarët gëzojnë status të veçantë dhe respekt për shkak të shërbimit të vështirë dhe të përgjegjshëm që ata i kushtojnë shoqërisë. Si të tillë ata duhet të plotësojnë disa kushte të vendosura nga dispozitat ligjore, në mesin e të cilave është integriteti profesional. Gjyqtarët janë të detyruar që të zbatojnë dispozitat ligjore në mënyrë të ndërgjegjshme

dhe duke i ndjekur dispozitat ligjore. Në rast të ndonjë dyshimi, duhet të kryhet shqyrtim shtesë. Është e padiskutueshme se gjatë kryerjes së funksioneve të tyre gjyqtarët janë plotësisht të pavarur. Duhet të theksohet se ky rregull i njohur me kushtetutë nuk është i karakterit absolut në kuptimin që gjyqtarët janë të obliguar të respektojnë rendin juridik. Aktvendimet që ata i kanë nxjerrur kanë shkelur dispozitat ligjore të Republikës së Kosovës si ato procedurale ashtu edhe ato substanciale duke rezultuar drejtpërdrejt në humbje të konsiderueshme potenciale të palës së dëmtuar dhe në mënyrë të tërthortë buxhetin e Kosovës. Aktgjykimet në fjalë janë nxjerrur pavarësisht paralajmërimeve të dhëna nga autoritetet mbikëqyrëse gjyqësore duke udhëzuar që rastet që kanë të bëjnë me pronën bien nën kompetencën ekskluzive të DHPGJS-së. Trupi gjykues është i mendimit se në ato rrethana, gjyqtarët e pandehur kanë qenë të obliguar që të deklarohen se ata nuk kanë kompetencë dhe t'i dorëzojnë lëndët në DHPGJS. Trupi gjykues është i mendimit se rreziku potencial i vlerës së mbrojtur, përkatësisht interesit financiar të buxhetit të Kosovës është i një karakteri të rëndë. Trupi gjykues rithekson se edhe pse Memorandumi i UNMIK-ut nuk ishte konsideruar si një dëshmi vendimtare për vlerën e tokës, ajo qartazi tregon se toka është një mall me vlerë. Megjithatë, edhe pa memorandum kjo është një çështje e njohurisë së përgjithshme; vlera e lartë e tokës në Kosovë.

397. Duke konsideruar këtë aspekt të dënimit që reflekton intensitetin e rrezikut të vlerës së mbrojtur, trupi gjykues është i mendimit se situata që u krijua nga këto aktgjykime nuk është definitive dhe që veprimet e menjëhershme ligjore duhet të merren nga pala e dëmtuar. Ky trup gjykues mori qëndrim se një mundësi e tillë ishte krijuar me Ligjin Nr. 04 / L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë e Privatizimit që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2012. Neni 5 i Ligjit lexon si mëposhtë:

398. *"5. Asnjë gjykatë në Kosovë, përveç Dhomës së Posaçme, nuk do të ketë kompetencë apo autoritet mbi asnjë kërkesë, lëndë, procedurë apo rast të përshkruar me paragrafin 1 të këtij neni, përveç atyre që në mënyrë të veçantë përcaktohen në paragrafin 4 më lart. Nëse një gjykatë ka ushtruar apo ka provuar të ushtrojë kompetencë apo autoritet mbi një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast në kompetencën e Dhomës së Posaçme, derisa një lëndë apo kërkesë e tillë nuk është brenda kompetencës së asaj gjykate sipas paragrafit 4*

399. *5.1. Çdo Aktgjykim apo Aktvendim i lëshuar nga një gjykatë e tillë në lidhje me një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast, do të jenë të pavlefshme dhe të papërmbarueshme; ndërsa Dhoma e Posaçme, në bazë të parashtrësës së një personi, apo me iniciativën vetanake, do të lëshojë një urdhër me atë fuqi;*

400. Duke pasur parasysh numrin e rasteve dhe dëmtimin potencial të buxhetit të Republikës së Kosovës nga veprimet e ish-gjyqtarëve të cilët morën mbështetje nga H.B., ky trup gjykues është i mendimit se pala e dëmtuar është dashur të ketë marrë hapat ligjorë para shumë kohe kur ligji i ri për Dhomën e Posaçme hyri në fuqi, duke paraqitur këto parashtrës në DHPGJS për t'i shpallur këto aktgjykime si të pavlefshme dhe të pazbatueshme. Edhe në qoftë se DHPGJS-ja do të kishte vendosur se ligji i ri nuk ka efekt prapaveprues, pala e dëmtuar do të obligohej që t'a sjellë këtë çështje në vëmendjen e Gjykatës Kushtetuese.

401. Pala e dëmtuar është këshilluar se ekziston një mjet tjetër juridik për të kundërshtuar gjykimet në fjalë. Ligji mbi Procedurën Kontestimore nr.03 / L-006 në nenin 232.1 d) lexon si vijon:



402. *"Procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës: në qoftë se vendimi përfundimtar i formës së prerë është pasojë e veprës penale të gjyqtarit, të përfaqësuesit ligjor apo me prokurë të palës, kundërshtare apo të personit të tretë;*
403. Megjithatë, pala e dëmtuar duhet të marrë në konsideratë afatin shumë të rreptë për të paraqitur një parashtrim të tillë të paraparë në nenin 234.1 pika e.
404. Trupi gjykues thekson se këto procedura penale janë vetëm një aspekt i situatës komplekse dhe veprimet e mëtejshme të palës së dëmtuar janë urgjentisht të nevojshme në mënyrë që të rifitohet prona që ka qenë nën qeverisjen e AKP-së. Në rast se pala e dëmtuar fiton padinë civile, prona do të rifitohet nga pala e dëmtuar. Mundësia reale e kthimit të pronës në mënyrë të konsiderueshme ul nivelin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e cila së bashku me rrethanat e tjera personale, rezultoi në përfundimin se të gjithë të pandehurit meritojnë të dënohen me kusht.
405. Trupi gjykues vendosi të dalloj dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurve, duke marrë parasysh nivelin e ndryshëm të angazhimit në kryerjen e veprës penale, nivelin e ndryshëm të fajësisë që del nga numri i rasteve në të cilat aktgjykimet ishin dorëzuar, dhe rrethanat personale.
406. Në rastin e **N.U.**, trupi gjykues ishte i mendimit se dënimi prej 2 viteve është i përshtatshëm për seriozitetin e veprës penale, sjelljen e autorit të veprës dhe rrethanave personale.
407. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana rënduese janë marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:
- Në këtë kohë N.U. ishte gjyqtar i lartë në Gjykatën Komunale të Prishtinës i cili e mbante pozitën e rëndësishëm të kryetarit; si i tillë ai ishte i detyruar të ndërmerr të gjitha masat e mundshme për të ruajtur administrimin e duhur të sistemit të drejtësisë në gjykatën në të cilën ai ishte përgjegjës;
  - N.U. injoroi paralajmërimet zyrtare lidhur me parregullsitë ligjore në rastet lidhur me pronën dhe ka krijuar përjashtime nga rregullat e sistemit të caktimit të lëndëve.
408. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana lehtësuese janë marrë rrethanat e mëposhtme:
- Ky i pandehur nuk ka një të kaluar kriminale
  - I pandehuri ka një pozitë të qëndrueshme shoqërore si bashkëshort dhe baba i 5 fëmijëve
  - Para se të ndodhte ky rast ai udhëhoqi një karrierë profesionale si gjyqtar dhe kryetar i gjykatës.
409. Në rastin e **O.J.**, trupi gjykues arriti në përfundimin se dënimi prej 18 muajve është i përshtatshëm për seriozitetin e veprës penale, sjelljen e autores së veprës dhe rrethanave personale. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana rënduese janë marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:
- O.J. ka vendosur në shumicën dërrmuese të rasteve duke lëshuar aktgjykime në 9 lëndë.
410. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana lehtësuese janë marrë

rrethanat e mëposhtme:

- Kjo e pandehur nuk ka një të kaluar kriminale
  - E pandehura ka një pozitë të qëndrueshme shoqërore
  - Para këtij rasti, ajo arriti që të udhëheq një karrierë profesionale si gjyqtar.
411. Në rastin e **E.A.** trupi gjykues ishte i mendimit se dënimi prej 9 muajve është i përshtatshëm për seriozitetin e veprës penale, sjelljen e autorit të veprës dhe rrethanat e tij personale. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana rënduese janë marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:
- E.A. ishte anëtar i trupit gjykues me përvojë të gjatë profesionale në gjykatën e apelit, ai ishte përgjegjës për t'u përgatitur për shqyrtim dhe jo për t'u bazuar vetëm në raportin e përgatitur nga kryetari i trupit gjykues.
412. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana lehtësuese janë marrë rrethanat e mëposhtme:
- Ky i pandehur nuk ka një të kaluar kriminale
  - I pandehuri ka një pozitë të qëndrueshme shoqërore si bashkëshort dhe baba i 4 fëmijëve
  - Para se të ndodhte ky rast, ai kishte një përvojë të gjatë si gjyqtar.
413. Në rastin e **F.B.** trupi gjykues ishte i mendimit se dënimi prej 9 muajve është i përshtatshëm për seriozitetin e veprës penale, sjelljen e autorit të veprës dhe rrethanat e tij personale. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana rënduese janë marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:
- F.B. ishte anëtar trupit gjykues me përvojë të gjatë profesionale në Gjykatën e Apelit; ai ishte përgjegjës për tu përgatitur për këshillim dhe jo vetëm duke u mbështetur në raportin e përgatitur nga kryetari i trupit gjykues.
414. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana lehtësuese janë marrë rrethanat e mëposhtme:
- Ky i pandehur nuk ka një të kaluar kriminale
  - I pandehuri ka një pozitë të qëndrueshme shoqërore si bashkëshort dhe baba i 5 fëmijëve
  - Para se të ndodhte ky rast, ai kishte një përvojë të gjatë si gjyqtar
415. Në rastin e **S.M.**, trupi gjykues arriti në përfundimin se dënimi prej 6 muajve është i përshtatshëm për seriozitetin e veprës penale, sjelljen e autorit të veprës dhe rrethanat e saj personale. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana rënduese janë marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:
- S.M. ka vendosur në vetëm 2 raste, kështu që krahasuar me O.J. dënimi i shqiptuar për atë të pandehur duhet të reflektonte këtë ndryshim.
416. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana lehtësuese janë marrë rrethanat e mëposhtme:

- Kjo e pandehur nuk ka një të kaluar kriminale
  - E pandehura ka një pozitë të qëndrueshme shoqërore
  - Para se të ndodhte ky rast, ajo udhëhoqi një karrierë profesionale si gjyqtare.
417. Në rastin e **S.S.**, trupi gjykues arriti në përfundimin se dënimi prej 8 muajve është i përshtatshëm për seriozitetin e veprës penale, sjelljen e autores të veprës dhe rrethanat e saj personale. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana rënduese janë marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:
- S.S. ka lëshuar vendim në një rast, kështu që krahasuar me O.J. dënimi i shqiptuar për atë të pandehur duhet të reflektonte këtë ndryshim. Për më tepër kjo e pandehur duket se ka njohuri të plotë të lëndës pasi që ajo e shpalli veten jokompetente në shumë raste të tjera të të njëjtës natyrë.
418. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana lehtësuese janë marrë rrethanat e mëposhtme:
- Kjo e pandehur nuk ka një të kaluar kriminale
  - E pandehura ka një pozitë të qëndrueshme shoqërore
  - Para se të ndodhte ky rast, ajo udhëhoqi një karrierë profesionale si gjyqtare.
419. Në rastin e **T.M.** trupi gjykues ishte i mendimit se dënimi prej 1 viti është i përshtatshëm për seriozitetin e veprës penale, sjelljen e autorit të veprës dhe rrethanat e tij personale. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana rënduese janë marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:
- T.M. ka vendosur në vetëm 3 lëndë në fjalë kështu që krahasuar me O.J. dënimi i shqiptuar për atë të pandehur duhet të reflektonte këtë ndryshim
420. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana lehtësuese janë marrë rrethanat e mëposhtme:
- Ky i pandehur nuk ka një të kaluar kriminale
  - I pandehuri ka një pozitë të qëndrueshme shoqërore
  - Para se të ndodhte ky rast, ai kishte një përvojë të gjatë si gjyqtar.
421. Në rastin e **RR.R.**, trupi gjykues ishte i mendimit se dënimi prej 9 muajve është i përshtatshëm për seriozitetin e veprës penale, sjelljen e autorit të veprës dhe rrethanat personale. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana rënduese janë marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:
- RR.R. ishte kryetar i trupit gjykues në gjykatën e apelit, ai ishte përgjegjës për përgatitjen e çështjes për shqyrtim dhe të udhëheq diskutimin ligjor gjatë shqyrtimit
422. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana lehtësuese janë marrë rrethanat e mëposhtme:
- Ky i pandehur nuk ka një të kaluar kriminale

- I pandehuri ka një pozitë të qëndrueshme shoqërore si bashkëshort dhe baba i 4 fëmijëve
  - Para se të ndodhte ky rast, ai kishte një përvojë të gjatë si gjyqtar.
423. Në rastin e **H.B.**, trupi gjykues arriti në përfundimin se dënimi prej një 1 viti është i përshtatshëm për seriozitetin e veprës penale, sjelljen e autores së veprës dhe rrethanat personale. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana rënduese janë marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:
- H.B. e ka përfaqësuar të paditurën KBI Kosova në të gjitha lëndët; si avokate ajo ka qenë e obliguar që të ngrisë të gjitha argumentet e mundshme ligjore kundër padive por megjithëkëtë ajo dështoi që të përfaqësoi siç duhet interesat e palës së paditur për të cilët ajo pretendonte se ishte duke punuar.
424. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana lehtësuese janë marrë rrethanat e mëposhtme:
- Kjo e pandehur nuk ka të kaluar kriminale
  - E pandehura ka një pozitë të qëndrueshme sociale
  - Para se ky rast i tanishëm të ndodhte, ajo kishte udhëhequr një karrierë profesionale si avokate.
425. Në rastin e **G.G.** trupi gjykues ishte i mendimit se dënimi prej gjashtë muajve është i përshtatshëm për seriozitetin e veprës penale, sjelljen e autorit të veprës dhe rrethanave të tij personale. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana rënduese janë marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:
- G.G. si një avokat i ri ambicioz ka demonstruar njohuri të plotë të së drejtës materiale dhe procedurale në lidhje me rastet lidhur me pronën. Trupi gjykues është i vetëdijshëm se shqetësimi kryesor i avokatit që përfaqëson interesat e ligjshme të klientit të tij është që të arrihet një vendim pozitiv duke përmbushur thelbin e kërkesës ligjore. Megjithatë, duhet të theksohet se gjatë kryerjes së këtij funksioni avokati është i kufizuar nga dispozitat ligjore. Në këtë rast i pandehuri duke u përpjekur për të arritur vendim pozitiv për klientin e tij ka vendosur të shkel ligjin. Ky lloj i sjelljes duhet qortuar në mënyrë të rreptë.
426. Gjatë shqiptimit të dënimit për këtë të pandehur, si rrethana lehtësuese janë marrë rrethanat e mëposhtme:
- Ky i pandehur nuk ka një të kaluar kriminale
  - I pandehuri ka një pozitë të qëndrueshme shoqërore si një profesionist i martuar dhe i arsimuar.
427. Trupi gjykues ishte plotësisht i vetëdijshëm se vëmendje e përpiktë publike ishte drejtuar në këtë rast si një nga rastet më të rënda të korrupsionit. Megjithatë, trupi gjykues duhet të theksojë se procesi i vënies të drejtësisë është i drejtuar në mënyrë rigoroze nga dispozitat ligjore, brenda kufijve të parashikuar nga ligji e jo nga pritjet publike lidhur me dënimin. Duke i shqiptuar këto dënime trupi gjykues synon që të arrijë qëllimin e dënimit i cili është i përqëndruar tek të pandehurit. Pas shqyrtimit të plotë të secilit të pandehur, trupi gjykues erdhi në përfundim se secila dhe të gjitha

karakteristikat personale të të pandehurve dhe jetesa e tyre më herët justifikojnë shqiptimin e dënimit me kusht për ta, dhe se ata do ta respektojnë rendin ligjor, dhe në veçanti, ata nuk do të kryejnë ndonjë veprë më tutje. Trupi gjykues e kufizoi kohën e pezullimit në dy vite pasi që kjo periudhë kohore është e përshtatshme për rrethanat e këtij rasti dhe i mundëson trupit gjykues për të arritur qëllimin e dënimit dhe në mënyrë të veçantë për të parandaluar rikthimin e tyre në krim.

428. Duke pasur parasysh se të gjithë të pandehurve iu është shqiptuar dënimi me kusht, trupi gjykues erdhi në përfundim se në mënyrë që të arrihet qëllimi i dënimit duhet të shqiptohet dënimi plotësues.
429. Kundër të pandehurve O.J., E.A., F.B., S.M., S.S., RR.R., T.M., H.B. dhe G.G., sipas nenit 54 paragrafët 1 dhe 2 dhe nën par. 4 dhe neni 57 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPPK, shqiptohet dënimi plotësues i Ndalimit në ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës shqiptohet për një periudhë prej dy (2) viteve.
430. Kundër të pandehurit N.U., në bazë të nenit 54 par. 1 dhe 2 dhe nën-paragrafi 4 dhe neni 57 paragrafët 1, 2, dhe 3 të KPPK, shqiptohet dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës për një periudhë prej tre (3) viteve nga dita kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.
431. Ky dënim plotësues ndihmon më tutje në arritjen e qëllimit të dënimit, që do të thotë se të pandehurit do të respektojnë rendin ligjor dhe nuk do të kryejnë asnjë veprë. Trupi gjykues vendosi se dënimi plotësues është i nevojshëm për shkak se të gjithë të pandehurit ende mund të kryejnë detyrat e avokatëve dhe ish-gjykatësit mund të aplikojnë për një pozitë të tillë.
432. Kërkesat pronësore-juridike
433. Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për realizimin e plotë apo të pjesërishtë, gjykata në pajtim me nenin 458 të Kodit të Procedurës vendosi që të udhëzon palën e dëmtuar se ai mund ta realizojë kërkesën e plotë pronësore-juridike në kontest civil.
434. Përfundim:
435. Duke shqyrtuar me kujdes të gjitha provat e lëndës dhe pas dëgjimit të të gjithë dëshmitarëve të propozuar trupi gjykues erdhi në përfundim se është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit kanë kryer veprën penale siç akuzohen në aktakuzë, prandaj, gjykata vendosi si në dispozitiv.
436. Ne duhet të theksojmë se shpenzimet do të vendosen me një aktvendim të veçantë.

## **GJYKATA E QARKUT TË PRIZREN**

**P.nr.272 / 13**

**Me datë 9 shtator 2014**

**Procesmbajtësi**

**Kryetari i trupit gjykues**

**Sonila Macneil**

**Arkadiusz Sedek**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës Themelore në Prizren, në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, në bazë të nenit 380 par. 1 i KPP-së.